REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

# Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

# 2023-2027

**Djetor 2022, Klinë**

*1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave ..................................... 6*
1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit ..................................................................... 6
1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishkimin e planit ........................................... 7
1.3 Konteksti lokal ........................................................................................... 10
*2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave ................................................... 18*
2.1 Të dhënat për mbeturina në komunë ............................................................... 18
2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave ....................................... 19
2.3 Rishikimi i implementimit të planit ................................................................. 21
2.4 Performance e shërbimit ............................................................................... 23
2.5 Performanca financiare e MM ......................................................................... 24
2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave ........................ 25
2.7 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave .................................................... 25
*3 Objektivat e MM dhe plani operacional ................................................................. 27*
3.1 Vizioni i MM ............................................................................................... 27
3.2 Objektivat dhe caqet e MM ............................................................................ 27
3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave ....................... 28
3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave ......................................... 31
3.5 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qendrueshme të MM 39
3.6 Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit ..... 42
3.7 Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM ............. 43
*4 Plani i MM në kushte emergjente ........................................................................ 44*
*5 Plani financiar, veprimi dhe monitorimi ................................................................. 45*

**Lista e Shkurtesave**

| | |
|---|---|
| AMMK | Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës |
| ASK | Agjencioni i Statistikave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BMZ | Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik |
| CEDE | Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit |
| DRS | Sistemi i kthimit të depozitës |
| ELV | Automobila mbeturinë |
| EPR | Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit |
| GIZ | Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik |
| QeK | Qeveria e Kosovës |
| ITMB | Impijanti për trajtimin mekanik biologjik |
| IWMS | Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave |
| JICA | Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar |
| KfW | Kreditanstalt für Wiederaufbau |
| KIWER | Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit |
| KLMC | Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës |
| KRM | Kompania Regjionale e Mbeturinave |
| MESPI | Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës |
| MND | Mbeturina nga ndërtim demolimi |
| MPEE | Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike |
| MRF | Qendra e rikuperimit të materialit |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| PKMM | Plani komunal për menaxhim të mbeturinave |
| PPP | Partneriteti publik privat |
| PZP | Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit |
| SIMM | Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave |
| WFD | Direktiva kornizë e mbeturinave |

## Lista e tabelave

Tabela 1 Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2 Migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar për vitin 2021 në Komunën e Klinës
Tabela 3 Numri ndërmarrje të regulltë në komunën e Klinës
Tabela 4 Rrezja shërbyese optimale në vijen ajrore (m)
Tabela 5 Sasia e mbeturinave të grumbulluara 2021 nga KRM "Ambienti"
Tabela 6 Analiza e kompozicionit të mbeturinave 2020-2021 (rasti Pejë)
Tabela 7 Mbeturinat e riciklueshme të grumbulluara nga operatoret
Tabela 8 Operatorët për menaxhimin e mbeturinave nën përgjegjësin komunale
Tabela 9 Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës
Tabela 10 Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 11 Mbulimi I shërbimit për EF sipas vendbanimeve
Tabela 12 Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 13 Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 14 Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 15 Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 16 Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 17 Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 18 Shpenzimet e shërbimit të MM
Tabela 19 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 20 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 21 Lista e propozuar e objektivave të planit
Tabela 22 Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 23 Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante “zero mbeturina”
Tabela 24 Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 25 Parashikimet demografike të popullatës
Tabela 26 Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 27 Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 28 Caqet e riciklimit
Tabela 29 Orari i ndarjes së mbeturinave në burim
Tabela 30 Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 31 Strategjia e zgjerimit me shërbim
Tabela 32 Efikasiteti i stafit
Tabela 33 Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 34 Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela 35 Plani veprimit dhe monitorimit - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi”
Tabela 36 Plani veprimit dhe monitorimit - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi
Tabela 37 Plani veprimit dhe monitorimit - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore
Tabela 38 Plani veprimit dhe monitorimit - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit
Tabela 39 Plani veprimit dhe monitorimit - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve

## Fjala e kryetarit

Kam nderin që ta shpalosi para juve qytetarë të komunës së Klinës planin komunal të menaxhimit të mbeturinave 2023 – 2027. Ky plan përmbledh vullnetin dhe përcaktimin tonë të përbashkët për një mjedis të pastër dhe dukje më të bukur të qytetit tonë dhe më tërheqëse për vizitorët.

Bashkërisht do të angazhohemi që nëpërmjet këtij plani të reduktojmë në masën më të madhe të mundshme gjenerimin e mbeturinave, mbrojtjen e resurseve natyrore si dhe ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave sipas praktikave më të mira të ave duke zbatuar menaxhimin e integruar të mbeturinave.

Përmes promovimit të ekonomisë qarkore dhe angazhimit social ne kemi synim që të integrojmë në sistem sektorin informal, dhe të zhvillojmë ekonominë lokale përmes partneritetit me biznese lokale të komunës dhe më gjerë.

Jemi të vetëdijshëm se zbatimi i këtij plani ambicioz është një sfidë e madhe dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme politike, financiare, fuqizim të kapaciteteve organizative dhe njerëzore të komunës dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetjen e plotë të komunës. Ne inkurajojmë qeverinë, donatorët dhe shoqërinë civile të na mbështesin në arritjen e objektivave të planit dhe realizimin e misionit të komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe krijimin e kushteve për mirëqenie të qytetarëve tanë.

Ne do të punojmë vazhdimisht për të rritur vetëdijen mbi rëndësinë e minimizimit të gjenerimit të mbeturinave, rëndësinë e ndarjes së mbeturinave në burim, do të angazhohemi në implementimin e projekteve për ripërdodrimin dhe riciklimine mbeturinave, si dhe inkurajimin e qytetarit aktiv në partneritet të qëndrueshëm me bizneset, si dy aktorët kryesorë në realizimin me sukses të planit.

Për fund shfrytëzoj rastin të faleminderoj përzemërsisht partnerët tanë GIZ, Asociacionin e Komunave të Kosovës, kompaninë konsulente “KIWER” dhe OJQ “CEDE” që na kanë ndihmuar në hartimin e këtij plani.

Përzemërsisht,

Kryetari i Komunës

Prof. Zenun Elezaj

# 1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

## 1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. PKMM ofron kornizen konceptuale për menaxhimin e qendrueshem të mbeturinave për periudhen pesëvjeqare për territorin e administruar nga Komuna në pajtueshmeri me dispozitat ligjore dhe kornizen planifikuese strategjike.

Objektivi i PKMM është që të analizon situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), të identifikoj çështjet dhe mangësitë, të vlerësoj pikat e forta dhe të dobëta, të propozoj rekomandime për përmirësime të gjendjes dhe përcaktoj vizionin, qëllimet dhe objektivat e reja (afatshkurtra, afatmesme), si dhe të hartoj një Plan Veprimi ku përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga Komuna e Klinës në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si në vijim:

PKMM ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të tyre.
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

**Vizioni -** *Komuna e Klinës duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërin e 100 % të territorit të Komunës.*
**Misioni-** *Komuna e Klinës do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit.*
**Masat e Shërbimit të Grumbullimit te Mbeturinave**:

- ***Masa e Parë*** - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
- ***Masa e dytë*** - Rritja e Mbulushmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.
- ***Masa e Tretë* -** Krijimi i strukturave organizative;
- ***Masa e Katërtë-*** Vlerësimi i gjendjes ekzistuese;
- ***Masa e Pestë-*** Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;
- ***Masa e Gjashtë-***Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- ***Masa e Shtatë-*** Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës**.**

Hartimi i planit lokal për menaxhim të integruar të mbeturinave është mbështetur në pjesëmarrjen aktive të institucioneve përkatëse lokale dhe atyre qendrore, të komunitetit dhe organizatave joqeveritare. Realizimi i programeve dhe aktiviteteve të propozuara në plan do t'i referohet mundësive për zhvillim ekologjik të komunës së Klinës dhe qasjes sistematike dhe gjithëpërfshirëse me implikime aftagjata për jetën e qytetarëve të komunës sonë.

## 1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishkimin e planit

### 1.2.1 Korniza ligjore për MM

Baza themelor legjislative për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike **Ligji i Mbeturinave** përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunat sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar

në masë të konsiderueshme me direktivat përkatës të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligjë përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhiimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit .

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen koorporative. transparencën financiare, dhe forminimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal te Komuna e Klinës përfshinë:

- Rregulloren Komunale për menaxhimin e mbeturinave-2017
- Rregulloren për Leje mjedisore etj.

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) per Menaxhimin e Integruar te Mbeturinave ne Kosovë- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshém të menaxhimit të mbeturinave dhë të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik té vendit. Dokumenti synon ti trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- **Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës 2014-2021-** Është dokument në të cilën vëhen baza e zhvillimit të qëndrueshëm në Komunën e Klinës. Përmes këtij plani mundësohet zhvillimi I qëndrueshem ne ruajtjen e mjedisit, planifikimit hapësinor, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, bujqësor, turizmit dhe zonave të mbrojtura natyrore dhe kulturore
- **Plani i Veprimit – Shërbimet e ekosistemit dhe investimet intelegjente në Komunën e Klinës 2021-2025** - Plani ka për qëllim të kontribojë në rritjen e qëndrueshme ekonomike në rajonin ndërkufitar duke mundësuar kapërcimin e bashkive në ekonominë e gjelbër përmes politikave të integruara, investimeve inteligjente publike dhe rritjes së kapaciteteve. Ndërkohë, hartimi dhe miratimi i këtij plani veprimi kontribon në rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve vendore për mbrojtjen e kapitalit natyror.
- **Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Klinës 2022-2024,** që prezantojnë shpenzimet edhe për projektet e planifikuara për fushën e mjedisit.

### 1.2.2 Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunat e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunat nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- **Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit** - është përgjegjes për rregullimin e aspkteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësit e organeve komunale në menaxhimin e e mbeturinave jan paraqitur si më poshtë:

- **Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP)** është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimine punëve të kompanive të

angazhuara për mirëmbatjen e pastrimin e rrugëve dhe hapsirave tjera komunale.DSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të sherbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale dhe ndermarrjet për administrimin e mbeturinave.

- **Drejtoria e financave** është përgjegjese për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojte të Mjedisit**, e cila nder të tjera është përgjegjse pë planifikimin e zhvillimit hapsinor dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe mbeturinave brenda teritorit të Komunës, po ashtu siguron mbeshtetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.
- **Drejtoria për punë inspektuese** e cila është përgjegjëse për mbikqyrjën dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregullorëve Komunale në lëmin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujësis, dhe Pylltarisë.
- **Ndërrmarrja publike Komunale KRM"Ambineti", Klinë** – kjo ndërmarje është përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponia e mbeturinave në Sferkë të Thatë në Pejë.

## 1.3 Konteksti lokal

Pozita gjeografike:

Komuna e Klinës shtrihet ne pjesën perendimore të Kosovës , përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit .Komuna e Klinës Kufizohet me shtatë Komuna -ne veri kufizohet me Istogun,në lindje kufizohet me Skenderajin dhe Drenasin, ne jug kufizohet me Malisheven ,Rahovecin dhe Gjakovën kurse ne perëndim kufizohet me Pejën.

Komuna e Klinës ka një sipërfaqe prej 308.8 kilometra katëror dhe ka 9 zyra vendore dhe 54 vendbanime. Territori i komunës se Klinës ka karakteristika të ndryshme gjeomorfologjike. Pjesa lindore ka karakter të lartësisë, ndërsa pjesa perëndimore ka karakter të rrafshët. Pjesa veriore dhe verilindore e komunës është e përbërë prej viseve malore të Prekorupës dhe Drenicës, ndërsa pjesa perëndimore dhe pjesa qendrore janë pjesë e rrafshinës së Rrafshit te Dukagjinit. Pjesët të cilat i përkasin Rrafshit te Dukagjinit janë në zonën me lartësi mbidetare deri ne 500 m, ndërsa pjesët kodrinore gjenden kryesisht në lartësinë ndërmjet 500 dhe 700 m. Ne pjesën lindore, një pjesë vogël e territorit te kësaj komune ka lartësinë pak më shumë se 700 m

Qyteti i Klinës ka pozitë qendrore ne kontekst të komunës dhe paraqet nyje të rëndësishme të qarkullimit.

Neper territorin e Komunës së Klinës kalojnë pesë lumenje; Drini i Bardhë,Lumbardhi i Pejes, Lumi Klina, Lumi Mirusha, dhe Lumi i Istogut. Pra pozita gjeografike dhe kushtet klimatike krijojnë kushte te volitshme për zhvillimin e bujqësisë, perimeve, permeve, zhvillimin e blegtorisë ,shpeztarisë dhe bletarisë.

Një rol shumë të rëndesishem ne pozitën e komunës së Klinës luan dhe pershkruajrja e Drinit te bardhë i cili e lidh Kosovën me Republikën e Shqipërisë .

Pozita gjeografike i mundëson lidhje te mira rrugore dhe hekurudhore me rajonin me gjerë.

Neper Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë -Pejë, rruga regjionale Klinë-Skenderaj - Mitrovicë dhe rruga regjionale Klinë-Istog-Pejë.

Neper territorin e Komunes së Klinës kalojnë edhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë - Pejë dhe Fushë Kosovë -Klinë -Prizren. Pra këto lidhje perveq që lidhin Klinen me qendrat tjera ne Kosovë ,mundësojnë edhe lidhje te metejme me qendrat ne rajon. Shih Fig.1.




Fig 1. Lokacioni i K. Klinës në hartën e Kosovës[1]

Klima -në komunën e Klinës ka karakteristikat e klimës së butë kontinentale, me ndikim të klimës mesdhetare. Temperatura mesatare e ajrit është 11.3˚C. Në korrik arrihet temperatura maksimale absolute prej 37.6˚C, ndërsa ne shkurt temperatura minimale absolute prej -11,8˚C. Amplituda mesatare është 46.1˚C. Në këtë rajon për shkak të ndikimit të mediteranit i cili depërton me anë të lumit Drini i Bardhë, klima është mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturë të ajrit gjatë vitit. Vlera mesatare vjetore e të reshurave në Klinë është 540 mm. Të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në janar dhe shkurt. Të dhënat nga IHMK tregojnë se koha e djellosjës në periudhën kohore 2010-16 ishte 1846.50 orë në vitit. Muajt me ndriçim më të gjatë ishin muaji korrik dhe gusht ndërsa me ndriçim më të shkurtër ishin dhjetori dhe janari.

Resurset natyrore:

Komuna e Klinës ka lloje të ndryshme të tokave të cilat karakterizohen me bonitet të ndryshme (8 kasa të ndryshme të bonitetit). Llojet kryesore të tokave janë: Tokat aluviale të cilat shtrihen rreth luginave dhe lumenjve dhe i takojnë klasat të pare të bonitetit. Përdoren për kultivimin e produkteve të ndryshëm bujqësore. Pos tokës si burim natyror, në Komunën e Klinës janë prezentë edhe burime tjera të cilat mund të përdoren për zhvillim ekonomik: Thëngjilli - gjenden mes komunave Klinë dhe Istog, në lartësi 400 – 500m mbi nivelin e detit. Këto shtratimet të thëngjillit kryesisht gjenden ndërmjet hapësirës së Klinës në jug, Jashanicës në lindje, Tuçepit në veri dhe Drinit të Bardhë në perëndim. Boksiti - Shtresat e boksitit gjenden afro 10 km në jug – lindje të qytetit të Klinës, në brez kodrinor. Ky territor përfshin një sipërfaqe prej 15 $km^2$. Zhavorri dhe rëra - gjendet kryesisht në jug të Klinës, përkatësisht në territorin e fshatit Volljakë, buzë bregut të djathtë dhe të majtë të Drinit të Bardhë dhe

[1] https://www.google.com/search?q=harta+e+komunes+se+Klines

përfshinë një sipërfaqe prej 40ha në bregun perëndimor dhe 20ha në bregun lindor të lumit Drini i Bardhë. Argjila për tulla - gjendet në perëndim të qytetit të Klinës, përkatësisht në territorin e Jagodës, ne afërsi të hekurudhës dhe 2 km larg rrugës Prishtinë – Pejë. Trashësia e shtratimit të argjilës sillet prej 6-18.6 m. Si resurs i veçanet janë pllakat të gurit, të cilat janë edhe identifikuese të Komunës së Klinës, të cilat nxirren në lokalitete të ndryshme.

Me qëllim të ruajtjes së biodiversitet si dhe diversiteti kulturorë në Komunën e Klinës janë shpallur zona të mbrojtura të cilat i takojnë kategorive të ndryshëm. Në aspektin e mbrojtje së natyrës zonat më të rëndësishme janë ato të cilat i takojnë Kategorisë III sipas IUCN-së (monumente natyrore), janë; Ujëvara e Mirushës, Rrjedha e Lumit Klina, Gryka e Lumit Klina, Burimi i ujit mineral në Dresnik, shumë komplekse të drunjëve të vjetër dhe monumente kulturore. [2]

Pyjet - Një pjesë mjaft e madhe e Komunës së Klinës është e mbuluar me pyje, të cilat përfaqësohen nga lloje të ndryshme të dushkut, përkatësisht nga bashkësia pyjore e shpardhit dhe qarrit (Quercetum frainetto-cerris scardicum) dhe më rrallë edhe nga bashkësia pyjore e bungë-buti me qarr (Quercetum pubescentis-cerris). Këto janë bashkësi klimatogjene që shtrihen lartësi mbidetare prej 400 deri 750 m në tërë territorin e Kosovës. Këto pyje dominohen nga llojet si: shpardhi (Quercus farnetto), qarri (Quercus cerris), bungë-buti (Quercus pubescent) dhe në vartësi nga lartësia mbidetare, baza gjeologjike, ekspozicioni, etj., këtyre iu bashkëngjiten edhe bungbuta (Quercus pubescens), frashëri i bardhë (Fraxinus ornus), mollëviçja (Sorbus torminalis), kreka (Acer campestre), molla florentinë (Malus florentiana), Bungu (Quercus petrea), shkozë (Carpinus sp.), etj.

Pos pyjeve të larta dhe atyre të ulëta në Komunën e Klinës gjenden edhe shkurraja të ndryshëm, përkatësisht bashkësia bimore e dëllinjës (Astero-Juniperetum oxycedri), të dominuar nga dëllinja (Juniperetum oxycedri). Në zonat rreth lumenjve po ashtu zhvillohet vegjetacioni i drunjtëve të lartë dhe shkurreve, përkatësisht bashkësive bimore të shelgut të bardhë (Salicetum albae fragilis), shelgu i kuq (Salicetum purpurea), verri i zi (Alnetum glutinosae). Këto bashkësi dominohen nga llojet e shelgut të bardhë (Salix albae), verrit të zi (Alnus glutinosae), plept (Populus ps.), shelgut të kuq (Salix purpurea). Këto bashkësi bimore janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë aktorit antropogjen (Rexhepi 1994).

Sipas klasifikimit "Corine Land Cover 2006" tokat pyjore në Komunën e Klinës zënë 26.68% të sipërfaqes së komunës dhe janë të klasifikuara si: pyje gjetherënëse (22.95%) dhe zonat tranzitore nga pyjet në shkurraja (3.73%)

Popullsia

Sipas të dhënave të regjistrimit të ASK 2011, Komuna e Klinës kishte 38496 banorë, ndërsa sipas vlerësimeve të ASK 2021, numri I banoreve është 40490, shih tabelen. 1.

| **Tabela 1: Të dhënat mbi popullatën** | | | |
|---|---|---|---|
| Regjistrimi ASK 2011 | | Vlerësimi ASK 2021 | |
| Numri i populates | Numri i amvisërive | Numri i popullatës | Ngritje / zbritje % |
| 38,496 | 5,843 | 40.490 | +5.4 |

[2] Plani Zhvillimor I Komunës së Klinës 2014-2021

Migrim ndërkombëtarë i popullisë në Komunën e Klinës zënë një shkallë të lartë në krahasim më migrimin vendor. Bilanci i migrimit të përgjithshëm është -738 (tabela 2).

Tabela 2: Migrimi për vitin 2021 në Komunën e Klinës[3]

| **Gjthësej popullsia e vlerësuar 2020** | **Migrimi ndërkombëtar 2021** | | | **Migrimi Kombëtar 2021** | | | **Bilanci i përgjith-shëm i migrimit** | **Gjithësej popullësia dhe migrimi 2021** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i migrimit ndërkomb-ëtar | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i Migrimit Kombëtar | | |
| 40490 | 106 | 817 | -711 | 185 | 212 | -27 | -738 | 39.752 |

## Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Në komunën e Klinës aktivitet të ndryshme humane ndikojnë drejtpërsëdrejti në gjendjen e mjedisit, përfshirë këtu ndikimin në ekosisteme. Për shkak të degradimit të ekosistemeve vjen deri te ulja e kualitetit në mjedis, zvogëlimi i mundësisë së përdorimit të biodiversitetit për zhvillim ekonomik, si dhe zvogëlimi i mirëqenës së popullatës humane. Faktorët që me së shumti kanë ndikuar në uljën e cilësisë së mjedisit në Komunën e Klinës, janë;

Zënia e tokës- zgjerimi zonave të banimit, ndërtimet pa leje, ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese, ndërtimet për qëllime komerciale janë disa nga aktivitetet humane që qojnë në zënien e tokës në Komunën e Klinës.

Degradimi i lumenjve-shpesh përgjatë lumenjve në Komunën e Klinës hasen ndërtime të ndryshëm, devijime të shtretërve të lumenjve, ose edhe nxjerrje e rërës. Këto ndryshime rezultojnë me daljen e lumit nga shtrati dhe vërshime, sidomos në stinën e pranverës dhe vjeshtë kur edhe ka më së shumti reshje. Vërshimet sjellin dëme të konsiderueshme materiale.

Ujërat e Zeza- ujërat e zeza nga amvisëria por dhe nga aktivitetet e ndryshëm industriale, nuk trajtohen paraprakisht, ato derdhen drejt për së drejti në lumenj. Shkaktojnë dëme në mjedis, dëmtim të peizazhit, florës dhe faunës si dhe dëme në shëndetin e njeriut.

Bujqësia- Komuna e Klinës ka një sipërfaqe të madhe ku kultivohen produkte bujqësore, për rritjen e të cilave përdoren plehra artificiale si dhe pesticide të ndryshëm. Ndikimi i plehrave dhe pesticideve është i shumëfishtë, duke filluar nga ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore, tokë, në florë dhe faunë si dhe në shëndetin e njeriut.

Mbeturinat- një sasi e konsiderueshme e mbeturinave në Komunës së Klinës hedhen jashtë deponive, si p.sh. përgjatë lumenjve dhe përroskave, dhe vendet të ndryshme. Mbeturinat ndikojnë në peizazhin e zonës në florë dhe faunë, si dhe në shëndetin e njeriut. Gjatë vitit 2021 janë identifikuar 31 deponi ilegale te mbeturinave.

Eksploatimi i gurit dhe gurthyesit: janë një faktor tjetër shqetësues në Komunën e Klinës të cilët shkaktojnë probleme të mëdha në mjedis, sidomos në peizazhin e zonës, por edhe në shëndetin e njeriut.

Prerja Ilegale e pyjeve-në një pjesë të madhe të sipërfaqes pyjore të Komunës së Klinës hasen aktivitete të prerjes ilegale të pyjeve. Këtë ndikojnë si në zvogëlimin e sipërfaqes së pyjeve

[3] Vlerësimi Popullsia e Kosovës 2021, ASK

por edhe në uljen e cilësisë së tyre. Dëmtimi i ekosistemeve pyjore ka ndikim edhe në ekosisteme tjera, por edhe në florë dhe faunën, si dhe peizazheve të zonës.

Biodiversitet- Komuna e Klinës ka një diversitet të larmishëm biologjik. Në kuadër të florës përfshihen shumë lloje bimore të gjethërenseve drurore, shkurreve dhe pjesë e vogël halore. Në mesin e bimëve të pranishme në Komunën e Klinës janë edhe bimët mjekësore dhe aromatike të cilat paraqesin në interes të veçantë në aspektin ekonomik.

Disa prej tyre si; shpardhi (*Quercus farnetto*), qarri (*Quercus cerris*), bungë-buti (*Quercus pubescent*) dhe xxx (*Quercus petrea*), *Quercus farnetto, Quercus petraea, Rosa canina, Rumex crispus, Salvia sclarea, Sedum maximum, Senecio vulgaris, Silene viridiflora, Stachys officinalis, Stachys scardica, Stellaria holostea, Tanacetum vulgare, Teucrium chamaedrys, Trifolium angustifolium, Trifolium medium, Trifolium montanum, Trifolium pignati, Thymus sp., Ulmus minor, Urtica dioica, Verbascum sp., Veronica chamaedrys, Vicia sativa etj.*

Disa lloje bimore në Komunën e Klinës, ose në kufi të kësaj komune me komunat tjera (zona e Mirushës) janë lloje endemikët e Ballkanit, si p.sh.: boshtra evropiane (*Forsythia europaea*), bari i zgjebes (*Scabisa fumaroides*) moltkia Dorflerit (*Moltkia doerfler*), *asteri Shqiptar* (*Aster albanicus*), poligala e Dorflerit (*Polygala doerfleri*), gjineshtra e Hasertit (*Genista hassertiana*), halaçia e Sendtnerit (*Halascya sendtneri*), dioskorea e Ballkanit (*Dioscorea balcanica),* skutelaria lindore (*Scutellaria orientalis*), rrushqyqja e serpentine (*Sedum serpentini*), pendëkaposhi I Majorit (*Stipa mayeri*), veronica e Andrasovskit (*Veronica* andrasovskyi, Malus florentina, Moltkia doerfleri). Me qëllim të mbrojtjes së këtyre llojeve zona e Mirushë është shpallur zonë e mbrojtur “Monumenti i Natyrës me rëndësi të veçantë”

Në Komunën e Klinës jetoje lloje të ndryshme të insekteve, shtazëve kurrizores siç janë lloje të ndryshëm të **peshqve, ujë-tokësorëve, zvarranikëve**, **Shpendët dhe gjitarët. Prej gjitarëve janë;** derri i egër (*Sus scofa*), vjedulla (*Meles meles*), lepuri (*Lupus europeus*), ketri (*Scirius Vulgaris*), ujku (*Canis lupus*), macja e egër (*Felis sylvestris*), sqarthi (*Martes martës*) iriqi (*Erinaceus europaeus)*, etj.

### 1.3.1 Të dhënat mbi ekonominë lokale

**Bujqësia** - Klina hyn në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë, pasi që 87.7% e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Tokë bujqësore është 95%, vetëm 4.9% janë toka jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12,734 ha, pyjet me 12,735 ha, livadhet me 2,184 ha, kullosat me 2,043 ha etj.[4]

Duke marrë për bazë pozitën gjeogrfike dhe cilësinë e tokës sipas Drejtorisë së Bujqësisë së Komunës së Klinës realizimi i te mbjellurave te planifikuara për vitin 2022 është më sa vijon, shih tabelen 3.

Tabela.3. Realizimi i te mbjellurave për vitin 2022

| Nr. | Lloji të mbjellurave | ha |
|---|---|---|
| 1 | Misër | 2995 |
| 2 | Tërsherë | 260 |
| 3 | Perime | 215 |
| 4 | Patate | 155 |
| 5 | Bimë Foragjere | 790 |
| 6 | Te tjera | 75 |

[4] Drast strategjia e zhvillimit ekonomik local për Komunën e Klinës 2022-2027

| | | |
|---|---|---|
| 7 | Gjithesejt | 4990 |

**<u>Turizmi lokal:</u>** Natyra e larmishme në Komunën e Klinës me peizazhe të bukura si luginat e lumenjve, ujëvarat e Mirushës, shpellat, fauna dhe flora, pyjet, klima, si dhe trashëgimia kulturore (kullat, mullinjtë, xhamitë, kishat etj.), janë vlerat cilat turizmin e bëjnë një sektor potencial për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Komuna planifikoj të zhvilloj eko-turizmin, si formë e turizmit të qëndrueshëm i definuar dhe agroturizmi, turizëm rural dhe turizmi kulturor.

Klina është e njohur për bukuritë e saj natyrore. Rrjedhimisht, ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit rekreativo-turistik.

Parku “Ujëvarat e Mirushës” është një ndër zonat më bukura dhe interesante të natyrës së Republikës së Kosovës. Ky park shtrihet në territorin e komunave: Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Saktësisht gjendet në jug të maleve Gremnik, në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha. Sipërfaqja e këtij parku është 598.4 ha. Lartësia mbidetare e parkut është 340-600 m.

**<u>Institucionet publike:</u>** Administrata Publike- Sherbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara kryesisht ne qendrën urbane pra ne Klinë, ku përfshihen shërbimet e kuvendit Komunal dhe drejtorit me zyrat përkatese, Qendra për Punë Sociale, Qendra per rexhistrimin e automjeteve, post telekomi , bankat dhe filalet e bankave .

Në zonat rurale shërbimet adminsitrative ofrohen ne 13 zyre te gjendjes civile. Sipas te dhënave te fundit te ne dhjetor te vitit 2021 ne administraten Komunale janë të punësuar 123 punonjës , ne sektorin e arsimit 647 punonjës dhe ne sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 136 punonjës. Shih Fig.2.




Fig.2. Struktura organizative e Administratës së Komunës së Klinës

**<u>Arsimi:</u>** Sistemi arsimor në komunën e Klinës është e organizuar në tri nivele: arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X –

XII). Në komunën e Klinës arsimi është i organizuar në 29 institucione shkollore. Prej tyre 1 çerdhe, 26 shkolla të nivelit fillor dhe mesëm të ulët dhe 2 shkolla të nivelit mesëm të lartë.

Sipas Drejtorisë së Arsimit te Komunës së Klinës ne vitin 2022 Komuna e Klinës ka 7055 nxenës dhe dhe 647 punonjes arsimor.shih tabelen 4.

Tabela 4. Vijueshmeria e nxënësëve në mësim për vitet 2018-2021

| Vijueshmeria | 2018/2019 | 2019/2020 | 2020/2021 |
|---|---|---|---|
| Arsimi Parafillore | 487 | 564 | 505 |
| Arsimi i mesëm i ultë | 5792 | 5501 | 5326 |
| Arsimi i mesëm i lartë | 1715 | 1562 | 1446 |

**Shëndetësia:** Shërbimet shëndetësore në Komunën e Klinës organizohen në tri nivele të institucioneve:

- Qendra Kryesore të Mjëkesisë familjare (QKMF) në Klinë
- Qendra mjeksore familjare në fshatrat Zllakuqan,Ujmirë, Sverkë dhe
- 11 Ambullanca në fshatrat Budisalc, Jagodë,Drenoc,Grabanicë, Volljak, Gllarevë, Caravik, Jashanicë e Eperme dhe Shtupel.

Qendra Kryesore e mjekësisë familjare "Nëna Tereze" ne Klinë është institucioni kryesor shëndetësor ne Komunë. Ne kuadër te këtij institucioni përpos kujdesit primar shëndetsor ofrohet edhe shërbimi i ndihmës së shpejt ,praktikes se përgjithshme ,shërbimi internist , i pediatrisë,i ORL-së , shërbimi i vakcionimit. Sherbimi shëndetsor dytësor me i afërt ofrohet në Spitalin regjional në Pejë. Numri i të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve në komunën e Klinës në vitin 2019 ishte 148. Prej tyre, 31 mjekë, 1 farmacist, 86 infermierë dhe 30 punëtorë shëndetësorë.[5]

### 1.3.2 Dokumentet relevante komunale

Dokumentet relevante që lidhën me fushën e mjedisit të aprovuara në Komunën e Klinës janë;

- Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës 2014-2021
- Plani Lokal i Veprimit Mjedisor
- Plani i Veprimit – Shërbimet e ekosistemit dhe investimet intelegjente në Komunën e Klinës 2021-2025

Harta zonale- 2020-2028- Një ndër qëllimet e para të Hartës Zonale të Komunës së Klinës, është përmbushja e kërkesës ligjore, e cila obligon komunën për hartimin e HZK-së dhe e cila është rezultat i zbatimit të projektit të reformës së integruar ligjore, që ka filluar për t'u zbatuar, me aprovimin e ligjit të ri të planifikimit Ligji Nr. 04/L-174. Qëllimi tjetër i rëndësishëm i Hartës Zonale të Klinës është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës së Klinës, e cila do krijojë

[5] ASKDATA: Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve, 2017-2019.

bazat e qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

# 2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave

## 2.1 Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Nga të dhënat e Raportit për gjendjen e mbeturinave në Kosovë, i hartuar në AMMK, për vitin 2021 dhe 2018, kemi këtë gjendje të menaxhimit të mbeturinave të gjeneruara, grumbulluara dhe të deponuara në Komunën e Klinës, shih tabelen 5.

**Tabela 5**. Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara në 2021 në Komunën e Klinës

| Viti | Mbeturina të grumbulluar (ton) | Mbeturina të grumbulluara nga deponitë ilegale (ton) | Totali i sasisë së mbeturinave të deponuara nga Ambienti (ton) |
|---|---|---|---|
| 2021[6] | 9,758.70 | - | 9758.70 |
| 2018[7] | 10,067.60 | - | 10067.60 |

Përbërja e fragmentimit të mbeturinave në Komunën e Klinës pas vlerësimit kemi këtë përbërje tabelen 6. (ju lutem ne tabel te vihet vitit i analizimit te kompozicionit te mbeturinave dhe nga cila organizat eshte bere. Apo kjo analize eshte bere nga zyra e Komisionit Evropian ne nivel vendi dhe eshte marr si krahasim edhe per Klinen ne vitin 2015/2016.

Tabela 6. Kompozicioni i mbeturinave në Komunën e Klinës

| Lloji i mbeturinave | Analiza e kompozicionit | |
|---|---|---|
| | Kilogram | Përbërja në % |
| **Mbeturinat Komunale** | | |
| Letër dhe karton | 27.43 | 8.84 |
| Qelq | 14.6 | 4.70 |
| Mbeturina të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat | 200.09 | 64.48 |
| Tekstil | 11.5 | 3.70 |
| Plastikë | 52.88 | 17.04 |
| Metal | 3.85 | 1.24 |
| Mbeturina tjera komunale | | |
| **Totali në kg dhe në %** | **310.35 kg** | **100.0** |

Mbeturinat komunale si mbeturina te ricklueshme nga bilanci i përgjithshëm i shprehur në % janë të paraqitura në tabelen 7.

**Tabela 7. Bilanci i mbeturinave Komunale**

| Kategoria | Mënyra e përcaktimit të sasisë | Mbeturinat e grumbulluara | | | Mbeturinat e dorëzuara | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nga operatorët e grumbullimit | Nga ricikluesit | Nga deponitë ilegale | Mbeturinat e ricikluara | Mbeturinat e tregtuara | Mbeturinat e deponuara |
| Letër dhe karton | | - | - | - | - | - | - |
| Qelq | | - | - | - | - | - | - |

[6] Raporti Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, AMMK 2021
[7] Raporti Vjetor për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, AMMK, 2018

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbeturina bio-degraduese | | - | - | - | - | - | - |
| Tekstil dhe veshjet | | - | - | - | - | - | - |
| Pllastika | | - | - | - | - | - | - |
| Metal | | - | - | - | - | - | - |
| Mbeturina mikse | Matje | 9,758.7 t | - | - | - | - | 9,758.7 t |
| **Total:** | | 9,758.7 t | - | - | - | - | 9,758.7 t |

## 2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

<u>Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit</u>

Komuna e Klinës për menaxhimin e mbeturinave ka autorizuar KRM"Ambienti", njësia në Klinë. Ky operator grumbullon mbeturinat nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet në komunë dhe i transporton për deponim në deponinë sanitare rajonale në Sferkë(Komuna Pejë).

Operatori i njëjtë kryen edhe shërbimin e grumbullimit të mbeturinave masive dhe të ndërtim rrënimit edhepse për veprimtarinë e fundit nuk posedon licencë valide.

Në komunë të Klinës oprojnë edhe operatorë tjerë të riciklimit të cilët nuk janë të formalizuar dhe veprojnë jashtë sistemit legal.

**Tabela 8: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale**

| | Emri i operatorit (biznesit) | Forma e pronësisë | Kategoria e menaxhuar e mbeturinave | Mbulimi me shërbim % | Statusi i kontraktimit (po/jo) |
|---|---|---|---|---|---|
| Operatori 1 | KRM "Ambienti" | Publike | Komunale | 100% | Po |

**Tabela 9: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës**

| | Emri i operatorit (biznesit) | Forma e pronësisë | Kategoria e mbeturinave të menaxhuara | Sasia e mbeturinave të menaxhuara |
|---|---|---|---|---|
| Operatori 1 | - | - | - | - |

<u>Mbulimi me shërbim:</u>

Mbulimi më shërbim për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës për ekonomit familjare është 97.9%. Prej numrit të përgjithshëm të EF që është 5843, sherbehen 5,721 EF. Shih tabelen 10.

**Tabela 10: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës**

| Emri i operatorit | Numri i EF | Numri i EF të shërbyera | Numri i bizneseve aktive | Numri i bizneseve të shërbyera | Numri i institucioneve | Numri i institucioneve të shërbyera |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KRM Ambienti | 5,843 | 5,721 | - | 699 | - | 70 |

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Tipologjia e ofrimit të shërbimit dhe frekuenca në zonën urbane dhe rurale janë të paraqitura në tabelen 16 më poshtë. Ofrimi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave në Komunën e Klinës është e ndarë dy zona: zona urbane qendra, dhe zona rurale. Në qytet mënyra predominante e shërbimit është me kontejnerë të përbashkët ndërsa në zonën periurbane dhe rurale forma e shërbimit është derë më derë. Frekuenca e shërbimit për zonën urbane është 1 – 2 herë në ditë varësisht nga sezona dhe fluksi i gjenerimit të mbeturinave ndërsa në zonën rurale mbeturinat grumbullohen një herë në javë. Sa i përket infrastrukturës ndarëse ajo nuk ekziston në komunë dhe mbeturinat hedhen në kontejnerë/shprta në mënyrë të përzier dhe si të tilla grumbullohen nga operatori.

**Tabela 12: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit**

| Vendbanimi | EF të shërbyera derë më derë % | Frekuenca e shërbimit | EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët % | Frekuenca e shërbimit |
|---|---|---|---|---|
| Zona urbane qendra | 25 % | 1 në javë | 75 % | 1-2 herë ditë |
| Zona rurale | 100% | 1 në javë | 0 | / |

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Në tabelën në vijim janë listuar të gjitha asetet që janë në përdorim në Komunën e Klinës, në funksion të hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale. Në Klinë mjetet e hudhjes së mbeturinave janë shportat 120l si dhe kontejnerët 1.1m3. Gjendja e këtyre pajisjeve të hudhjes nuk është e mirë dhe se nevojiten investime të vazhdueshme në ripërtëritjen e tyre.

**Tabela 13: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave**

| Lloji i kontejnerit | Numri | Gjendje të mire % | Gjendje funksionale % | Gjendje jo të mire % |
|---|---|---|---|---|
| Shporta 120 l | 4825 | 7 | 35 | 58 |
| Kontejnerë 1.1 m3 metalik | 180 | | | |

Mjetet për transportin e mbeturinave (kamionët) dhe mjetet tjera të grumbullimit dhe transportit të mbeturinat komunale, që janë nën menaxhimin e KRM"Ambienti", janë paraqitura në tabelen 14. Operatori i shërbimit ka në dispozicion një autopark të konsiderueshëm prej 8 kamionëve 2 prej të cilëve nuk janë në gjendje të mirë operative. Disa nga kamionët janë të vjetër më shumë se 10 vite dhe si të tillë kanë defektë më të shpeshta dhe harxhim të karburanteve dhe lirim të gazrave serrë.

**Tabela 14: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave**

| Brendi | Tipi | Kapaciteti ton apo m3 | Viti i prodhimit | Targat | Gjendja (e mirë /funksionale/e keqe) |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Iveko | Kamion | 8t | | 03-471-CS | Funksionale |
| MItsubish | Kamionet | 4t | | 03-871-DQ | Jo e mire |
| Mercedes 10/17 | Kamion | 7t | | 03-291-EL | Jo e mire |
| Mercedes eco | Kamion | 10t | | 03-634-GP | Funkisonale |
| Man | Kamionet | 4t | | 03-317-EJ | Funksionale |
| Mercedes Aktros | Kamion | 8t | | 03Z-32-08 | E mirë |
| Mercedes Aktros | Kamion | 8t | | 03-359-HP | E mirë |
| Mercedes Atego | Kamionet | 4t | | 03-867-HR | E mirë |

## 2.3 Rishikimi i implementimit të planit

Komuna e Klinës në planin e menaxhimit të mbeturinave 2016-2021, ka pasur 15 objektiva kryesorë të ndarë në të shërbimit, dhe institucional.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin objektiv. Në përgjithësi rezultatet e realizimit të caqeve janë modeste për shkak të mungesave infrastrukturore dhe kapaciteteve institucionale.

Sido që të jetë ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kan ndikuar në mospërmbushjen e objektivave.

| Tabela 14: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Objektiva e MM | Treguesi i performancës | Caku | Realizimi | Favorshëm / pafavorshëm | Koment |
| O1 | Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit tëmbeturinave | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Mungesa e fondeve të infrastrukturës |
| O2 | Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime. | % | 100% | 90% | Pafavorshëm | Mungesa e fondeve të infrastrukturës |
| O4 | Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet. | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia |
| O5 | Ndarja e mbeturinave në burim në disa lagje apo vendbanime të komunës. | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia |
| O6 | Ndarja embeturinave në sheshepublike – ishujt e gjelbër. | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Eshte nenshkruar marreveshja, por nuk eshte filluar |
| O7 | Përcaktimi I lokacionit për pranimin embeturinave të vëllimshme | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Lokacioni eshte percaktuar. |
| O8 | Krijimi i sistemit lokal të kompostimit | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Mungesa e fondeve të infrastrukturës dhe pandemia |
| O9 | Grumbullim dhe transportim i vecantë i mbeturinave shtazore. | 1 | 1 | 0 | Pafavorshëm | Dobësi në zbatim |
| O10 | Ndarja e mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | |
| O11 | Identifikimi I lokacionit për ndërtimin e qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtim demolimi | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Lokacioni eshte percaktuar. |
| O12 | Miratimi i rregullores | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Rregullorja është hartuar dhe miratuar |
| O13 | Emërimi i zyrtarit për menaxhim tëmbeturinave | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Zyrtari është emëruar |
| O14 | Organizimi i procesit të përcaktimit të tarifave të shërbimit tëgrumbullimit tëmbeturinave komunalen | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Procesi është zbatuar |
| O15 | Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dheinformim rreth efektevepozitive dhe negative tëmbeturinave, rreth oraritdhe rregullave tëgrumbullimit dhehedhjes së mbeturinave. | 1 | 1 | 1 | Favorshëm | Jane mbajtuar takime sipas masave te pandemise |

## 2.4 Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i ofrueseve të shërbimeve në Komunën e Klinës përfshinë stafin direkt, indirekt dhe administrative. Numri i stafit të përgjithshëm të cilët ofrojnë shërbime në menaxhimin e mbeturinave është 36.shih tabelen 16 . Numri i stafit total është 36 dhe raporti staf direkt staf administrative është 21 / 15. Në përgjithësi efikasiteti i stafit të KRM Ambienti në komunën e Klinës nuk është i favorshëm sidomos nëse treguesi kalkulohet për konsumatorë të shërbyer që shpalos mbistafim (joefikasitet të theksuar operativ).

| Tabela 16: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM | |
|---|---|
| **Kategoria** | **Numri i stafit** |
| **Stafi direkt** | |
| Kryepunëtorë | 1 |
| Shoferë | 5 |
| Punëtorë | 15 |
| Total staf direkt: | 21 |
| **Staf indirekt dhe administrativ** | |
| Drejtorët e bordit | - |
| Menaxhmenti i lartë | 1 |
| Zyrtarë të rangut të mesëm | 10 |
| Staf teknik | - |
| Zyrtarë të rangut fillestar | 4 |
| Staf tjetër | - |
| Total staf indirekt dhe administrative: | 15 |
| Total staf të MM | 36 |
| Mbeturina të grumbulluara | 9,759 |
| Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara | 3,69 |
| EF të shërbyera | 5,721 |
| Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera | 6,29 |

Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

Performanca e mjeteve teknikë, kamioneve të menaxhuar nga KRM"Ambienti" për vitin 2021 është paraqitur në tabelen 17. Konsumi i mesatar i naftës është 4,86 l/ton për mbeturina të grumbulluara.

| Tabela 17: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave | |
|---|---|
| **Kategoria** | **Performanca** |
| Kamionët në operim | 5 |

| | |
|---|---|
| Kapaciteti maksimal operues (ton) | 26 t |
| Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit) | 9,758 t |
| Xhiro (xhiro/vit) | - |
| Kilometrazhi (km/vit) | - |
| Konsumi i naftës (l/vit) | 47,410 L |
| **Efikasiteti i Shfrytëzimit %** | |
| Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve | - |
| Konsumi i naftës l/100km | - |
| Konsumi i naftës l/ton | 4.86 l /ton |

## 2.5 Performanca financiare e MM

Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpënzimet e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave përfshinë shpënzimet e pagave, shpenzimet e materialit direkt dhe amortizimi (shih tabelën 18). Struktura e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve shpalos faktin se shumica dërmuese e shpenzimeve shkojnë në paga dhe shpenzime administrative ndërsa amortizimi është shumë i vogël për shkak të aseteve të vjetëruara. Operatori duhet të përmirësoj efikasitetin e operimit për të siguruar fonde shtesë për investime të ripërtëritjes kapitale.

**Tabela 18. Shpenzimet e shërbimit të MM**

| **Kategoria e kostove dhe shpenzimeve** | **Kostot (€/vjet)** | **Pjesëmarrja %** |
|---|---|---|
| Shpenzimet e pagave | 240,946.9 | 65.58% |
| Shpenzimet e materialit direkt[8] | 117,924.2 | 32.10% |
| Shpenzimet indirekte dhe administrative | - | - |
| Amortizimi | 8,500 | 2.31% |
| Total: | 367,371.1 | 100% |

Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Faturimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës e bënë KRM ”Ambienti” ndërsa arkëtimi bëhet përmes njësisë së inkasantëve dhe formave tjera të pagesës përfshi edhe përmbaruesve privat. Sipas raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave për të hyrat dhe arkëtimin janë të paraqitura në tabelen 19. Amvisëritë janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave 67.8 % e pasuar nga bizneset 20.5% dhe institucionet 11.7%. Shkalla e arkëtimit është 87.4 % ndërsa për amvisëri ajo është 88.3%.

**Tabela 19: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM**

| | **Të hyrat** | | **Arkëtimi** | |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat operative | € | % | € | % |
| *-Amvisëritë* | 301,514 | 67,8% | 266,360 | 88,3% |

[8] Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *-Bizneset* | 91,177 | 20,5% | 77,576 | 85,1% |
| *-Institucionet* | 51,742 | 11,7% | 44,710 | 86,4% |
| Total: | 444,433 | 100% | 388,646 | 87,4% |

Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit për KRM "Ambienti", për vitin 2021, janë paraqitur me sa vijon, shih tabelen 20. Sistemi nuk mbulohet me të hyra nga kosto dhe kjo imponon që të përmirësohet performanca e të hyrave dhe të kostove sidomos në dritën e inflacionit.

| **Tabela 20: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit** | |
|---|---|
| Kostot e MM | 367,371.1 |
| Të hyrat e MM | 444,433 |
| Arkëtimi | 388,646 |
| Shkalla e mbulimit nga faturim i% | 86.61 |
| Shkalla e mbulimit nga arkëtimi % | 87.45% |
| Kosto për ton të mbeturinave | 37.64 |

## 2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Në Komunën e Klinës nuk ka ndonjë qëndër të transferimit dhe reciklimit, edhepse në një formë ishin të përcaktuara sipas PKMM për vitin 2017-2021 (ndërtimi i transfer stacionit të përbashkët me komunën e Istogut). Mbeturinat e grumbulluara nga KRM"Ambienti", dergohen në deponinë Sanitare në Sferkë të Thatë.

Deponia

Komuna e Klinës nuk ka dhe as nuk menaxhon më ndonjë deponi të mbeturinave. Mbeturinat e grumbulluara nga KRM"Ambienti", dergohen në Deponin Sanitare në Sferkë të Thatë, që është në territorin e Komunës së Pejës.

## 2.7 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Jep të dhënat esenciale se si menaxhohen kategoritë e mëposhtme të mbeturinave:

**Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme**- në komunën e Klinës nuk ka ndonjë vend të dedikuar për hedhjen e tyre. Grubullimin dhe deponimin e tyre nga lokalitete të ndryshme e bënë KRM"Ambienti", Njësia në Klinë.

**Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi**- Akoma nuk ekziston një formë e veçant e trajtimit të mbeturinave nga ndërtim demolimi. Nuk është përcaktuar as lokacioni për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtim demolimi!

**Menaxhimi i mbeturinave shtazore**- nuk ka trajtim të veçant për këtë lloji të mbeturinave përveç se deponohen në deponinë sanitare në Sverkë nga ana e KRM "Ambienti", njësia në Klinë. Kemi edhe shumë raste kur keto mbeturina hudhën në pjesë të ndryshme të natyrë. Nuk ka të dhënat për mbeturinat shtazore.

**Menaxhimi i mbeturinave medicinale**- meturinat të gjeneruara nga kujdesi primar (QKMF, QMF dhe Ambullanta) trajtohen nga operator privat apo KRM"Ambienti", me të cilin drejtoria e shëndetsisë ka kontratë për trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale!!!!

Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave- zakonisht në këtë kategori janë të përfshira mbeturinat të cilët mblidhen nga operatoret privat dhe të cilat janë mbeturina të reciklueshme. Nuk ka të dhëna për numrin e operatoreve privat që merren me reciklimin dhe trajtimin e ketyre mbeturinave!!

# 3 Objektivat e MM dhe plani operacional

## 3.1 Vizioni i MM

Komuna e Klinës, është një komunë e cila promovon menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave të bazuar në parimet e ekonomisë qarkore me synim mbrojtjen e mjedisit, prezervimin e resurseve natyrore dhe zhvillimit ekonomik lokal!

Komuna e Klinës synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar më qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

## 3.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 21: Lista e propozuar e objektivave të planit**

| Numri objektivit | Emërtimi |
|---|---|
| Objektivi 1 | Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave |
| Objektivi 2 | Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave |
| Objektivi 3 | Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve |
| Objektivi 4 | Eliminimi i deponive ilegale |
| Objektivi 5 | Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave |

## 3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji. Direktiva kornizë e BEs për menaxhim të mbeturinave kërkon në mënyrë mandatore që planet lokale të vendeve anëtare të përmbajnë objektiva masa dhe aktivitete që promovojnë parandalimin dhe reduktimin e gjenerimit të mbeturinave pasi që këto masa dhe aktivitete janë efektive në terma të kostove implementuese, kanë ndikim pozitiv mjedisorë, i ruajnë resurset natyrore dhe me efekteve tjera pozitive direkte dhe indirekte.

Komuna e Klinës është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

**Tabela 22: Korniza strategjike e Objektivit 1**

| Nr. | Aktiviteti / masa | Treguesi | Vlera bazë | Caku | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 1.1 | Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pkp /ditë) | Sasia e mbeturinave të grumbulluara nga ofruesi i shërbimeve (kg /pkb/ditë) | | | | | | |
| 1.2 | Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara | Shërbimi është riorganizuar që të mundësoj matjen në pikën e grumbullimit | - | - | 1 | - | - | - |
| 1.3 | Zbatimi i tarifave volumetrike | Tarifat volumetrike janë miratuar dhe po aplikohen | - | - | - | 1 | - | - |
| 1.4 | Futja e pakos stimuluese | Pako stimuluese është hartuar dhe miratuar | - | - | - | 1 | - | - |
| 1.5 | Shpërndarja e komposterëve individual | Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF dhe biznese „zero waste" | - | 250 | 100 | 100 | 200 | 200 |
| 1.6 | Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të | Fushata informative po zbatohet | - | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjenerimit të mbeturinave | | | | | | | |

### 3.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

**Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:**

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin komuna do të bëjë:

- **Planin e riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT.

**Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje**

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike do të zbatohen aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifat e bazuara në matje
- Zbatimi i tarifave PAYT

**Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim" dhe "zero mbeturina"**:

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bënin atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat do të luaj rolin e sajë që të i promovoj këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve

- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

**Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante "zero mbeturina"**:

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkë-financim komposterë individual per të reduktuar mbeturinat e hudhura në kontejnerët apo shportat që grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

**Tabela 23: Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante "zero mbeturina":**

| Nr. | Shperndardja e Kompostereve individual | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF | 150 | 100 | 100 | 100 | 150 |
| 2 | Numri i komposterëve individual biznese „zero waste"(72 biznese sherbehen) | 70 | 50 | 70 | 100 | 100 |

**Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.**

Komuna në mënyrë kontinuale do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektivë.

## 3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veqantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Komuna përmes këtij objektivi do ti adresojë edhe menaxhimin e mbeturinave nga kujdesi shëndetësor edhe mbeturinat me prejardhje shtazore nga therrëtoret dhe industria e përpunimit të mishit.

Edhepse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Masat e këtij objektivi do të jenë të ndara në dy faza, duke zbatuar në fazën e parë zgjidhje kalimtare që kanë qëllim normalizimin e menaxhimit të kategorive të ndryshme të mbeturinave në masën më optimale të mundshme për të menaxhuar situatën.

Në fazën e dytë komuna do të shfrytëzoj infrastruktura adekuate rajonale (ndërkomunale) të riciklimit që pritet të përfundohet dhe e cila parashihet në strategjinë e mbeturinave 2021 – 2030 dhe planin e veprimit 2021 – 2024.

Tabela në vijim jep kornizën strategjikë për objektivin 3 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

**Tabela 24: Korniza strategjike e Objektivit 2**

| Nr. | Masat / aktivitet / treguesi i performancës | Treguesi | Vlera bazë | Caku | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| **2.1** | Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave | Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar | | | 1 | | | |
| **2.2** | Studim i fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit dhe modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale | Studimi i fizibilitetit është zbatuar | | | 1 | | | |
| **2.3** | Zgjerimi i mbulimit me shërbim të ndarjes së mbeturinave në burim | % EF me shërbim të ndarjes ne burim | - | 10% | 20% | 30% | 40% | 50% |
| **2.4** | Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese | % e riciklimit te plastikës, letres, kartonit, qelqit dhe metalit. | 0% | 5% | 10% | 20% | 30% | 40% |
| **2.5** | Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese | % e riciklimit te mbeturinave | 0% | 5% | 10% | 20% | 30% | 40% |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ushqimore dhe mbeturinave tjera biodegraduese | | | | | | |
| **2.6** | Ndërtimi i oborrit riciklues për të ricikliueshmet jodegraduese | Oborri riciklues është ndertuar | | | 1 | | | |
| **2.7** | Zgjerimi i skemës lokale të kompostimit | Skema lokale e kompostimit është zgjeruar | | | 1 | | | |
| **2.8** | Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të reciklueshme jo degraduese | Operatori është kontraktuar | | | | 1 | | |
| **2.9** | Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese | Operatori është kontraktuar | | | | 1 | | |
| **2.10** | Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit | Studimi i fizibilitetit është zbatuar | | | 1 | | | |
| **2.11** | Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit | Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim | | | | 1 | | |
| **2.12** | Caktimi i lokacionit të deponisë së MND | Lokacioni i deponisë të MND është përcaktuar dhe procedurat administrative janë zbatuar | | 1 | | | | |
| **2.13** | Studimi i fizibilitetit per modelin e operimit te grumbullimit, transportit dhe riciklimit te MND nw komune. | Studimi i fizibilitetit është zbatuar | | | 1 | | | |
| **2.14** | Rehabilitimi i qendrës së riciklimit të MND | Qendra është rehabilituar | | | | 1 | | |
| **2.15** | Kontraktimi i operatorit të licencuar për MND | Operatori është kontraktuar | | | | 1 | | |

## Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Parashkimiet demografike në tabelën e mëposhtme janë marrë nga ASK dhe janë të ndara në zonën urbane dhe rurale.

**Tabela 25: Parashikimet demografike të popullatës**

| Vendbanimi | Numri i popullatës | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Qyteti (banorë) | 5,767 | 5,827 | 5,887 | 5,948 | 6,010 | 6,073 |
| Zona ruarle (banorë) | 34,723 | 35,084 | 35,448 | 35,816 | 36,189 | 36,565 |
| Total banorë | 40,490 | 40,911 | 41,335 | 41,764 | 42,199 | 42,638 |

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave dhe kompozicionit të tyre është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave.

**Tabela 26: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave**

| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Popullata në zonën urbane | 5,767 | 5,827 | 5,887 | 5,948 | 6,010 | 6,073 |
| Gjenerimi për kokë banori ZU(2%) | 264 | 269 | 274 | 280 | 285 | 291 |
| Gjenerimi i mbeturinave ZU | 1,522t | 1,569 t | 1,617 t | 1,666 t | 1,717t | 1,770 t |
| Popullata në zonën rurale | 34,723 | 35,084 | 35,448 | 35,816 | 36,189 | 36,565 |
| Gjenerimi për kokë banori ZR | 264 | 269 | 274 | 280.24 | 285.84 | 291.56 |
| Gjenerimi i mbeturinave ZR | 9,169 t | 9,450t | 9,739 t | 10,037 t | 10,344t | 10,660t |
| Gjenerimi vjetor i mbeturinave | 10,692t | 11,019t | 11,356 t | 11,703t | 12,062t | 12,431t |

**Tabela 27: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit**

| | Fraksioni | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| % | Letër dhe karton | 7.80% | 8% | 9% | 9.2% | 9.3% |
| | Qelq | 2.32% | 2.5 | 2.5 | 3 | 3 |
| | Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat | 54.52% | 52 | 50 | 50 | 49 |
| | Tekstil dhe veshjet | 6.4%(Peja) | 6 | 5.5 | 5 | 4 |
| | Pllastika | 12.41% | 13 | 13 | 14 | 14 |
| | Metal | 1.11% | 1 | 1 | 1 | 1 |
| | Të tjera | 15.44% | 17.5 | 19 | 17.8 | 19.7 |
| ton | Letër dhe karton | 761.18 t | 780.7 t | 878.28t | 897.8t | 907.55t |
| | Qelq | 226.40t | 243.96t | 243.96t | 292.76t | 292.76t |
| | Mbeturina bio-degraduese[9] | 5320.44t | 5088.56t | 4892.85t | 4892.85t | 4794.99t |
| | Tekstil dhe veshjet | 626.28t | 587.14t | 538.21t | 489.28t | 391.42t |
| | Pllastika | 1214.40t | 1272.14t | 1272.14t | 1369.99t | 1369.99t |
| | Metal | 107.64t | 97.85 | 97.85t | 97.85t | 97.85t |
| | Të tjera | 1510.91t | 1712.49t | 1859.28t | 1741.85t | 1927.78t |

[9] Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të riciklueshme jodegraduese si letra, plastika, qelqi dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

| Tabela 28: Caqet e riciklimit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Fraksioni | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Të riciklueshmet jo-degraduese % | 5% | 10% | 20% | 30% | 40% |
| Të riciklueshmet jo-degraduese (ton) | 223.26t | 469.71t | 978.57t | 1467.85t | 1996.28t |
| Të riciklueshmet biodegraduese % | 5% | 10% | 20% | 30% | 40% |
| Të riciklueshmet biodegraduese (ton) | 266.02t | 508.85t | 978.57t | 1467.85t | 1917.99t |

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat do të zbatoj studimin e gjenerimit dhe kompozicionit si dhe një **studim të fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit**.

**Avancimi i sistemit të ndarjes, grumbullimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale:**

- Zgjerimi i shërbimit të ndarjes së mbeturinave në burim:

Komuna e Klinës është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale si mënyrë për të zbutur presionin mjedisor nga deponimi eksesiv si dhe zhvilluar ekonominë qarkore. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mund të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë si dhe me kontejner të përbashkët
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë si dhe me kontejner të përbashkët
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastrukturës ricikluese, modelit të operimit e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga studimi i fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim jepen caqet e ndarjes së mbeturinave në burim:

| Tabela 29: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Mbulimi me shërbim (total) | 97.9% | 98% | 100% | 100% | 100% | 100% |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbulimi me ndarje në burim | 5% | 10% | 15% | 25% | 35% | 45% |

- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Klinës do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit si dhe të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**[10]. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e riciklueseve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikat më të mira të fushës.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh ndërtimin e qendrës rajonale të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të ndërtoj një oborr riciklues për sortimin e mbeturinave dhe kompresimin e tyre në ballo për ti tregtuar te ricikluesit final. Ky oborr mundet të financohet nga komuna apo nga kapitali privat. Komuna syno të bëjë partneritet me operatorin ekzistues publik apo ndonjë riciklues privat për të operuar me oborrin riciklues.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegraduese do të zbatoj:

- studimin e fizibilitetit
- ndërtimi i qendrës së riciklimit
- zhvillimi i partneritet me operatorin ekzistues apo ricikluesit privat për operimin e kësaj qendre
- Kontraktimin e operatorit

Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese:

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të ndarjes dhe riciklimit si dhe të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë së mbeturinave secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Megjithatë derisa të funksionalizohet kjo qendër komuna synon të ndërtoj një skemë lokale të kompostimit ku do të ricikloheshin

[10] Letra, plastika, metali, tekstili ,etj.

mbeturinat biodegraduese të komunës duke filluar me mbeturinat nga parqet, hapësirat publike dhe tregjet dhe duke shtuar sistemit edhe mbeturinat tjera. Ndërtimi i kësaj qendre mundet të financohet nga komuna apo nga kapitali privat. Komuna synon të bëjë partneritet me operatorin ekzistues publik apo ndonjë riciklues privat për të operuar me këtë qendër.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MMPHI të cilët do të bëjën grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegraduese do të zbatoj:

- Studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- Ndërtimin e skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- Kontraktimin e operatorit publika apo privat për operimin me qendrën kompostuese
- Inspektimin e lokaleve gastronomike sa i përket zbatimit te kontrates per vajra mbeturinë
- Bashkimin me skemën rajonale të menaxhimit të mbeturinave biodegraduese

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:**

- Hapja e qendrës së pranimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Klinës planifikon të hap **qendrën e pranimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e kësaj qendre komuna do të do ta caktoj lokacionin e përshtatshëm për këtë qëllim.

Në këtë objekt qytetarët do të mund të dërgojnë artikujt e panevojshëm të tyre me sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të panevojshëm qytetarët munden të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna do të zbatoj një **studimi të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës përmes së cilit do të analizohet dhe do të vendoset se a do ta menaxhoj vetë këtë qendër komuna apo ta angazhoj një operator privat.

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:**

Ligji e mban përgjegjëse komuna për menaxhimin e MND përfshi vendosjen e sisstemit të menaxhimit. Komuna sipas ligjit: e cakton lokacionin e deponisë; e kontrakton shërbimin me

operator të licencuar; i cakton tarifat e shërbimit. Ndërtuesit (gjeneruesit) e MND kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar (qendra).

Komuna në lidhje me MND do të organizoj shërbimin në dy faza. Në fazën e parë do të ndërtoj qendrën lokale të pranimit dhe riciklimit të MND ndërsa në fazën e dytë kur të funksionalizohet qendra rajonale do ti bashkoheet skemës.

Komuna ende nuk e ka caktuar lokacionin e deponisë por do ta bëjë këtë gjë gjatë vitit të parë të planit. Komuna do të zbatoj fizibilitetin për grumbullimin, transportin dhe rikuperimin e MND si dhe të operimit të qendrës. Ky studim do të bëjë edhe dizajnin e ndërtimit të qendrës. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbehen nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Komuna do të shqyrtojë bazën ligjore në mënyrë që të instaloj një sistem i cili në kuadër të lejes ndërtimore do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave qe do të deponohen dhe lokacioni ku do të dërgohen ato. Poashtu inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vende të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do ti dërgoj mbeturinat tek kjo qendër.

Pra sa i përket mbeturinave të ndërtim demolimit do të zbatohet:

- Studimi i fizibilitetit
- Ndërtimi i qendrës së riciklimit
- Caktimin e tarifave të shërbimit të MND
- Zhvillimi e partneritet me operatorin publika po ricikluesit privat për operimin e kësaj qendre
- Kontraktimin e operatorit.

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:**

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria pergjegjese për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave te papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetsorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatoret publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojne planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspekcioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspekcioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

**Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:**

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga therrtoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në zonën industriale në Drenas të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, therrëtoret dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do ti hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

**Aktivitet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:**

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

## 3.5 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qendrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektiv synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qendrueshmërisë financiare dhe të kostos.

**Tabela 30: Korniza strategjike e objektivit 3**

| Nr. | Aktiviteti / masa | Treguesi | Vlera bazë | Caku | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 3.1 | Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale | % e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale | 97,9% | 97,9% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| 3.2 | Revidimi i planit operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është hartuar dhe miratuar | Plani operativ është reviduar dhe miratuar | 1 | 1 | | | | |
| 3.3 | Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave | Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është zbatuar | - | - | 1 | - | - | - |
| 3.4 | Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave | Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin | - | - | 1 | - | - | - |
| 3.5 | Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave | Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave | | | | | | |

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

### Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjeroj ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj.

**Tabela 31: Strategjia e zgjerimit me shërbim**

| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mbulimi me shërbim** | 97.9% | 97,9% | 100% | 100% | 100% | 100% |

**<u>Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:</u>**

Komuna do të **revidoj planin ekzistues operativ** për riorganizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave i cili do të rezultoj në përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes:

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit:
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale

Plani ekzistues operativ ka qenë i bazuar në grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale mikse në deponi. Plani i ri operativ do të parasheh organizimin e shërbimit duke përfshi ndarjen e mbeturinave në burim sipas dinamikës së zgjerimit si dhe dërgimit të tyre në qendrat ricikluese përkatëse.

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësin dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmerr **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

### Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të kostos

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të kotos në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimzimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

**<u>Përmirësimi i efikasitetit të stafit</u>**

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela 35: Efikasiteti i stafit**

| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Stafi direkt | 38 | - | - | - | - | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Stafi indirekt dhe administrativ | 23 | - | - | - | - | - |
| Amvisëritë (EF) e shërbyera | 13,121 | - | - | - | - | - |
| Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer | 4.6 | - | - | - | - | - |

**<u>Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimi të naftës</u>**

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Hartimi i planit të ri operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Përforcimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

### Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qendrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qendrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna

## 3.6 Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit

Ky objektiv i referohet gjendjes aktuale në teren, ku për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave. Me qëllim të sanimit të gjendjes, komuna do të angazhohet që për çdo vitë të organizoj pastrimin e këtyre lokacioneve të ndotura me mbeturina dhe vendosjen e shenjave informuese dhe ndërgjegjësuese për mos hudhjen e mbeturinave.

**Tabela 33: Korniza strategjike e objektivit 4**

| Nr. | Aktiviteti / masa | Treguesi | Vlera bazë | Caku | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 4.1 | Pastrimi i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave | Pastrimi është realizuar | - | x | x | x | x | x |
| 4.2 | Fushatë informuese | Deponite ilegale reduktohen vazhdimisht | - | x | x | x | x | x |
| 4.3 | Inspektim dhe monitorim | Shqiptimi i gjobave | - | x | x | x | x | x |

## 3.7 Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM

| Tabela 34: Korniza strategjike e objektivit 5 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Aktiviteti / Masa | Treguesi | Vlera bazë | Caku | | | | |
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| 5.1 | Revidimi i RrK të MM | RrK e MM është reviduar | - | - | 1 | - | - | - |
| 5.2 | Emërimi i zyrtarit | Zyrtari i MM është emëruar | 1 | - | - | - | - | - |
| 5.3 | Rishikimi i procesit tariforë | Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar | - | - | 1 | - | - | - |
| 5.4 | Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale | Operatori i licencuar është kontraktuar | 1 | 1 | - | - | - | - |
| 5.4 | Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët po zbatohet | Programi zbatohet | - | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

### Emërimi i zyrtarëvë komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

### Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

### Kalimi i procesit tariforë

Komuna e ka kaluar procesin tariforë në vitin 2019 dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2023 ppër të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

### Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësis së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

# 4 Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë  sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera te pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuarpër emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente.

## 5 Plani financiar, veprimi dhe monitorimi

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuara përmes buxhetit të komunës, bashkëfinancimit me komunat tjera apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

**Tabela 35: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi"**

| Masat dhe aktivitetet | Njësiti përgjegjës | Afati i implementimit dhe buxheti | | | | | 2023 - 2027 | Burimi i financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | | |
| Riorganizimi i shërbimit | | | **20,000** | **75,000 €** | | | **95,000 €** | |
| o Plani i riorganizimit të shërbimit | DSHP | | *20,000* | | | | ***20,000 €*** | Komuna |
| o Sigurimi i infrastrukturës matëse | DSHP | | | *75,000* | | | ***75,000 €*** | Donacion |
| Zbatimi i tarifave volumetrike | | | | **20,000 €** | | | ***20,000 €*** | |
| o Kalimi i tarifave PAYT (procesi) | DSHP | | | *5,000 €* | | | ***5,000 €*** | Komuna |
| o Azhurnimi i softuerit të faturimit | DSHP | | | *15,000 €* | | | ***15,000 €*** | Komuna |
| o Zbatimi i tarifave PAYT | KRM | | | x | | | | KRM |
| Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset | | | | **5,000 €** | | | **5,000 €** | |
| o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal | DSHP | | | *5,000 €* | | | ***5,000 €*** | Komuna |
| o Pakoja e lehtësimeve fiskale | DSHP | | | x | | | | Komuna |
| Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante | DSHP | ***26,400 €*** | ***18,000 €*** | ***20,400 €*** | ***24,000 €*** | ***30,000 €*** | ***118,800 €*** | Komuna; Donacion |
| Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit | | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **5,000 €** | Komuna |
| o Fushata e vetëdijësimit | DSHP | *1,000 €* | *1,000 €* | *1,000 €* | *1,000 €* | *1,000 €* | **5,000 €** | Komuna |
| **Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave** | | **27,400 €** | **39,000 €** | **121,400 €** | **25,000 €** | **31,000 €** | **243,800 €** | |

**Tabela 36: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi"**

| Masat dhe aktivitetet | Njësiti përgjegjës | Afati i implementimit dhe buxheti | | | | | 2023 - 2027 | Burimi i financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave | DSHP | - € | 15,000 € | - € | - € | - € | 15,000 € | Komuna |
| Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave komunale | | 7,000 € | 52,000 € | 217,000 € | 47,000 € | 17,000 € | 340,000 € | |
| o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit | DSHP | € | *40,000* | € | € | € | ***40,000 €*** | Komuna |
| o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim | DSHP | *5,000 €* | *10,000 €* | *15,000 €* | *15,000 €* | *15,000 €* | ***60,000 €*** | Komuna / donatori |
| ○ Ndërtimi i oborrit riciklues | DSHP | € | € | *100,000 €* | € | € | ***100,000 €*** | Komuna / donatori |
| ○ Ndërtimi i skemës lokale të kompostimit | DSHP | € | € | *100,000 €* | € | € | ***100,000 €*** | Komuna / donatori |
| ○ Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve | DSHP | € | € | € | *15,000 €* | € | ***15,000 €*** | Komuna |
| ○ Kontraktimi i operatorit të biodegradueseve | DSHP | € | € | € | *15,000 €* | € | ***15,000 €*** | Komuna |
| o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra | DSHP | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | ***10,000 €*** | Komuna |
| o Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit | DSHP | € | € | € | € | *x* | | Komuna |
| Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale | | 40,000 € | 100,000 € | - 10,000€ | - € | - € | *150,000 €* | |
| o Studimi i fizibilitetit | DSHP | *40,000 €* | | € | € | € | ***40,000 €*** | Komuna |
| o Ndërtimi i qendrës së pranimit / ripërdorimit[11] | DSHP | € | *100,000 €* | € | € | € | ***100,000 €*** | Komuna / donatori |
| o Funksionalizimi i qendrës | DSHP | € | € | X | € | € | **€** | Komuna |
| o Kontraktimi i operatorit | DSHP | € | € | *10,000 €* | € | € | ***10,000 €*** | Komuna |
| Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi | | 3,500 € | 93,500 € | 203,500 € | *3,500 €* | *3,500 €* | 307,500 € | |
| o Caktimi i lokacionit | DSHP | € | € | € | € | € | | |
| o Kontraktimi i operatorit | DSHP | € | *10,000 €* | € | € | € | ***10,000 €*** | Komuna |
| o Caktimi i tarifave | DSHP | € | *10,000 €* | € | € | € | ***10,000 €*** | Komuna |
| o Studimi i fizibilitetit | | € | *70,000 €* | € | € | € | ***70,000 €*** | |

[11] Për komunën e Klinës, parashikohet ndërtimi i një qendre të ripërdorimit dhe të pranimit. Buxheti përfshinë infrastrukturën përcjellëse të qendrësi: rrethojën, kamerat, bazamentin, kontejnerët, peshorën etj.

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| o Ndërtimi i qendrës së MND[12] | DSHP | € | € | *200,000 €* | € | € | ***200,000 €*** | Komuna / donatori |
| o Inspektimi i zbatimit | | *3,500 €* | *3,500 €* | *3,500 €* | *3,500 €* | *3,500 €* | ***17,500 €*** | Komuna |
| o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit MND | DSHP | | | | | *x* | | Komuna |
| Menaxhimi i mbeturinave shtazore | | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***10,000 €*** | |
| o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat | | *x* | *x* | | | | | |
| o Inspektimi i zbatimit | | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | ***10,000 €*** | Komuna |
| Menaxhimi i mbeturinave medicinale | | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***2,000 €*** | ***10,000 €*** | |
| o Inspektimi i zbatimit | | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | *2,000 €* | ***10,000 €*** | |
| Fushatat e vetëdijësimit | | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **1,000 €** | **5,000 €** | Komuna |
| **Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi** | | **55,500 €** | **265,500 €** | **435,500 €** | **55,500 €** | **25,500 €** | **837,500 €** | |

**Tabela 37: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qendrueshme"**

| Masat dhe aktivitetet | Njësiti përgjegjës | Afati i implementimit dhe buxheti | | | | | 2023 - 2027 | Burimi i financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | | |
| Përmirësimi i cilësisë së shërbimit | | **141,000 €** | **294,000 €** | **214,000 €** | **148,000 €** | **164,000 €** | **961,000 €** | |
| o Përditësimi i planit operativ | DSHP/KRM | *35,000 €* | | | | | ***35,000 €*** | Komuna |
| o Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit | DSHP/KRM | | *100,000 €* | *20,000 €* | *20,000 €* | *20,000 €* | ***160,000 €*** | Komuna |
| o Furnizimi me shporta 120 l | DSHP/KRM | *40,000 €* | *20,000 €* | *20,000 €* | *40,000 €* | *40,000 €* | ***160,000 €*** | Komuna/KRM/Donatori |
| o Furnizimi me shporta 240 l | DSHP/KRM | *21,000 €* | *15,000 €* | *9,000 €* | *18,000 €* | *24,000 €* | ***87,000 €*** | Komuna/KRM/Donatori |
| o Furnizimi me kontejnerë 1.1 m3 | DSHP/KRM | *45,000 €* | *54,000 €* | *60,000 €* | *70,000 €* | *80,000 €* | ***309,000 €*** | Komuna/KRM/Donatori |
| ○ Furnizimi me kamionë | | | *100,000 €* | *100,000 €* | | | ***200,000 €*** | Komuna/KRM/Donatori |
| ○ Projekte tjera kapitale | | | *5,000 €* | *5,000 €* | | | ***10,000 €*** | Komuna |
| Përmirësimi i performancës operative dhe financiare | | ***3,000 €*** | ***23,000 €*** | ***3,000 €*** | ***3,000 €*** | ***3,000 €*** | ***35,000 €*** | |
| o Marrja përsipër e faturimit nga komuna | DSHP/KRM | | | x | | | | Komuna |
| o Zhvillimi i softuerit të faturimit | DSHP/KRM | | *20,000 €* | | | | ***20,000 €*** | Komuna |
| o Monitorimi I performancës | DSHP/KRM | *3,000 €* | *3,000 €* | *3,000 €* | *3,000 €* | *3,000 €* | ***15,000 €*** | Komuna |

12 Fizibiliteti, rrethoja, , makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës.

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kampanja informative | OJU | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 5,000 € | Komuna |
| **Total objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore efikase dhe të qendrueshme“** | | **145,000 €** | **318,000 €** | **218,000 €** | **152,000 €** | **168,000 €** | ***1,001,000 €*** | |

| **Tabela 38: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masat dhe aktivitetet | Njësiti përgjegjës | Afati i implementimit dhe buxheti | | | | | 2023 - 2027 | Burimi i financimit |
| | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | | |
| Eleminimi i deponive ilegale | DSHP | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *25,000 €* | Komuna |
| Inspeksioni dhe masat detyruese | Inspektorati | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *5,000 €* | *25,000 €* | Komuna |
| Fushatat informative | DSHP | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 1,000 € | 5,000 € | Komuna |
| **Total objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“** | | **11,000 €** | **11,000 €** | **11,000 €** | **11,000 €** | **11,000 €** | **55,000 €** | |

| **Tabela 39: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masat dhe aktivitetet | Njësiti përgjegjës | Afati i implementimit dhe buxheti | | | | | 2023 - 2027 | Burimi i financimit |
| | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | | |
| Revidimi i RrK të MM | DSHP | | 10,000 € | | | | **10,000 €** | Komuna |
| Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit | DSHP | | | | | | **0 €** | Komuna |
| Rishikimi i procesit tariforë | DSHP | | 10,000 € | | | | **10,000 €** | Komuna / KRM |
| Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK | DSHP | 10,000 € | | | | | **10,000 €** | Komuna |
| Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve | DSHP | 35,000 € | 35,000 € | 35,000 € | 35,000 € | 35,000 € | **175,000 €** | Komuna |
| **Total objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“** | | **45,000 €** | **55,000 €** | **35,000 €** | **35,000 €** | **35,000 €** | **205,000 €** | |

| **Tabela 40: Përmbledhje e buxhetit për zbatimin e PKMM** | | |
|---|---|---|
| Masat dhe aktivitetet | Afati i implementimit dhe buxheti | **2023 - 2027** |

| | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave | 27,400 € | 39,000 € | 121,400 € | 25,000 € | 31,000 € | **243,800 €** |
| Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi | 55,500 € | 265,500 € | 435,500 € | 55,500 € | 25,500 € | **837,500 €** |
| Total objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore efikase dhe të qendrueshme“ | 145,000 € | 318,000 € | 218,000 € | 152,000 € | 168,000 € | ***1,001,000 €*** |
| Total objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“ | 11,000 € | 11,000 € | 11,000 € | 11,000 € | 11,000 € | **55,000 €** |
| Total objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“ | 45,000 € | 55,000 € | 35,000 € | 35,000 € | 35,000 € | **205,000 €** |
| **Total buxheti për zbatimin e PKMM** | **283,900 €** | **688,500 €** | **820,900 €** | **278,500 €** | **270,500 €** | **2,342,300 €** |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

# PLANI
# I
# PUNËS SË KKSB-së PËR VITIN 2023

Klinë – 2023

# Hyrje

Në komunën tonë për vitin 2023, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), funksionin e tij bazon në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra e themelimit, përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi.

Në Planin Vjetor të Punës së KKSB-së përcaktohen objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrative për KKSB-në.

Roli i KKSB-së në komunën tonë ka rëndësi të veçantë sepse identifikon dhe mbledh shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.

Bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSB duhet të mbaj së paku gjashtë (6) mbledhje gjatë vitit, KKSB-ja mund të mblidhet edhe me shpesh në bazë të nevojave dhe kërkesave të anëtareve të saj. Në këto mbledhje shqyrtohen probleme të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve.

**1**

| Nr. Ren. | **OBJEKTIVAT** | **AKTIVITETET** | **Bartësit e aktiviteteve** | **Rezultatet e pritura** | **Afati kohor** | **Burimet financiare** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | -Gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës.<br>-Iniciativat e harmonizuara të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjidhjen e problemeve të sigurisë të çdo komuniteti në komunë tonë. | Planit i punës së KKSB-së. | Anëtarët e KKSB-së. | -Iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve për siguri në Bashkësi. | Janar- shkurt | Pa kosto financiare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | -Monitorimi në vazhdimësi gjendjen e sigurisë në të gjithë territorin e komunës;<br>-Vetëdisimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet si dhe identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike. | - Organizimi i së paku 6 mbledhjeve të rregullta të KKSB-së<br>- Organizimi i 12 takimeve me qytetar në lokalitete.<br>Takime me KKSB- të të Komunave fqinje. | Anëtarët e KKSB-së Policia. | -Identifikohen brengat dhe shqetësimet e qytetarëve për sigurinë publike. | Në Vazhdimësi. | 8.000 |
| 3 | -Siguria në shkollat fillore dhe ato të mesme.<br>-Zgjerimi i rrjetit të kamerave egzistuese.<br>Rregullimi i pjerrinave në shkolla.<br>-Siguria e nxënësve në trafik.<br>-Vendosja e kamerave të stacioni i autobusve.Rruga "Skënder Rexhepi".<br>- Ndriçimi i rrugëve në afërsi të shkollave në zonat rurale,(Gremnik).<br>Largimi i deponive të egra.<br>- Ndërtimi i trotuareve në afërsi të shkollave aty ku mungojnë.<br>-Vendosja e shenjave sinjalizuese në rrugët në afërsi të shkollave.<br>- Mbyllja e lokaleve në afërsi të shkollave të cilat nuk janë në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi ;<br>-Ndalimi i shitjes dhe shërbimit me pije alkoolike personave të moshës jomadhore. | Mirëmbajtja e Qendrës monitoruese, Kamerave dhe rrjeteve.<br>-Patrullimi i rregullt i Policisë, posaçërisht gjatë orarit të fillimit dhe mbarimit të orarit mësimor, vendosja e barrierave të komunikacionit në afërsi të shkollave, mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla nga ana e Policisë lidhur me sigurinë në komunikacion, raportimi i DA-së mbi gjendjen e sigurisë. | Policia e Kosovës.<br>Kuvendi Komunal dhe Drejtoria e Arsimit.<br><br>Drejtoria e Inspektoratit.<br><br>Drejtoria e Arsimit. | Minimizimi i incidenteve mes nxënësve;<br><br>Parandalimi i akteve joligjore.<br><br>Siguri në nivel më të lartë në vendbanimet në përgjithësi; | Vendosja e kamerave do të përfundoj në ketë vit.<br>Vazhdon ndërtimi i trotuareve.<br>Ka filluar mbyllja e lokaleve të natës që operojnë pa dokumentacion e nevojshëm<br><br>Vazhdon 2023. | Buxheti Komunal |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | -Zgjerimi dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësira publike në rrugët kryesore në qytet.<br>- Vendosja e shkallëve emergjente dhe pjerrinave në objekte. | -Realizimi i projektit për vendosjen e kamerave shtesë<br>- Kushtëzimi i lejeve për ndërtime nga Drejtoria e Urbanizmit | Komuna e Klinës DSHPE..<br><br>Drejtoria e Urbanizmit. | -Ngritja e Sigurisë së përgjithshme publike. | Gjatë tërë vitit. | |
| 5 | -Vetëdisimi i të rinjve për mbrojtje nga dukuritë negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (rreziku nga përdorimi i narkotikëve) me theks të veçantë në shkollat fillore dhe hapësira të shkollave të mesme.<br>-Informimi i nxënësve për dhënien e ndihmës së parë. | -Mbajtja e ligjëratave në shkollat e Komunës nga ekspertët e Mjekësisë, të specializimeve përkatëse. | KKSB, DA. DSHMS, Kryqi i Kuq, OJQ-të. | -Ngitja e vetëdijesimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve, dhënies së ndihmës së parë. | | Pa kosto buxhetore |
| 6 | -Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore.<br>Siguria e nxënësve në trafik .<br>-Parandalimi i bullizmit në shkollat e komunës së Klinës. | -Mbajtja e ligjëratave në shkollat e Komunës së Klinës. | KKSB,DA, DSHMS, Kryqi i Kuq, QPS, Policia e Kosovës, OJQ-të. | -Ngitja e vetëdijesimit nga rreziku i trafikimit me qenie njerëzore, dhe ngitja e bashkëpunimit ndër institucional në luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje. | Gjatë tërë vitit 2023. | Pa kosto buxhetore |
| 7 | Funksionalizimi, organizimi dhe riorganizimi i Këshillave në shkollat e Komunës , monitorimi i organizimit të Këshillave. | -Riaktivizimi i Këshillit të prindërve në nivel komunal;<br>-Formimi i Këshillave të nxënësve në shkolla | KKSB, DA. | -Ngritja e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e sigurisë publike dhe | | Pa kosto buxhetore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -Bashkëpunimi me këshillat e prindërve. | | minimizimi i incidenteve mes tyre. | | |
| 8 | - Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda. | -Kontrollimi dhe patrullimi i policisë në lokale të natës, lojërave të fatit dhe monitorimi i zbatimit të orarit të punës së bizneseve. | KKSB, Drejtoria Komunale e Inspektoratit, Policia e Kosovës. | -Zbatimi i Rregullores Komunale për orarin e punës së bizneseve, Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve etj. | Gjate tërë vitit 2023. | Pa kosto buxhetore |
| 9 | -Hartimi i Planeve të mbrojtjes nga zjarri nëpër shkolla, pajisja me mjetet e nevojshme për shuarje të zjarrit ;<br>-Verifikimi dhe servisimi i aparateve të fikjes së zjarrit,<br>- Trajnimi i stafit. | Sigurimi i vend parkimeve;<br><br>Projekti për servisim dhe trajnim; | DU<br>DSHPE<br>DA | Rritja e sigurisë në shkolla;<br>Menaxhimi më efikas i emergjencave eventuale; | Sipas afateve ligjore. | Pa kosto buxhetore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | -Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.<br><br>-Vlerësimi dhe pajisja me mjetet e nevojshme për Njësinë e Zjarrfikësve.<br><br>-Organizimi i kampanjave informuese vetëdijesuese për parandalimin e zjarreve.<br><br>-Organizimi i sesioneve informative për mbrojtje nga pickimi i rriqrave.<br><br>-Identifikimi i zonave të rrezikshme në trafik ( ku ndodhin më shumë aksidentet etj. | - Projektet për reagim ndaj situatave emergjente.<br>-Projekti për furnizim me Mjete.<br>-Zgjidhja e problemit të kafshëve të braktisura-qentë endacak.<br>**-Fushata sensibilizuese :**<br>1. lëmi e shëndetit publik,<br>2.mbrojtjes nga zjarri,<br>3. vetëdijesimi qytetarëve për pagesat e obligimeve për shfrytëzimin e shërbimeve të mbeturinave dhe ujit.<br>-Menaxhimi i mbeturinave dhe eliminimi i deponive joformale.<br>-Mbajtja e ligjëratave në shkolla mbi rëndësinë e marrjes së masave preventive shëndetësore;<br>Fletëpalosjet informuese si dhe takimet me komunitetin. | Komuna<br>Policia<br>DSHPE<br>DSHMS<br>DI<br>DBPZHR<br>FSK-ja.<br><br>Përfaqësuesit e fshatrave.<br><br>Instituti Kombëtar shëndetit publik. | -Ngritja e sigurisë së shëndetit të qytetarëve-minimizimi i rasteve të pickimit dhe viktimave.<br>-Ngritja e nivelit të vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e shëndetit ,<br>mbrojtjen nga zjarri ,vërshimet dhe rreziqe të tjera. | Gjatë tërë vitit 2023. | Buxheti Komunal |
| 11 | -Siguria në Komunikacion (Patrullimi i PK, shenjëzimi dhe vendosja e tregueseve të komunikacionit aty ku mungojnë dhe është e nevojshme | -Vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale në komunikacion. | KKSB,<br>EVSB,<br>DSHP. | Ngitja e sigurisë së përgjithshme publike, Zvogëlimi i rasteve të incidenteve në komunikacion. | Sipas prioriteteve të investimeve kapitale. | Buxheti Komunal |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | -Mbrojtja nga zjarrvënësit dhe parandalimi i prerjes së pakontrolluar të pyjeve,<br>-Parandalimi i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit. | -Mbajtja e takimeve me qytetar për rëndësinë dhe mbrojtjen e ambienteve jetësore , natyrës.<br>Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve. | KKSB, DBPZHR, Policia e Kosovës, Drejtoria e Inspektoratit dhe OJQ-të. | -Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve për kujdesin dhe mbrojtjen e natyrës. | Gjatë tërë vitit 2023. | |
| 13 | Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes përmirësimit të infrastrukturës . | - Mirëmbajtësja e infrastrukturës së qytetit<br>- Mirëmbajtja e hapësirave të varrezave të Qytetit dhe të vendbanimeve tjera si dhe të varrezave të dëshmorëve.<br>- Zgjerimi i rrugëve në drejtim të fshatrave , për nevojat e banorëve dhe qasjes më të lehtë të shërbimeve emergjente dhe Policisë. | DSHP Drejtoria e urbanizmit /Drejtoria e Inspektoratit.. | -Implementimi i Planit Rregullues dhe atij Urbanistik<br>-Implementimi i Rregullores Komunale për varrezat; | Sipas projekteve me prioritet. | Buxheti Komunal |
| 14 | -Respektimi i të drejtave të njeriut, Parandalimi i lypsarëve me theks të veçantë e fëmijëve, kryesisht nga radhët e minoriteteve.<br><br>-Përshtatja e infrastrukturës për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. | - Respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi (pakicave dhe personave të margjinalizuar;<br>Bashkëpunimi me QPS, OQ dhe OJQ për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike (njoftimi mbi të drejtat për asistencë sociale, pension invalidor etj. | -Zyra Komunale për Komunitete, Zyra Komunale për Barazi Gjinore, QPS, OJQ-të. | Vetëdijesimi i pakicave mbi të drejtat e tyre.<br><br>-për sigurinë e këmbësoreve, në veçanti të personave me nevoja të veçanta. | Gjatë tërë vitit 2023. | Pa kosto financiare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - Kushtëzimi i lejeve për ndërtime nga Drejtoria e Urbanizmit. | | | | |

Miratuar nga KK më datë:

**K r y e s u e s i i K u v e n d i t,**
**Fadil Gashi**

**Nr.__________________/2023**
**Klinë, më ____________________/2023**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

# P R O J E K T

# RREGULLORE NR. __/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E KLINËS

Klinë, Janar 2023

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7)

dhe nenit 80 të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 10 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinë, nr.01-110-1232/2010 te miratuar me datën 31.03.2010, Kuvendi i Komuness e Klines në mbledhjen e mbajtur më ___/___/2023, miraton këtë:

# RREGULLORE NR. ____/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E KLINËS

## DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

**Neni 1**
**Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e Komunës së Klinës, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

**Neni 2**
**Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet:
   1.1. në territorin e Komunës së Klinës, për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, dhe
   1.2. ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave në/dhe për territorin e Komunës së Klinës.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kategoritë e mbeturinave të përjashtuara sipas Ligjit për Mbeturina dhe ligjeve dhe akteve të veçanta.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 3**
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Administrata komunale -** të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
1.2. **Deponi -** vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;
1.3. **Gazeta Zyrtare –** Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
1.4. **Impiant -** objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;
1.5. **Komunë -** Komuna e Klinës, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
1.6. **Konsumator -** personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime te caktuara sipas Ligjit për mbeturina dhe kësaj rregulloreje;
1.7. **Kompostim -** është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;
1.8. **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Klinës;
1.9. **Kuvend -** Kuvendi i Komunës së Klinës;
1.10. **Ligj/Ligji për Mbeturina -** Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022);
1.11. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008),
1.12. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
1.13. **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
1.14. **Magazinim -** ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim.
1.15. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedh;
1.16. **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
1.17. **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën 1 të Ligjit për mbeturina;

PROJEKTRREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.18. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;

1.19. **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4, të Ligjit për mbeturina;

1.20. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

- 1.20.1. mbeturina inerte qe nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- 1.20.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

1.21. **Mbeturinat komunale** - nënkupton:

- 1.21.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet;
- 1.21.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;
- 1.21.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.

1.22. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;

1.23. **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshire edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjate prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.

1.24. **Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;

1.25. **Mbeturina të vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, mobiliet, dhe mbeturina tjera të vëllimshme, përmasat e të

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

cilave e pengojnë përdorimin e zakonshëm të grumbullimit, transportimit dhe largimit dhe kërkohet që kjo të bëhet në mënyrë të veçantë;

1.26. **Mbledhja -** mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;

1.27. **Mbledhja e ndarë -** nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet ne mënyrë te ndare në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;

1.28. **Ministria -** Ministria përkatëse për mjedisin;

1.29. **Operatori** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, Ligjit për prokurimin publik dhe legjislacionin përkatës në fuqi është përzgjedhur nga organi kontraktues i Komunës për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave, brenda territorit të Komunës së Klinës;

1.30. **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Klinës;

1.31. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;

1.32. **Prodhuesi i mbeturinës -** çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;

1.33. **PKMM -** Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave;

1.34. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.35. **Riciklimi -** çdo operim te përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;

1.36. **Statut** - Statuti i Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 i miratuar me datën 31.03.2010;

1.37. **SMM** - Sektori/Njësia/Zyrtari përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, që vepron në kuadër të Drejtorisë së Sherbimeve Publike dhe Emergjente, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;

1.38. **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;

1.39. **Zotëruesi i mbeturinës -** prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën;

2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

## SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 4
### Parimet për menaxhimin e mbeturinave

1. Mbeturinat në Komunën e Klinës, mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina, këtë rregullore, PKMM si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.
2. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Klinës bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për mbeturina, si në vijim:
   - 2.1. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;
   - 2.2. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;
   - 2.3. Parimi ku ndotësi paguan;
   - 2.4. Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;
   - 2.5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;
   - 2.6. Parimi i sigurimit financiar;
   - 2.7. Parimi për qasje të publikut në informata;
   - 2.8. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

### Neni 5
### Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Klinës, duhet të organizohet në atë mënyrë që të:
   - 1.1. mbulohet i tërë territorit të Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;
   - 1.2. bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;
   - 1.3. bëhet vlerësimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave;
   - 1.4. rishikimi i procesit tarifor për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;
   - 1.5. përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;
   - 1.6. parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.
   - 1.7. parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm a rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;
   - 1.8. ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi, dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.9. sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;

1.10. përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikat qeveritare dhe PKMM;

1.11. zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t’i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;

1.12. zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore, me përfshirjen e grupeve të cenueshme;

1.13. parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut, nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;

1.14. rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

1.15. përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;

1.16. realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis.

## Neni 6
## Reduktimi, Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Klinës, duhet të organizohet në atë mënyrë që mbeturinat të:

1.1. **Reduktohen** - prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;

1.2. **Ripërdoren** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitimin e energjisë;

1.3. **Riciklohen** - mbeturinat, kur është e mundur të riciklohen me qëllim që të përdorën si lëndë e parë sekondare.

## Neni 7
## Trajtimi i barabartë

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Operatori duhet të trajton në mënyrë të barabartë të gjithë konsumatorët, prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturivae dhe nuk mund të diskriminojë asnjë person në cilëndo prej bazave të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

## PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 8
### Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave

1. Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave, siç përcaktohet në Ligjin për mbeturina, janë:
   1.1. Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (Strategjia), e cila propozohet nga ministria dhe miratohet nga Qeveria, për periudhën kohore dhjetë (10) vjeçare, dhe rishqyrtohet së paku në pesë (5) vjet;
   1.2. Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga ministria për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevoje;
   1.3. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM), i cili nxirret nga komuna në pajtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje;
   1.4. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesi i mbeturinave i cili nxirret nga pronari i pajisjes për periudhën pesë (5) vjeçare;
   1.5. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga operatori për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga operatorët për periudhën pesë (5) vjeçare.

### Neni 9
### Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave

1. PKMM nxirret nga Komuna, dhe duhet të:
   1.1. jetë i harmonizuar me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
   1.2. nxirret për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevoje;
   1.3. hartohet në bashkëpunim me operatorët dhe në një proces publik dhe gjithëpërfshirës me pjesëmarrje të qytetarëve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme joqeveritare;
   1.4. miratohet nga Kuvendi.
2. Përmbajtja e PKMM, duhet të jetë në pajtim me paragrafin 6 të Nenit 10 të Ligjit për mbeturina.
3. Sipas nevojës dhe në marrëveshje, Komuna e Klinës së bashku me një a më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët lokal për menaxhimin e mbeturinave.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

4. Përgjegjës për zbatimin e PKMM janë organet komunale të përcaktuara në këtë rregullore dhe në PKMM.

**Neni 10**

**PKMM dhe masat për parandalimin, reduktimin, dhe riciklimin e krijimit të mbeturinave**

1. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për parandalimin dhe reduktimin e krijimit të mbeturinave, për të ndikuar që gradualisht të ndryshohen shprehitë e konsumatorëve për prodhim të mbeturinave.
2. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
   - 2.1. rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e parandalimit dhe reduktimit të prodhimit të mbeturinave;
   - 2.2. përgatitja e ambientit për futjen graduale të tarifave volumetrike për të dekurajuar prodhimin e mbeturinave;
   - 2.3. promovimi dhe fasilitimi i skemës së kompostimit individual;
   - 2.4. promovimi përmes politikave të favorshme të hapjes së stacioneve rimbushëse dhe dyqaneve "zero mbeturina";
   - 2.5. përgatitja e ambientit, dhe në koordinim me Qeverinë, për largimi nga tregu i artikujve një përdorimesh të tillë si qeset plastike dhe paketimeve një përdorimesh;
   - 2.6. promovimi dhe facilitimi i restoranteve dhe objekteve gastronomike "zero mbeturina" për të reduktuar mbeturinat;
   - 2.7. futja e stimujve të përshtatshëm fiskal, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjektet me "zero mbeturina".

**3.** Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale por edhe kategorive tjera të mbeturinave, me theks të veçantë në mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat e veçanta.

4. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
   - 4.1. aktivitet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave;
   - 4.2. përgatitjet për sigurimin e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim dhe për hapjen e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit të produkteve të hedhura;
   - 4.3. analizat e kompozicionit të mbeturinave dhe potencialit të mbeturinave që mund të riciklohen, dhe shikimi i mundësisë për hapjen e qendrës lokale/rajonale të kompostimit dhe për hapjen e qendrës për rikuperimin e mbeturinave nga ndërtim dhe rrënimi;
   - 4.4. përgatitja e ambientit për zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe zotëruesit të mbeturinave.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 11
### Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Sektori/Njësia/Zyrtari përkatëse për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), vepron në kuadër të Drejtorisë Drejtorise se Sherbimeve Publike dhe Emergjente.
2. SMM bashkëpunon me ministrin dhe me palët e interesuara për hartimin e dokumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe zbaton politikat në fushën e mbrojtjes, të përcaktuara nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

### Neni 12
### Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për menaxhimin e mbeturinave

1. SMM, ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
   - 1.1. planifikon, rregullon, udhëheqë dhe të zbaton aktivitete për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të komunës së Klinës;
   - 1.2. harton, siguron dhe raporton zbatimin e PKMM, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
   - 1.3. udhëzon dhe mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale;
   - 1.4. planifikon buxhetin për funksionimin e duhur të menaxhimit të mbeturinave;
   - 1.5. propozon tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare;
2. SMM, sipas nevojës dhe në bashkëpunim me dhe përmes operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, përcakton:
   - 2.1. vendndodhjen e pikave të grumbullimit të mbeturinave;
   - 2.2. llojin, numrin, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për;
   - 2.3. lokacionin për vendosjen e kontejnerëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre;
   - 2.4. kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, të mbeturinave;
   - 2.5. orarin dhe dinamikën për mbledhjen e mbeturinave, dhe sipas nevoje autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë;
   - 2.6. mënyrat për transportim të mbeturinave komunale;

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

2.7. siguron, brenda afatit të caktuar, kontejnerë të veçantë për hedhjen e mbeturinave gjatë ndërtim-rrënimit, mbeturinave të vëllimshme dhe të caktojë tarifën e këtij shërbimi në bazë të zbrazjes së kontejnerëve.

3. SMM, përkujdeset që të themelohet komisioni i ankesave në kuadër të administratës komunale, i cili do të shqyrton ankesat e konsumatorëve sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, tarifave dhe mënyrës së arkëtimit të tyre.

**Neni 13**
**Të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave**

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave dhe çdo konsumator ka të drejtë:
   1.1. qasjeje në shërbimet publike për hedhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;
   1.2. të informohet dhe të kërkojë informata për menaxhimin e mbeturinave
   1.3. të marrë pjesë dhe të kontribuojë në politikat për menaxhimin e mbeturinave;
   1.4. të bëjë ankesë, ndaj shërbimit të ofruar dhe të marrë përgjigje në ankesën e bërë.

**Neni 14**
**Detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave**

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
   1.1. të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave dhe të përditësojnë të dhënat në rastet e ndryshimit të adresës;
   1.2. të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;
   1.3. të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme);
   1.4. t'i respektojë rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe PKMM;
   1.5. të paguaj për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna;
   1.6. t'i hedhin mbeturinat e tyre në vende dhe sipas sistemit të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
   1.7. të bëjnë ndarjen e mbeturinave sipas sistemit të caktuar nga komuna, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre si dhe t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
      1.7.1. në shporta dhe kontejnerë të përcaktuar për atë lloj;
      1.7.2. në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj; ose
      1.7.3. te operatori;
   1.8. ta njoftojnë SMM kur prodhojnë mbeturina gjatë meremetimit apo rrënimit të objekteve dhe të largojnë këto mbeturina, nga hapësirat ose vendet publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

2. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave medicinale, janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi për trajtimin e këtyre mbeturinave dhe të përdorin sistemin e ndarjes së kontejnerëve dhe ti dorëzojnë ato mbeturina në vendet e caktuara për to.
3. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave, për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave, për të cilat sipas Ligjit për mbeturina, është e nevojshme të merret cilado nga lejet mjedisore, janë të detyruar të nxjerrin Planin për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Neni 11 të Ligjit për Mbeturina.

## AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 15
### Grumbullimi i mbeturinave

1. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë dhe në vendet e mbledhjes së mbeturinave të cilat caktohen nga Komuna.
2. Ndryshimi i vendndodhjes së vendeve të mbledhjes së mbeturinave dhe vendit të kontejnerëve, pa miratim të komunës, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 16
### Kontejnerët për mbeturina

1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbeturina.
2. Llojin, mënyrën, vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe publike, e cakton SMM, në bashkëpunim me operatorin.
3. Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e përbashkëta të banimit dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.
4. Kontejnerët për mbeturina duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme.
5. Kontejnerët, nëse paraqitet nevoja, duhet të kenë mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.
6. Personat juridik dhe fizik të amvisërive që marrin shërbimet derë me derë, sigurojnë kontejnerët sipas llojit dhe mënyrës që caktohet nga SMM.
7. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qellim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera, që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

8. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të parqeve, sheshe dhe në vende tjera, është e obliguar të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të kontejnerëve (koshave) për mbeturina.
9. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, duhet të përdorin sistemin e disa kontejnerëve për të edukuar fëmijët dhe nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.
10. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina, në sipërfaqe publike, kujdeset operatori.
11. Personat juridik dhe qytetarët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina dhe vendeve përreth tyre.

**Neni 17**
**Orari për mbledhjen dhe hedhjen e mbeturinave**

1. Komuna bën publike oraret e hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e orarit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ftohen të marrin pjesë personat juridik dhe fizik, OJQ-të dhe publiku i interesuar.
3. Secili person ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të hedhjes dhe largimit të mbeturinave.
4. Sistemimi dhe hedhja e mbeturinave, nga prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë ose në vendet e mbledhjes së mbeturinave dhe sipas orarit që ka caktuar komuna.
5. Kalimtarët, mbeturinat e çastit si ambalazhe të ndryshme, i hedhin vetëm në kontejnerët e vendosur në hapësira publike ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.
6. Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.
7. Hedhja e mbeturinave jashtë këtij rregulli, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Hedhja e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave te veçanta, mbeturinave industriale, mbeturinave inerte, mbeturinave medicinale, mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinave të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina komunale sipas Ligjit dhe nga kjo rregullore, duhet të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Komuna për këtë qëllim, dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

**Neni 18**
**Transportimi i mbeturinave**

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1. Transportimi i mbeturinave për në vendet e depozitimit bëhet nga komuna ose operatori.
2. Transportuesit e mbeturinave bëjnë transportimin e mbeturinave në bazë të kushteve të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës, në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes, sipas orarit dhe dinamikës për mbledhjen e mbeturinave të caktuar nga SMM, i cili bëhet publikë në ueb faqen e komunës.
4. Transportimi i mbeturinave në orët e pikut të aktiviteteve qytetare, është i ndaluar dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja apo rishpërndarja e mbeturinave gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.
6. Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.
7. Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në deponinë e destinuar, transportuesi duhet ta kthej mbeturinën në vendin ku është marrë dhe të njoftojë SMM.

**Neni 19**
**Deponitë e mbeturinave**

Deponimi i mbeturinave në Komunën e Klinës, në varshmëri të karakteristikave të mbeturinave, bëhet vetëm në deponitë e licencuara dhe të lejuara përkatëse si dhe sipas llojit përkatës të mbeturinave, që mund të jenë deponi për mbeturinat e rrezikshme; deponi për mbeturinat jo të rrezikshme; deponi të mbeturinave inerte, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për menaxhimin e deponive.

## OPERATORËT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 20**
**Operatorët për menaxhimin e mbeturinave**

1. Menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave, të cilët duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave mund të jenë institucionet, kompanitë publike ose private të regjistruara sipas ligjit, të cilët shërbimet për komunën për menaxhimin e mbeturinave e kryejnë në bazë të kontratës.
3. Organi kontraktues i Komunës, duke u bazuar në dispozitat e ligjit përkatës të prokurimit, mund të përcaktojnë të gjitha kushtet nevojshme për përzgjedhjen e operatorit për menaxhimin e

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

mbeturinave komunale, dhe mbeturinave: inerte, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe rrënimet, brenda territorit të Komunës së Klinës.

4. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 21
### Menaxhimi i mbeturinave me partneritet publiko-privat

Menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impianteve dhe objekteve për menaxhimi e mbeturinave mund të epet në formën e partneritetit publiko-privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 22
### Kontrata me operatorin

1. Kontrata me operatorin duhet të specifikoj, së paku:
   - 1.1. territorin ku kryhen shërbimet;
   - 1.2. mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
   - 1.3. specifikimin e pajisjeve për trajtim;
   - 1.4. çështjet tjera që kërkohen sipas Ligjit, këtë rregullore dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas Ligjit, kontratës, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi dhe përmbush të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të përcaktuar në Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

## KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

### Neni 23
### Kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave

1. Kategorite e konsumatorëve do te paguajnë fature mujore per shërbimin e grumbullimit, transportimit, dhe deponimit te mbeturinave, si në vijim:
   - 1.1. Kategoria e konsumatorëve shtëpiak- amviserite do te paguajnë tarife fikse prej 6.5 € në muaj;
   - 1.2. Kategoria e konsumatorëve komercial/industrial;
     - 1.1.1. Nenkategoria e pare: veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do te paguajnë tarife fikse prej 7.5 € ne muaj;

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.1.2. Nënkategoria e dyte: subjektet e mesme deri te mëdha komerciale/industriale me kosto te ulet te shërbimit do te pagujne tarife fikse prej 12.00 € ne muaj;

1.1.3. Nënkategoria e trete: subjektet e mesme deri te mëdha komerciale/industriale me kosto te moderuar te shërbimit do te paguajnë tarife fikse prej 15.00 € ne muaj;

1.1.4. Nënkategoria e katërt: subjektet e mesme deri te mëdha komerciale/industriale me kosto te larte te shërbimit do te paguajte tarife fikse prej 35.00 € ne muaj.

1.3. Kategoria e konsumatorëve Institucional do te paguaje tarife fikse prej 14.00 € zbrazje per kontinier 1.1m³.

2. SMM në bashkëpunim me operatorin krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë listën e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kategorizimin dhe nënkategorizimin e tyre.

**Neni 24**
**Faturimi i mbeturinave**

1. Faturimi mbeturinave bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet konsumatorit, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues. Konsumatori obligohet që të paguajë faturën e mbeturinave për çdo muaj të vitit.)

2. Konsumatori obligohet të paguaj faturën e mbeturinave, në katër këste brenda vitit, si më poshtë:

2.1. Kësti i parë janar – mars;

2.2. Kësti i dytë prill – qershor;

2.3. Kësti i tretë korrik- shtator;

2.4. Kësti i katërt tetor – dhjetor.

3. Konsumatorët paguajnë tarifat për menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga Kuvendi.

4. SMM e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritë koston e shërbimeve, dhe i rekomandon Kuvendit ndryshimet që i sheh të nevojshme.

5. Konsumatorët mund të parapaguajnë tarifat për gjashtë muaj ose një vit. Nëse konsumatorët paguajnë në këtë mënyrë tarifat kanë zbritjet si në vijim:

5.1. 5% për qind për konsumatorët që parapaguajnë tarifat për gjashtë muaj; dhe

5.2. 10% për qind për konsumatorët që parapaguajnë tarifat për një vit.

## INFORMIMI, PROMOVIMI DHE RAPORTI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 25**
**Seanca/t vjetore për çështjet e menaxhimit të mbeturinave**

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, apo se paku në një seancë e diskuton në rend të ditës çështjet e menaxhimit të mbeturinave.
2. Në seancën/at vjetore ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen më menaxhimin e mbeturinave, si dhe paraqesin aktivitetet që janë ndërmarrë për realizimin e PKMM.
3. Në seancën/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave, ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile.
4. Seanca/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave organizohen në koordinim me SMM.

**Neni 26**
**Ditët e Komunës së pastër**

1. Nën patronatin e Kryetarit organizohen dhe mbahen "Ditët e Komunës së pastër".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës.
3. Kryetari, me vendim, cakton datat për "Ditët e Komunës së pastër", dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.

**Neni 27**
**Informimi dhe promovimi**

1. Komuna e Klinës është transparente ndaj palëve të interesuara për dhënien e informatave për menaxhimin e mbeturinave.
2. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Klinës, në bashkëveprim me SMM, përmes fushatave, ligjëratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës së Klinës, krijojnë një sistem të informimit për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe informata të tjera të cilat janë në interes të qytetarëve.
3. Organizatat e shoqërisë civile inkurajohen dhe përkrahen që të monitorojnë, promovojnë dhe informojnë për menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 28**

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.**

1. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Klinës, në bashkëveprim me SMM, shoqërinë civile dhe konsumatorët promovojnë konceptin e 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim) për të synuar që gradualisht në Komunën e Klinës të fillojë të ndarja e mbeturinave (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të ngritë vetëdijen e qytetarëve dhe bizneseve rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.
2. Masat për parandalimin dhe reduktimin e gjenerimit të mbeturinave duhet të përfshijnë instrumente ekonomike dhe politike të drejtuara për t'i ndryshuar shprehitë e konsumatorëve për gjenerim të mbeturinave.

**Neni 29**
**Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave**

1. SMM monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe harton raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për bashkëpunimin dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga SMM.
3. Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues, siç është përcaktuar në Nenin 58 të Ligjit për mbeturina.
4. Operatorët që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin Raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues. Raporti paraqitet në Komunë dhe në Ministri.
5. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të përmbajnë të dhënat për:
    5.1. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave;
    5.2. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare të përfituar në objektet për menaxhimin e mbeturinave;
    5.3. çështje tjera të rëndësishme.
6. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni plotësohet sipas Shtojcës VI. të Ligjit, dhe në pajtim me aktin nënligjor i cili rregullon kushtet dhe kriteret për raportimin për menaxhimin e mbeturinave.

## BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 30**
**Bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave**

Të gjitha njësitë përbërëse të komunës dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin e Ligjit, kësaj rregulloreje, legjislacionit në fuqi dhe PKMM-së.

**Neni 31**
**Bashkëpunimi ndër-komunal**

Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Klinës, kur është në interesin publik të tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, dispozitat e të cilit ligj vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 32**
**Bashkëpunimi me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile**

1. Organet dhe administrata komunale:
    1.1. bashkëpunojnë me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
    1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;
    1.3. mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

PROJEKTRREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

## MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

**Neni 33**
**Mbikëqyrja inspektive**

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuar me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t`i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësive të veta.
5. Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

**Neni 34**
**Inspektimi jashtë territorit të komunës**

Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjinden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Klinës.

**Neni 35**
**Kundërvajtjet**

1. Në territorin e Komunës së Klinës, për mosrespektim të dispozitave të Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina, dhe sipas gjobave të përcaktuara në këto nene, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara në këto nene personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës të personave juridik.

**Neni 36**
**Procedurat e ankesës**

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

**Neni 37**
**Veprat penale**

Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

**Neni 38**
**Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur**

1. Për tëre mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave, përgjigjet hedhësi i tyre.
2. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, ne pajtim me përgjegjësitë ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë Komuna, e cila siguron largimin e tyre.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 39**
**Përgjegjësia individuale**

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

**Neni 40**
**Procedura përmbarimore dhe gjyqësore**

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë procedura përmbarimore dhe gjyqësore nga njësitë përkatëse të komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 41**
**Buxhetimi**

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1. Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.
3. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet ne konsultime me palët.
4. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave te buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
5. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 42**
**Regjistri i deponive ilegale**

Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Klinës, sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.

**Neni 43**
**Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave**

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

**Neni 44**
**Zbatimi**

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Klinës, i nënshtrohen:
    1.1. SMM si dhe organet dhe administrata komunale;
    1.2. Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
    1.3. të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;

PROJEKTRREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.4. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;

2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve publike dhe/apo udhëheqësit të SMM.

3. Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara qe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive përkatëse.

4. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 45**
**Shfuqizimi**

Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunen e Klines, nr.01-06-966/2017 e miratuar më datën 24.02.2017.

**Neni 46**
**Publikimi**

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.

2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në "Gazetën Zyrtare".

**Neni 47**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.

3. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.

PROJEKTRREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS**

**K R Y E S U E S I,**
**Fadil GASH**

13.12.2022

01 466-41738/22

# KËRKESË

Data: 12.12.2022

Drejtuar: Kryetari I komunes se Klinës z. Zenun Elezaj

Lënda: Kërkesë për shfrytëzimin e parcelës

P-71011030- 00116-0, Zona Kadastrale Drenoc, Klinë

Parashtrues I kërkesës: Gjevdet Fejza Prebreza

Nr. Personal 1230639368

I nderuar,

Po e dorëzoj këtë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të parcelës me numër P-71011030-00116-0, zona kadastrale Drenoc me siperfaqe 3503 m2 e cila gjendet para parceles time me numer P-71011030-00117-3, parcelë në të cilën une kam dy shtëpitë në të cilat banoj me familje. Parcela gjendet para parceles time në komplet gjatësinë andaj më duhet shfrytëzimi I saj për pastrim nga shkurret, mbjellje të drunjve dekorativ, hapësirë gjelbruese.

Shprehem I gatshëm që në rast të dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele do jem I gatshëm të paguaj taksat sipas ligjeve në fuqi dhe që ta kthej prapë kurdo që kërkohet.

Poashtu zotohem në mirëmbajtjen në mos dëmtim të mjedisit brenda kësaj parcele.

Unë pres nga ju miratimin e kësaj kërkese pasi rregullimi I kësaj parcele na mundëson të jetojmë jetën më lehtë dhe më pastër.

Mbes me shpresë për miratimin e kërkesës sime për arsye të lartcekura.

Gjevdet Fejza Prebreza

__________ 049-439 700


00117-3
41
43
SHAIP REGJ
SHAIP REGJEPI

REPUBLIKA E KOSOVËS
LETËRNJOFTIM

РЕПУБЛИКА КОСОВО
ЛИЧНА КАРТА

REPUBLIC OF KOSOVO
IDENTITY CARD



Mbiemri / Презиме / Surname
PREBREZA
Emri / Име / Given name
GJEVDET
Datëlindja / Датум рођења / Date of birth
07.10.1965
Gjinia / Пол / Sex
M
Shtetësia / Држављанство / Nationality
KOSOVAR
Data e skadimit / Датум истека / Date of expiry
04.12.2032
Vendlindja / Место рођења / Place of birth
DRENOC
Nënshkrimi / Потпис / Signature

ID

624201

Data e lëshimit / Датум издавања / Date of issue
05.12.2022
Lëshuar nga / Издат од / Issued by
MPB / MUP / MIA
Nr. Personal / Лични Бр. / Personal No.
1230639368
Nr. Lnj. / Бр. Л. К. / ID Card No.
ID2280814
Vendbanimi / Пребивалиште / Residence
DRENOC, KLINË

IDRKSID22808148<<<<<<<<<<<<<<<
6510075M3212046RKS1230639368<9
PREBREZA<<GJEVDET<<<<<<<<<<<<<

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

**PËR:** Komitetin për Politikë dhe Financa, kryesuesin z. Fadil Gashi

**NGA:** Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, drejtori z. Qendrim Millaku ;

**PËRMES:** Kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj ;

**LËNDA:** **Kërkesë**, për futje në rend të ditës për seancën e KPF-së të dt.13.01.2023, 1. Draft Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave, si dhe 2. Draft Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

I nderuar kryesues dhe ju anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke marrë parasysh se draft Rregullorja Komunale për Menaxhim të Mbeturinave si dhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, janë punuar nga ana e komisionit komunal, andaj, kërkojmë nga ana e KPF-së, qe këto draft dokumente të shqyrtohen dhe t'i rekomandohen Kuvendit të Komunës qe në seancën e radhës te shqyrtohen dhe të vihen në diskutim publik.

Shpresojmë ne përkrahjen tuaj.

**Me respekt,**

01 Nr. 06-1516 /2023
Klinë, dt.12.01.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

# PLANI I PUNËS I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2023

**Klinë, janar 2023**

**PËRMBAJTJA:**


1. **Hyrje.................................................................................................................3**
2. **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.............................................................4**
3. **Drejtoria e Arsimit..................................................................................14**
4. **Drejtoria E Financave, Ekonomisë Dhe Zhvillimit.................................................20**
5. **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport......................................................................24**
6. **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale....................................................32**
7. **Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.........................................................40**
8. **Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.................................................44**
9. **Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural...........................................50**
10. **Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë .................................................53**
11. **Drejtoria për Punë Inspektuese...................................................................56**

## 1. HYRJE

Esenca e Planit të Punës qëndron në faktin se kryetari i komunës të jetë sa më afër qytetarit nëpërmjet dëgjimeve me publikun, transparencës dhe llogaridhënies, kontaktit në çdo kohë dhe në çdo vend me qytetarët, duke i përmbushur të gjitha obligimet ndaj qytetarëve, siç e kërkon legjislacioni në fuqi.

Në këtë plan të punës, synimet dhe projektet e planifikuara të ekzekutivit të komunës së Klinës për vitin 2023 janë në funksion të realizimit të synimeve kryesore zhvillimore, të përcaktuara në dokumentet zhvillimore të komunës dhe Strategjisë Zhvillimore 2022-2027, që është si projekt në përfundim e që pritet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2023:

1. Zhvillimi ekonomik,
2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve,
3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë,
4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Ky plan i punës përcakton aktivitetet që do të ndërmerren këtë vit dhe kohën e aktivitetit për të bërë realitet vizionin që Klina gradualisht të bëhet një komunë ekonomikisht e zhvilluar me një administratë efikase, në shërbim të qytetarëve të vet dhe bizneseve, me një mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar, duke treguar progres të vazhdueshëm në përmirësim të cilësisë së arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve publike.

Në vitin 2023 prioritetet kryesore do të jenë përmirësimi i infrastrukturës fizike, në mënyrë që vitet në vijim të krijohen parakushtet për të kaluar në fazën e mirëfilltë të zhvillimit ekonomik lokal, duke u përqendruar në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, posaçërisht në lëmin e prodhimit, bujqësisë, turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Gjatë punës dhe ushtrimit të funksioneve, ekzekutivi, përkatësisht qeverisja komunale, aktivitetet për realizimin e synimeve kryesore do t`i ndërlidhë me dokumentet strategjike të nxjerra nga Kuvendi i Komunës si dhe orientimet strategjike në nivel vendi, përkatësisht Strategjinë Kombëtare Për Zhvillim 2016-2021, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2020-2022 dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, përkatësisht raporteve kontraktuale të prioritetit të Republikës me Bashkimin Evropian.

Në vijim, po prezantojmë planet sektoriale të punës dhe të veprimit për të gjitha drejtoritë veç e veç, siç vijon:

## 2. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Misioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve nëpërmjet komunikimit korrekt dhe transparent lidhur me kushtet, procedurat administrative, respektimin e ligjeve, respektimin e afateve kohore të dhënies së përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve.

### 2.1. Sektori i Regjistrimit të Gjendjes Civile – Ofiqaria

Gjendja Civile në Klinë është e organizuar në Zyrën Qendrore, ku punojnë 5 zyrtarë së bashku me shefin e Gjendjes Civile, si dhe gjithashtu 10 zyra në terren, duke përfshirë 10-zyrtarë.

Përveç shërbimeve të cilat i ofrojnë, gjithashtu në shërbim të qytetarëve është edhe E-Kiosku, që ofrojnë shërbime 24/7.

Planifikimet e Zyrës së Gjendjes Civile për vitin 2023 do t'i paraqesim, si në vijim:

- Të sigurohet një sallë për kurorëzime, që është shumë e domosdoshme;
- Të kompletohen me kompjuterë të rinj Zyrat e Gjendjes Civile, që nuk janë furnizuar me kompjuterë gjatë vitit 2022;
- Furnizimi me material shpenzues, si tonerë, letër A4, certifikata të gjendjes civile me të gjitha llojet, si dhe materiale tjera të nevojshme për kryerjen e punëve.

Lëshimi i certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, certifikata të vendbanimit, certifikata të shtetësisë, vërtetime nga arkiva, procesverbale mbi pranimin e atësisë dhe amësisë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve, regjistrimin e martesave etj.

Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet të publikohen në ueb-faqen zyrtare, ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese, ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse Drejtoria e Administratës, gjegjësisht Zyra e Informimit.

### 2.2. Zyra e Teknologjisë Informative

Zyra e Teknologjisë Informative është pjesë e Drejtorisë së Administratës dhe i përgjigjet drejtorit të Administratës për planifikimet dhe punët që kryhen në këtë zyrë, dhe ka vetëm një punëtor dhe kërkohet që të shtohet numri i stafit në këtë zyrë.

- Sistemi i Menaxhimit të radhës, vazhdimi për arkivin, tatimin në pronë dhe kadastër,
- Planifikimi për blerjen e kompjuterëve sipas nevojës për administratën e komunës,
- Avancimi i pajisjeve të IT-së me serverë,
- Instalimi i kamerave në objektet e ZGJC-ve në komunën e Klinës,
- Avancimi i serverëve për ruajtjen e shënimeve BackUp për Server,
- Trajnime profesionale për fushën e IT-së,
- Mirëmbajtjen e rrjetit të brendshëm të komunës,
- Mbështetja e stafit të komunës në përdorimin e teknologjisë informative,
- Menaxhimi i llogarive zyrtare për përdoruesit e tyre.

## 2.3. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit e themeluar në bazë të LPP dhe organogramit të komunës, punën e vet e kryen bazuar në LPP 04/L-042, i ndryshuar dhe amandamentuar me ligjet 04/L237, atë Nr.05/L-68 dhe 05/L-092, si Udhëzuesit dhe Rregullores për prokurim publik, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe ligjeve që kanë të bëjnë me çështje administrative dhe bazuar në planin e punës së zyrës së prokurimit për vitin 2023.

**Prokurim transparent: Në këtë kuadër parashikohen:**

- Njoftimi për kontratë,
- Njoftim për dhënien e kontratës,
- Njoftim për konkurs të projektimit,
- Njoftim për anulim,
- Njoftim për vazhdimin e afatit,
- Njoftim për nënshkrimin e kontratës,
- Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është zyra e prokurimit,
- Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen publike në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Është e nevojshme që të bëhet një zgjidhje për të kompletuar këtë sektor mjaft të rëndësishëm me staf, kur dihet se volumi i punëve në këtë zyrë është mjaft i madh.

Zyrës së Prokurimit i mungon një (1) ekonomist dhe një (1) jurist për përgatitjen e kontratave, dosjeve dhe dokumentacionit përcjellës, pasi që tani kjo zyre punon me vetëm një udhëheqës të zyrës dhe një zyrtare administrative, kujdesi i së cilës është ekskluziv për nxjerrje të urdhërblerjeve, fushë kjo është mjaft me përgjegjësi.

## 2.4. Zyra e Personelit

- Të digjitalizohen në HRMIS të gjitha dosjet e të punësuarve në komunë,
- Zbatimi i Ligjit për Zyrtarë Publik dhe rregulloreve përkatëse,
- Shpallja e konkurseve,
- Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,
- Njoftimi për anulimin e konkursit,
- Rishpallja apo vazhdimi i konkurseve,
- Avancimet brenda institucionit,
- Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të zyrtarëve publik është zyra e personelit, ndërsa për publikimin e tyre zyra e informimit,
- Publikimi i të gjitha procedurave për përzgjedhjen e zyrtarëve publik publikohen në ueb- faqe zyrtare të komunës, në objektin e komunës, në media lokale të shkruara dhe atyre elektronike. Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për shërbimin civil,
- Zbatimi i planit të personelit i aprovuar nga ministria dhe kryetari i komunës,
- Përgjigje në të gjitha shkresat që vijnë nga KPMSHC,
- Zbatimi i planit të trajnimeve për zyrtarët komunal.

## 2.5. Zyra pritëse dhe arkiva e komunës

Duke u mbështetur në Ligjin mbi Administratën e Përgjithshme, në Ligjin mbi Afarizmin Zyrtar, në Ligjin mbi Lëndën Arkivore, si dhe në Rregulloret mbi Ligjin e Shërbimeve Publike, ky sektor ka për qëllim regjistrimin e të gjitha akteve, shkresave, vendimeve, lejeve të ndërtimit, çka do të thotë, i gjithë materiali, regjistrat unik që prodhon KK-Klinë për vitin 2023.

## 2.6. Shërbimi për Punë të Kuvendit

Hapat konkret që Kuvendi i Komunës së Klinës do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së Planit të Punës dhe rekomandimeve të ekzekutivit të komunës, përfshijnë objektivat si në vijim:

1. Objektivi i parë i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve tjera.

Në këtë kuadër parashikohet:

1.1. Njoftim për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve përmes ueb-faqes zyrtare, medieve lokale, të shkruara dhe elektronike, rrjeteve sociale, mbi vendin dhe kohen e mbajtjes së mbledhjes me agjendë të punës;

1.2. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe Zyrës për komunikim me qytetarë, së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes;

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës;

2.1. Njoftim për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës përmes ueb-faqes zyrtare, medieve lokale të shkruara/elektronike, rrjeteve sociale mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë;

2.2. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe zyrës për komunikim me qytetarë.

- **Konsultimi me publikun, ku parashikohet të ketë:**

1. Konsultime për buxhet,
2. Konsultime dhe zgjedhja e kryetarëve të fshatrave,
3. Konsultime për planin/strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal,
4. Konsultime për planifikim hapësinor,
5. Konsultime për investime,
6. Konsultimi për të hyra komunale dhe
7. Konsultimi për çështje tjera në interes të përgjithshëm.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e kuvendit dhe zyra për komunikim me qytetarë, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqe zyrtare të komunës, në medie lokale të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara në qytet dhe fshatra.

**Takimet me publikun, ku parashikohet:**

Komuna do të mbajë së paku dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilat takime mund të marrë pjesë secili qytetar apo organizatë me interes në komunë.

Përveç këtyre dy takimeve me qytetarë, komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara të këtij plan-veprimi.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i kryetarit së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqen zyrtare të komunës, në medie, vende të frekuentuara si dhe në rrjete sociale, etj.

**Rinovimi i sallës së Kuvendit të Komunës:**

1. Rinovimi i bazës së sallës,
2. Ndërrimi i ulëseve dhe tavolinave,
3. Ndërrimi i sistemit të zërimit dhe mikrofonave,
4. Implementimi i votimit elektronik,
5. Transmetimi video live-stream.

## 2.7. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në kuadër të Komunës së Klinës për vitin 2023 planifikon t`i mbulojë të gjitha aktivitetet që zhvillohen në komunë. Zyra ka siguruar informim të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët e komunës dhe më gjerë.

•Takimet dhe intervistat e kryetarit të komunës me qytetarë, OJQ, dhe gazetarë,

• Takime në formë debati me qytetarë,

• Takime pyetje dhe përgjigje,

• Intervista, konferenca për medie,

• Kryetari i komunës cakton një ditë brenda javës që në zyrën e tij të ketë takime me qytetarë,

• Aktivitetet bëhen të ditura nga shefi i kabinetit të kryetarit dy javë para, përmes zyrës për komunikim të kryetarit të komunës.

**E drejta e qasjes në dokumente publike**

• Kërkesa për qasje në dokumente publike, trajtohet nga secili organ i komunës që posedon dokumentin e kërkuar duke mbikëqyr informatën;

• Organi komunal ndihmon kërkuesin për qasje në dokument publik aq sa është e mundshme për të identifikuar dokumentin e kërkuar dhe trajtimi bëhet në mënyrë të barabartë;

• Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyrtari i caktuar nga organi brenda (7) ditësh dhe mund të vazhdohet deri në 15 ditë;

• Njësia/zyrtari për komunikim me qytetarë bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike te kërkuesi.

**Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet**

• Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të trajtohen drejtpërdrejt apo përmes kërkesave me shkrim;

• Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej 60 ditësh;

• Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e kuvendit.

**Publikimin e akteve komunale:**

• Të gjitha rregulloret, vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja;

• Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës, në vendet e frekuentuara brenda komunës, brenda 15 ditësh pas regjistrimit në MAPL, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi;

• Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e kuvendit;

Freskimin e faqes zyrtare të komunës:

• Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015;

• Përgjegjësia për mirëmbajtjen e ueb faqes së komunës është e Zyrës për Informim dhe Zyrës së IT-së.

## 2.8. Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit

Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit e komunës së Klinës gjatë vitit 2023 planifikon kryerjen e obligimeve që rrjedhin nga detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të komunës si dhe drejtorive komunale, sipas kërkesave dhe nevojave të tyre si dhe shërbimeve tjera përkatëse, duke përfshirë hartimin e akteve të kryetarit, si dhe akteve tjera sipas kërkesave të Kuvendit të Komunës, drejtorive dhe shërbimeve tjera përkatëse.

Do të merr pjesë dhe përcjell seancat e Kuvendit të Komunës përgjatë gjithë vitit, takimet publike, dëgjimet publike si dhe aktivitetet tjera organizative brenda institucionit.

Po ashtu, Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit, sipas autorizimeve të kryetarit të komunës, do të përfaqësojë Komunën e Klinës pranë Gjykatave kompetente në lëndët që Komuna e Klinës paraqitet si palë paditëse apo e paditur.

Po ashtu, lëndët në intranet do të procedohen sipas vendosjes se tyre duke përfshirë lëndët e zyrës ligjore si dhe lëndët e zyrës së kryetarit.

## 2.9. Shërbimi teknik

Sigurimin fizik të objektit të administratës së komunës 24/7;

- Ardhja në punë, dalja në pushim si dhe kthimi nga pushimi i punëtorëve në kohë të caktuar;

- Kujdeset për hyrjen dhe daljen e personave dhe qytetarëve në objektin e komunës;

- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të drejtorit.

## 2.10. Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Qëllimi i këtij plani është të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet, të përcaktojë përgjegjësitë në nivelin komunal, për të hartuar dhe zbatuar politika që garantojnë barazinë e plotë në mes të grave e burrave.

Arsimi:

• Sigurimi i qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor;

• Rritja e numrit të vajzave që vazhdojnë shkollimin fillor dhe të mesëm;

• Rritja e shkollimit të vajzave të komuniteti Rom, Ashkali, për 50% më shumë krahasuar me çdo vit paraprak;

• Krijimi i kushteve në bazë të standardeve për shkollimin e vajzave me nevoja të veçanta.

Punësimi:

• Fuqizimi ekonomik dhe rritja e punësimit të grave;

• Rritja e numrit të grave të punësuara;

• Rritja e numrit të grave në inicimin dhe udhëheqjen e bizneseve të vogla;

• Promovimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla të udhëhequra nga gratë.

Shëndetësia:

• Përmirësimi i shëndetit të grave dhe vajzave dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore preventive;

• Ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave, për vizita të rregullta shëndetësore preventive dhe vizita tjera;

• Ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave për rrezikun e kancerit të gjirit, mitrës;

• Përmirësimi i shëndetit reproduktiv për gratë dhe vajzat e reja;

• Sigurimi i një aparati monografik me infrastrukturë përcjellëse për komunën e Klinës.

Të drejtat e grave dhe dhuna në familje:

• Promovimi i të drejtave të barabarta të grave dhe dhuna në familje;

• Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit kundër Dhunës në Familje;

• Ngritja e vetëdijes për dhunë në familje;

• Mbështetja e infrastrukturës për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të dhunës.

E drejta e trashëgimisë:

• Krijimi i mekanizmave mbështetëse në zbatimin e Ligjit mbi Trashëgiminë;

• Nxitja dhe vetëdijesimi i grave dhe vajzave mbi të drejtën e trashëgimisë;

• Promovimi i të drejtave të barabarta në mes të vajzave, djemve, grave dhe burrave.

Vendimmarrja:

• Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit mbi Barazinë Gjinore;

• Nxitja e grave për pjesëmarrje në vendimmarrje.

## 2.11. Zyra e Përkthimeve

- Është përgjegjës për punët në lëmin e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;

- Bënë përkthime të drejtpërdrejta, përkthime me shkrim për të gjitha organet e Administratës Komunale, Kuvendit, Trupat e Kuvendit, Komisioneve etj;

- Bënë përkthimin e të gjitha materialeve të cilat i pranon përmes internetit;

- Mban evidencën e të gjitha shkresave të përkthyera;

- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të kryetarit të komunës apo drejtorit të cilit i përgjigjet.

## 2.12. Zyra e Lekturimeve

- Kryen dhe është përgjegjës për lekturimin e procesverbaleve dhe të materialit tjetër të Kuvendit Komunal;

- Kryen lekturimin e të gjitha procesverbaleve tjera të të gjitha organeve komunale, komiteteve, si dhe komisioneve komunale;

- Kryen lekturimin e të gjitha akteve normative, vendimeve, aktvendimeve, kontratave, proceseve administrative dhe gjithë dokumentacionin tjetër zyrtar të komunës apo edhe drejtorit të cilit i përgjigjet.

## 2.13. Zyra e Pranimit të Mallit

- Pranimi dhe regjistrimi i mallrave të furnizuara,
- Komunikimi me të gjitha drejtoritë komunale,
- Koordinimi i kërkesave mes drejtorive dhe zyrës së prokurimit,
- Implementimi i procedurave administrative në shpërndarjen e mallrave,
- Mbajtja e librave në rregull mbi mallin e pranuar,
- Përcjell kërkesat nga drejtoritë në zyrën e prokurimit,
- Mban evidencën për të hyrat dhe daljet nga depoja e administratës,
- Evidenton me tiketa sipas artikullit,
- Shpërndan materialin për nevoja zyrtare,
- Mban libra të veçanta sipas drejtorive për shpenzimet e krijuara,
- Përgjigjet për hyrjet dhe daljet e tërë mallit në depo,
- Kryen të gjitha fotokopjimet për nevoja zyrtare të komunës,
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të drejtorit të cilit edhe i përgjigjet.

Nevojat e zyrës për vitin 2023:

- Printer për printimin e barcodeve.

Si kërkesa elementare do të ishin këto:

- Pajisja me inventar të nevojshëm për Drejtorinë e Administratës,
- Rinovimi i sallës së Kuvendit të Komunës,
- Avancimi i pajisjeve të rrjetit Suitcha-ve,
- Trajnime profesionale për fushën e IT-së,
- Furnizimi me një e E-kiosk në Komunën e Klinës,
- Digjitalizimi i lëndëve arkivore,
- Zhvillimi i softuerit për menaxhim të autoparkut,
- Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të radhës,
- Riparimi i ndriçimit në objektin e komunës,
- Furnizimi me kompjuterë dhe llaptop sipas nevojës.

Deklarata e misionit: Ndihmon kuvendin dhe komitetet dhe ju siguron informacione dhe raporte të ndryshme, ndihmon Bordin e Drejtorëve për mbarëvajtjen e punëve që u përkasin lëmit e DAP, zbaton të gjitha aktet dhe vendimet e komunës, përgatit raportin e punës dhe programin – objektivat e kësaj drejtorie, propozon personelin udhëheqës dhe personelin tjetër për drejtoritë, kryen edhe punë të tjera që ngarkohen nga kuvendi dhe kryetari, etj.

Deklarata e Vizionit: Administrata siguron të gjitha shërbimet administrative të drejtorisë, mbikëqyr procedurat e menaxhimit të stafit të shërbimit civil, gjithashtu menaxhon me stafin dhe buxhetin e kësaj drejtorie.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhimi me një nivel të lartë të gjithë administratës komunale, ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët.

**Kostoja e mjeteve financiare për investimet kapitale janë si në vijim:**

1. Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale (Renovimi i sallës së Kuvendit dhe objektit të Komunës). Nga buxheti Komunal 40.000.00 ndërsa pjesa tjetër nga donatorët;

2. Blerja e veturave zyrtare me kosto financiare 45.000,00 € (katërdhjet e pesë mijë euro);

3. Furnizimi me E-kiosk të ri me kosto financiare 22.000,00 € (njëzetedy mijë euro), nga donatorët.

## 3. DREJTORIA E ARSIMIT

### JANAR:

1. Inspektimi i shkollave-konstatimi i gjendjes dhe i kërkesave për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2022/2023.

2. Analiza e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2022/2023 dhe marrja e qëndrimeve për rritjen e nivelit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

3. Qasja, kontrollimi, krahasimi dhe monitorimi i të dhënave të shkollave në programin SMIA për gjysmëvjetorin e parë 2022/2023, në përputhje me përgjegjësitë e DKA-së sipas UA 25/2013 për regjistrimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e arsimit.

4. Analizë e gjendjes rreth orëve të pambajtura në gjysmëvjetorin e parë të viti shkollor 2022/2023.

5. Vizita sistematike në shkolla në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe gjendjen infrastrukturore në shkolla.

6. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për shtimin e linjave të reja për transportin e nxënësve në zonat e largëta dhe të rrezikshmërisë.

7. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për furnizim, montim me pajisje për leximin e vijueshmërisë së punonjësve në shkolla.

8. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për furnizim, montim i kaldajës me Pompë termike në SHFMU "Ymer Berisha" në Siqevë.

9. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore, diskutimi i nevojave për investime kapitale.

### SHKURT:

1. Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve kulturore dhe me frymë garuese nëpër shkolla në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizata kompetente dhe të akredituara të MASHTI.

2. Takim me ekipin komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore sipas UA 16/2017.
3. Koordinimi me drejtorë shkollash për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe të atyre që kanë vështirësi në nxënie.

4. Aktivitete në bashkëpunim me koordinatorët e cilësisë dhe drejtorët e shkollave për gjendjen momentale në procesin mësimor dhe për marrjen e qëndrimeve për avancimin e treguesve të cilësisë nëpër institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese.

5. Zgjerimi i instalimit të kamerave në shkolla.

6. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për ndriçimin e ambienteve të jashtme të objekteve shkollore.

7. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

**<u>MARS:</u>**

1. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për renovimin e objekteve shkollore dhe fushave sportive në shkolla - projekte kapitale.

2. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për furnizim me inventar në shkolla – projekte kapitale.

3. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për gjelbërimin e hapësirave shkollore dhe krijimi i këndeve rekreacioni për nxënës.

4. Organizimi i veprimtarive kulturore nëpër shkolla dhe në nivel komunal për nder të 7 Marsit-Ditës së Mësuesit.

5. Aktivitete për funksionalizimin e Këshillit Komunal të Prindërve.

6. Koordinimi dhe organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në bashkëpunim me MASHT-in dhe OJQ-të kompetente.

7. Organizimi i garave tradicionale komunale në disa fusha.

8. Aktivitete për funksionalizimin e aktiveve profesionale nëpër shkolla.

9. Renovimi i objektit dhe rregullimi i ngrohjes qendrore me pompa termike në SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës" në Gllarevë, projekt-donacion nga Komisioni Evropian.

10. Vizita sistematike në shkolla në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe gjendjen infrastrukturore në shkolla.

11. Publikimi i konkursit për ndarjen e 60 bursave për studentët e vitit akademik 2022/2023.

12. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

**<u>PRILL:</u>**

1. Organizimi i javës ekologjike nëpër shkolla me rastin e 1 prillit-ditës ndërkombëtare të ambientit.

2. Shënimi i ditës ndërkombëtare të librit.

3. Inspektimi i shkollave - konstatimi i gjendjes në procesin mësimor, kontrolli i dokumentacionit pedagogjik.

4. Aktivitete për ngritjen e nivelit të veprimtarive jashtëmësimore të nxënësve rreth zbulimit dhe afirmimit të talenteve të reja në fusha të ndryshme të artit e të sporteve.

5. Vizita sistematike në shkolla në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor për verifikimin e ditarëve, vlerësimin e nxënësve, planifikimin e aktiviteteve nga ana e shkollave, etj.

6. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për vendosjen e roletave në shkollat që kanë nevojë.

7. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për hapjen e puseve  në shkollat që kanë nevojë.

8. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

**MAJ:**

1. Fillimi i inicimit të procedurave për furnizimin e bibliotekës digjitale në një shkollë model të digjitalizimit të mësimdhënies, E-Ditari.

2. Organizimi i aktiviteteve nëpër shkolla me rastin e 9 Majit-Ditës së Evropës (në bashkëpunim me MASHT-in.

3. Fushata nëpër shkolla për informimin dhe përgatitjen e nxënësve për testin nacional të klasës së nëntë dhe për provimin e maturës shtetërore.

4. Konsultimi me drejtorë të shkollave të mesme të larta rreth planifikimit të drejtimeve dhe profileve arsimore për klasën e dhjetë të vitit shkollor 2023/2024.

5. Bashkërendim aktivitetesh me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve- 1 Qershorit.

6. Organizimi i testit ndërkombëtar TIMSS dhe ICILS.

7. Organizimi i testit të arritshmërisë për klasën e nëntë.

8. Organizimi i aktiviteteve sportive në shkolla.

9. Organizimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me koordinatorë të cilësisë nëpër shkolla rreth procesit të vetëvlerësimit dhe vlerësimit në shkollë sipas UA 24/2016.

10. Përfundimi i projektit për praktikën profesionale në IAAP “Fehmi Agani” në Klinë, donacion nga ITED.

11. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për furnizim, montim i kaldajës me Pompë termike në SHFMU “Nëna Terezë”në Budisalc.

12. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

**QERSHOR:**

1. Aktivitete për përfundimin me kohë dhe me sukses të vitit shkollor 2022/2023.

2. Organizimi i provimit të Maturës shtetërore 2023.

3. Organizimi i punës për regjistrimin e fëmijëve parashkollorë, parafillorë dhe në klasën e I-rë të shkollës fillore dhe në klasën X-të të shkollës së mesme të lartë, sipas planit të DKA-së dhe konkursit të MASHT-it.

4. Koordinimi i punëve për mbarimin me kohë të të gjitha procedurave pedagogjike dhe administrative nëpër shkolla, pajisja e nxënësve me dokumentacionin e nevojshëm pedagogjik (librezë e nxënësit, dëftesë, certifikatë, diplomë), sipas vendimit të MASHT-it për formën e lejuar të dokumentit shkollor.

5. Kontrollimi i të dhënave statistikore në SMIA dhe analiza për suksesin dhe mungesat e nxënësve në fund të vitit mësimor 2022/2023.

6. Përgatitja dhe organizmi i konkursit dhe publikimi i tij për kuadrin arsimor për vitin shkollor 2023/2024.

7. Fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit për furnizim me mjete konkretizimi në shkolla.

8. Analizë e gjendjes rreth orëve të pambajtura në fundin e vitit shkollor 2022/2023.

**KORRIK:**

1. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore rreth përfundimit të vitit shkollor 2022/2023.

2. Shqyrtimi i kërkesave të shkollave për pajisje mësimore për vitin shkollor 2023/2024 dhe për dokumentacion pedagogjik.

3. Vizitë sistematike në shkolla për përgatitjet higjieno-teknike të objekteve shkollore dhe identifikimi i nevojave për furnizimin e shkollave me lëndë për ngrohje të objekteve për vitin shkollor 2023/2024.

**GUSHT:**

1. Organizimi i provimit të maturës shtetërore në afatin e gushtit 2023.

2. Pranimi i kuadrit arsimor në shkolla, sipas konkursit publik.

3. Shpërndarja e teksteve mësimore në shkolla dhe mjeteve të tjera pedagogjike.

4. Vizitë sistematike në shkolla lidhur me gjendjen e tyre dhe kushtet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.

5. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.

**<u>SHTATOR:</u>**

1. Kontrollimi i futjes së të dhënave statistikore në SMIA për fillimin e viti të ri shkollor 2023/2024.

2. Organizimi dhe menaxhimi i ekskursioneve të maturantëve, sipas udhëzimeve administrative të MASHT-it, sipas kërkesave të shkollave.

3. Kontrollimi i të dhënave statistikore në SMIA për shënimet me rastin e përfundimit të vitit shkollor 2022/2023.

4. Inspektimi i shkollave me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor.

5. Ndihmesë pedagogjike dhe profesionale mësimdhënësve të rinj.

**<u>TETOR:</u>**

1. Analizë e gjendjes në procesin mësimor dhe ecurive të tjera zhvillimore në fillimin e vitit shkollor 2023/2024.

2. Bashkërendimi i aktiviteteve për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të shkollave për shkëmbim përvojash pedagogjike si dhe hulumtimi i mundësive për ndonjë binjakëzim ose shkëmbim përvojash me shkolla të Republikës së Shqipërisë.

3. Kontrollimi i të dhënave statistikore në SMIA për shënimet me rastin e fillimit të vitit shkollor 2023/2024.

4. Bashkërendimi i punëve me drejtorë të shkollave dhe ndihmesa e DKA-së për planifikimin e buxhetit të arsimit për vitin kalendarik 2024.

5. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

**NËNTOR:**

1. Inspektimi i shkollave-konstatimi i gjendjes, rekomandime për përdorimin e strategjive të avancuara për rritje të cilësisë në procesin mësimor.

2. Bashkërendimi i aktiviteteve me drejtorë të shkollave për zhvillimin e aktiviteteve me rastin e festave të Nëntorit.

3. Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës, varësisht nga nevojat e shkollave.

4. Takim pune me drejtorë dhe koordinatorë të cilësisë të institucioneve edukativo-arsimore.

**DHJETOR:**

1. Aktivitete për zbatimin e planit dinamik të MASHT-it për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024.

2. Organizimi i punëve për përfundimin e raporteve statistikore dhe për plotësimin e dokumentacionit pedagogjik, administrativ dhe juridik nëpër shkolla.

3. Analiza e raporteve të shkollave.

4. Takim pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.

5. Raportet vjetore të drejtorëve të shkollave.

**Buxheti i planifikuar për vitin 2023:**

Numri i punëtorëve: 657;

Buxheti për paga dhe mëditje: 4,500,836.00 €;

Buxheti për mallra dhe shërbime: 594,464.00 €;

Buxheti për komunali: 45,000.00 €;

Buxheti për subvencione: 36,000.00 € (këtu planifikohet pagesa e bursave të studentëve dhe transporti i nxënësve me nevoja të veçanta).

Projektet kapitale:

- Furnizim me inventar për shkolla: 30,000.00€;

- Rinovim i objekteve shkollore dhe fushave sportive: 175,000.00 €

**Gjithsej buxheti i planifikuar për vitin 2023 në vlerë prej 5,381,300.00 euro.**

## 4. <u>DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT</u>

Në periudhën  e planifikimit 01 janar - 31 dhjetor 2023 në vendet e punës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, është siç vijon:

**<u>ZYRA JURIDIKE DHE E TAKSAVE KOMUNALE</u>**

- Lëshimi i kontratave të ndryshme që ndërlidhen me taksat komunale, tatimet dhe qiratë sipas kërkesës së kryetarit të komunës dhe drejtorit të drejtorisë;
- Lëshimin e aktvendimeve për shfrytëzim të pronës komunale sipas marrëveshjeve paraprake dhe sipas pëlqimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe komisionit komunal për periudhën më pak se një vit;
- Lëshimi i më shumë se 1500 aktvendimeve të taksave për ushtrim të veprimtarisë të subjekteve afariste që operojnë në komunën e Klinës për vitin 2023;
- Lëshimin dhe vendosjen e më shumë se 30 ankesave të arritura gjatë vitit 2023 nga personat fizik dhe juridik të tatimit mbi pronën;
- Lëshimin dhe vendosjen e më shumë se 10 ankesave të arritura gjatë vitit 2023 nga personat fizik dhe juridik të taksave komunale për ushtrim të veprimtarisë;
- Lëshimin e konkluzioneve të përgjithshme të arritura dhe të preferuara nga eprorët kompetent në komunë dhe drejtorinë përkatëse;
- Lëshimin e më shumë se 10 akteve të përgjithshme administrativo-juridike sipas urdhrit të kryetarit të komunës dhe drejtorit të drejtorisë;
- Lëshimin dhe njoftimi i qytetarëve me akte administrative juridike, lidhur me neglizhencat e ndryshme të pagesave të taksave komunale dhe qirave të ndryshme sipas lëmive përkatëse;
- Paraqitja e raporteve mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore sipas kërkesave të eprorëve kompetent dhe organeve kompetente;
- Si dhe  punë tjera sipas urdhrit të eprorëve kompetent dhe kohës së paraqitjes së punëve dhe detyrave përkatëse gjatë vitit planifikues.

**<u>ZYRA E TË HYRAVE:</u>**

-  Regjistrimi i të gjitha të hyrave vetanake komunale për periudhën 01 Janar-31 dhjetor 2023 sipas transaksioneve të bankës dhe arkës;

-  Regjistrimi në akces i të hyrave dhe free-balance;

-  Nxjerrja dhe raportimi i raporteve ditore, mujore dhe vjetore lidhur me gjendjen e të hyrave sipas periudhave të përcaktuara kohore;

- Raportimi lidhur me gjendjen e të hyrave në organet kompetente komunale dhe në organet qendrore, respektivisht në MEF-ca;

- Barazimin e gjendjes financiare të të hyrave dhe plotësimin e formularëve për alokim të mjeteve komunale;

- Përcjelljen e gjendjes së pagesave të qirave të lokaleve afariste komunale dhe të banesave sociale;

- Nxjerrjen e raporteve mujore lidhur me gjendjen e pagesave të qirave komunale sipas periudhave kohore që obliguesit i kryejnë;

- Gjithsej planifikohen rreth 6 300 transaksione.

## ZYRA E ZOTIMEVE:

- Zotimi i të gjitha mjeteve buxhetore për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2023, sipas kërkesave të arritura nga zyra e prokurimit;

- Zotimi i të gjitha mjeteve financiare të arritura nga drejtoritë komunale sipas planifikimit të tyre buxhetor;

- Zotimi i mjeteve në modulin e blerjes, aprovimeve, etj;

- Nxjerrja e raporteve ditore, mujore, vjetore, lidhur me gjendjen e zotimeve dhe shpenzimeve përkatëse gjatë periudhave planifikuese;

- Përgatitja e lëndëve për dërgim në zyrën e pagesave;

- Gjithsej planifikohen për kryerje 1650 lëndë që duhet të përcillen në zyrën e pagesave në komunë.

## ZYRA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE:

- Në periudhën parashikuese parashihet regjistrimi-lëshimi i licencave për të gjitha llojet e bizneseve sipas regjistrimit në MIT-së dhe dokumentacionit të kërkuar sipas dispozitave aplikative në fuqi,

- Lëshimi i vërtetimeve mbi regjistrimin e bizneseve sipas kërkesave;

- Lëshimi i vërtetimeve për konkurrim për vendstrehim;

- Lëshimi i vendimeve për zgjatje të orarit të punës;

- Lëshimi i licencave për çdo gjashtëmujor të licencave për kombi-taksi dhe auto-taxi sipas kërkesave;

- Lëshimi i lejeve të punës për subjektet afariste;

- Lëshimi i lejeve të punës për auto-transportues;

- Lëshimi i lejeve të punës për vazhdimin e itinerarit për autobusët;

- Lëshimi i lejeve të punës për licencimin e alkoolit, duke i regjistruar të gjitha lëndët në intranet sistematikisht.

**ZYRA E TATIMIT NË PRONË:**

- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Komunale mbi Tatimin në Pronë;

- Regjistrimi në kompjuter i të gjitha ngarkesave tatimore për vitin 2023;

- Dërgimi-shpërndarja e vërejtjeve të fundit për obliguesit tatimor që nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore paraprake dhe të këtij viti;

- Shpërndarja e marrëveshjeve për pagesa;

- Shpërndarja e urdhëresave për bllokim të xhirollogarive për obliguesit që nuk i kanë kryer obligimet tatimore;

- Kushtëzimin e shërbimeve komunale me lëshimin e vërtetimeve që i kanë përmbushur obligimet tatimore;

- Aktiviteti i shpërndarjes së vërejtjeve të fundit, bashkë me shpërndarjen e faturave tatimore për vitin 2022-2023 dhe obligimeve paraprake;

- Regjistrimi i pagesave sistematikisht në programin e pagesave të tatimit në pronë, sipas pagesave për secilin obligues;

- Aplikimi i llogaritjes së kamatave sipas normave të MEF-it;

- Regjistrimi në kompjuter i ndryshimeve sipas vendimeve të ankesave të vitit 2023;

- Marrja e aksionit në inkasimin e obligimeve tatimore të pakryera nga ana e obliguesve tatimor;

- Si dhe punë tjera të kësaj natyre sipas dispozitave ligjore aplikative dhe sipas nevojës së paraqitjes, sipas kohës.

**SEKTORI I THESARIT:**

- Regjistrimi në sistemin e Menaxhimit të Financave Publike(SIMF) urdhër obligim pagesat për të gjithë shfrytëzuesit,

- Kryerja e pagesave sistematikisht për të gjitha drejtoritë komunale sipas pagesave të përgatitura nga drejtoritë.

**KONTABILITETI :**

- Regjistrimi sistematikisht i të gjitha pagesave sipas lëmive të caktuara në kontabilitet;
- Regjistrimi i bllokave të automjeteve sipas nr.serik;
- Regjistrimi i bllokave të taksave komunale dhe administrative sipas drejtorive;
- Regjistrimin e pagesave të të gjitha llojeve të qirave komunale;
- Regjistrimi i të gjitha pagesave të arritura nga arka komunale dhe zyrat e vendit, etj;
- Regjistrimi i të gjitha ngarkesave të përcaktuara për subjektet afariste për taksa komunale-licenca për vitin 2023;
- Regjistrimin e të gjitha ndryshimeve sipas aktvendimeve të lëshuara nga shërbimi i caktimit të taksave komunale.

**<u>REGJISTRIMI I PASURISË KOMUNALE</u>**

- Planifikimi i regjistrimit të tërë pasurisë komunale sipas udhëzimit administrativ dhe rregullave tjera financiare në fuqi;
- Regjistrimi i pasurisë së paregjistruar sipas urdhër zotim pagesave;
- Zhvlerësimin e pasurisë sipas procesit të Komisionit Komunal për Vlerësim të Pasurisë Komunale;
- Regjistrimi dhe zhvlerësimi i tërë pasurisë komunale në freebalance;
- Mbajtja e regjistrave të pasurisë në vlerë më e ulët se 1000€;
- Mbajtja e regjistrit të pasurisë së imtë (inventarit të komunës) të pranuara nga komisioni komunal i regjistrimit të inventarit.

**<u>ZYRA E PAGESAVE-ARKA</u>**

- Planifikimi i kryerjes së të gjitha pagesave sipas kohës së paraqitjes në vlerë prej 10€ dhe dorëzimin e këtyre mjeteve në bankë,
- Pagesa e të gjitha taksave administrative dhe taksave tjera për të gjitha organet komunale dhe zyrën e komuniteteve.

**<u>NDRYSHIMET MUJORE PËR PAGA DHE MËDITJE-PTKASH.</u>**

- Përgatitja e formularëve për ndryshimin e të ardhurave personale;
- Përgatitja e formularëve për pagesën e mëditjeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës;
- Përgatitja e formularëve për tërheqje të PTKASH-it në zyrën e thesarit;

- Shpërndarja e PTKASH-it sipas drejtorive komunale dhe zyrës së komuniteteve.

## 5. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vepron në kuadër të Komunës së Klinës me gjithsej 6 departamente që kryejnë funksione dhe shërbime të ndryshme. Më poshtë jepet plani i punës për vitin 2023 nga këto departamente që përfshijnë shërbime për qytetarët si dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme, me qëllim promovimi të kulturës, sportit dhe trashëgimisë si dhe fuqizimin e rinisë në komunën tonë.

| Nr . | D | Objektivat dhe aktivitetet | Vërejtje |
|---|---|---|---|

1

**Departamenti i Arkivit Historik të Klinës**

Duke u bazuar në ligjin e ri për arkivat Nr. 08/L-111 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2022 si dhe në bazë të analizës së punës të vitit 2022, mbështetur në synimet dhe prioritetet për vitin 2023, Arkivi Historik i Klinës ka hartuar planin e punës për vitin 2023.

- Pranimi i dokumentacionit të ri në arkiv nga fondkrijuesit, varësisht nga prioritetet që paraqet materiali i ofruar, ku prioritet paraqet lënda e fondkrijuesve që kanë plotësuar afatet e dorëzimit të lëndës në arkiv dhe lënda e cila rrezikohet të dëmtohet për shkak të kushteve jo të mira të ruajtjes.
- Seleksionimi i lëndës së parregulluar në depo sipas prioriteteve dhe ndarja e saj në bazë të përmbajtjes.
- Vazhdim i punës në rregullimin e lëndës arkivore që ka mbetur nga viti i kaluar, për shkak të rrethanave të shkaktuara si rezultat i mungesës së kuadrit arkivor, duke përfshirë rregullimin e lëndës, përgatitja e përmbajtjes së fondit, dosjeve, faqosja, vendosja e saj në kutia arkivore dhe regjistrimi në kompjuter. Me kompletimin e stafit arkivor, Arkivi Historik i Klinës synon angazhim më të madh në rregullimin e lëndës së mbetur nga viti i kaluar dhe realizimin e planit të paraparë për vitin 2023.
- Puna me palë: shqyrtimi i kërkesave, vulosja dhe vërtetimi i kopjeve, lëshimi i dëshmive dhe dokumenteve të ndryshme arkivore për qytetarët dhe hulumtues të fushave të ndryshme.
-Trajnimi profesional i stafit të ri arkivor në lëmin e arkivistikës, sigurimi i transportit për një periudhë një javore në Arkivin Ndërkomunal të Pejës dhe në ASHAK, Prishtinë.

- Digjitalizimi i lëndës arkivore të formatit A3 me prioritet librat e amzës së SHFMU ”Ismet Raci” të Klinës, të dëmtuara në masë të konsiderueshme nga faktori kohë. Për digjitalizim, arkivi parasheh sigurimin e një aparati skanues të formatit A3.
- Gjithashtu për ruajtjen e lëndës arkivore, arkivi ka paraparë investime në inventarizim, ndërrimin e rafteve aktuale që janë jashtë standardeve për ruajtjen e lëndës arkivore, zëvendësimin e tyre me rafte të reja të tipit të mbyllur që mundësojnë jetëgjatësinë e lëndës. Realizimi i këtij investimi është paraparë të kryhet në disa faza brenda periudhës 3-vjeçare.

Realizimi i planit të punës për vitin 2023 kushtëzohet varësisht nga përkrahja financiare dhe ofrimi i kushteve optimale për punë nga ana e Komunës së Klinës, gjegjësisht DKRS.

Është planifikuar rregullimi dhe sistematizimi i lëndës arkivore nga këto fonde:

| **Emri i fondit** | **Vitet** | **Sasia në metra** | **Rregulluar**<br>**Parregulluar** | **Afati i rregullimit** |
|---|---|---|---|---|
| Kuvendi Komunal i Klinës | 1945-2005 | 10 metra | Parregulluar | 2023 -2024 |
| Sekretariati i Punëve të Brendshme dega në Klinë | 1970-1998 | 15 metra | Parregulluar | 2023-2025 |
| SHFMU “Nënë Tereza” Budisalc | 1950-1990 | 3 metra | Pjesërisht i rregulluar | 2023 |
| Biblioteka e qytetit “Kongresi i Manastirit” Klinë | 1968-2008 | 1.50 metra | Parregulluar | Qershor 2023 |

Digjitalizimi i lëndës arkivore është shumë urgjent për shkak të dëmtimit që pësojnë dokumentet e vjetra kohë pas kohe.

Gjithashtu inventarizimi i arkivit me dollap të posaçëm për sistemimin dhe ruajtjen e lëndëve arkivore.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | **Biblioteka e Qytetit “Kongresi i Manastirit ”** | Biblioteka Publike “Kongresi i Manastirit” në Klinë, planifikon për vitin 2023 të thellojë dhe të zgjerojë veprimtarinë bibliotekare në shërbim të nevojave të qytetarëve të të gjitha kategorive të përdoruesve të librit në bibliotekë. Detyrat dhe kërkesat që i kemi të programuara i kemi vlerësuar të arsyeshme. Planifikim për librin, materialin e shtypur dhe elektronik, si dhe materialin tjetër bibliotekar.<br><br>Planifikimi i punës së Bibliotekës “Kongresi i Manastirit” në Klinë, përqendrohet në:<br>- Digjitalizimin e Bibliotekës (fondit librar) që do jetë prioritet i yni deri në realizimin e tij, shfrytëzimin e mundësive buxhetore nga ana e Komunës dhe kontakteve me Bibliotekën Kombëtare për marrjen e programit të digjitalizimit.<br>- Trajnimin e stafit rreth programit dhe punës për digjitalizimin e bibliotekës.<br>- Mbajtja e evidencës dhe regjistrimi i lexuesve.<br>- Përmirësimi i fondit librar në bazë të kërkesave dhe nevojave të lexuesve.<br>- Përpunimi i librit, evidencimi dhe regjistrimi i fondit te ri.<br>- Rritja e numrit të lexuesve dhe vetëdijesimi i tyre për librin i cili pasuron aftësitë e lexuesve, ruajtjen dhe kthimin në afat të librit në bibliotekë.<br>- Spastrimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e koleksionit të librit dhe gjërave të tjera me vlerë si punë në vazhdimësi të bibliotekës.<br>- Sigurimin e materialit shpenzues gjatë një viti.<br>- Bashkëpunimi me BKU dhe me Biblioteka të tjera publike në vend.<br>- Mbajtjen e orëve letrare dhe aktiviteteve të tjera. | Digjitalizimi i Bibliotekës është parësor dhe me rëndësi të veçantë për sigurinë dhe shfrytëzimin më të lehtë të fondit librar. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **3** | **Departamenti i Kulturës** | - Regjistrimi i anëtarëve të rinj të teatrit.<br>- Kontakt me grupet e teatrove shkollore dhe grupeve të artit figurativ.<br>- Vizitë grupeve teatrale, të artit figurativ dhe të shkollave në bashkëpunim me DKA-në.<br>- Bashkëpunim me të gjitha OJQ-të e fushës së kulturës për bashkërendim të aktiviteteve.<br>- Bashkëpunim me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “Jehona e Dukagjinit” - Klinë.<br>- Organizimi i aktiviteteve kulturo-artistike për 17 Shkurt - Dita e Pavarësisë, koncert dhe ekspozitë, orë letrare “Ora e Pavarësisë”.<br>- Organizimi i garave të koncertit kulturo-artistik të nxënësve të shkollave fillore dhe të<br>mesme në Komunën e Klinës.<br>- Përgatitjet e një shfaqje dramë, monodramë, komedi, realizimi i provave në skenë dhe inskenimi i saj.<br>- Shënimi i ditës ndërkombëtare të teatrit më 27 mars.<br>- Përgatitjet për Festivalin Folklorik “I Këndojmë Lirisë”<br>- Ekspozitë personale e një artisti të artit figurativ.<br>- 4 Prilli - Dita e të pagjeturve të luftës në Klinë.<br>- Përgatitjet e një shfaqje me nxënës.<br>- Kurs për pikturë dhe vizatim.<br>- Përgatitja e një shfaqje me kukulla për fëmijë.<br>- Shënimi i ditës së teatrit “Osman R. Gashi” më 21 maj.<br>- 1 Qershori - Dita e fëmijëve, program kulturo-artistik dhe ekspozitë.<br>- Mbajtja e festivalit folklorik “ I këndojmë lirisë” më 6, 7 dhe 8 qershor.<br>- Festimi i ditës së Çlirimit të Klinës më 18 qershor<br>- Campig Fest - Dresnik në bashkëpunim me OJQ Art Eko.<br>- Orë letrare dhe promovim librash, shfaqje teatrale, kino, koloni e artit pamor dhe muzikë.<br>- Ditët e Diasporës - Program kulturo artistik për bashkatdhetar, ekspozitë etj.<br>- Manifestimi letrar tradicional “Ora e Tahir Deskut” – 7 shtator<br>- Repriza e shfaqjeve të realizuara për fëmijë.<br>- Shënimi i ditës së Qendrës së Kulturës” Jehona e Dukagjinit” 31 tetor.<br>- Java e kulturës: (ekspozita, film, shfaqje teatrale, muzikë klasike, letërsi).<br>- Festimi i ditës së flamurit kombëtar më 28 Nëntor.<br>- Manifestimi i ekspozitë tradicionale - çmimi “Art Klina” | Për mbarëvajtjen sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të cekura duhet përmirësim dhe rinovim i objekteve të kulturës, andaj sipas mundësive nga DKRS shpresojmë të ketë zhvillime edhe në projekte kapitale. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **4** | **Departamenti i Rinisë** | Departamenti i rinisë përkujdeset për organizimin e aktiviteteve të ndryshme me qëllim fuqizimi të rinisë. Plani i punës përfshinë:<br>- Fushata vetëdijesuese në Shkollat Fillore dhe ato të Mesme në Komunën e Klinës.<br>- Fushata vetëdijesuese në bashkëpunim me QKMF për mbrojtje nga sëmundje të ndryshme.<br>- Fusha e edukimit joformal – investim në vetëdijesimin e të rinjve për edukim social.<br>- Riaktivizimi i Këshillit - Veprimi Rinor Lokal (KVRL).<br>- Vazhdimi i mirëmbajtjes së databazës së punës vullnetare.<br>- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme rinore.<br>- Shënimi i ditës Ndërkombëtare të Rinisë - 2 gusht.<br>- Java e rinisë – Aktivitete rinore, kulturore e sportive me të rinj.<br>- Aktivitete gjatë festivaleve dhe shënimi i datave me rëndësi.<br>- Draft Plani lokal i veprimit për rini 2023 - 2028<br>- Bashkëpunime me KVRL-në dhe Qendrën rinore "Ardhmëria". | Mungesa e një qendre rinore funksionale vështirëson aktivitetet tona. Uroj që së shpejti ta kemi si problem të zgjidhur. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | **Departamenti i Sportit** | Departamenti i sportit kryen shërbime të ndryshme për klubet sportive dhe qytetarët, punon me synimin e fuqizimit të sportit në Komunën e Klinës. Në planin e punës këtë vit parashihet:<br><br>- Formimi dhe riaktivizimi i disa klubeve; volejboll, shah, ping-pong, basketboll.<br>- Përgatitjet e klubeve sportive; futbolli (M), futbolli (F), volejboll (F).<br>- Aktivitete sportive për nder të 17 Shkurtit ditës së Pavarësisë së Kosovës.<br>- Fillimi i Kampionatit të Kosovës në futboll pjesëmarrja e K.F. "Dukagjinit".<br>- Aktivitete sportive për nder të 7 Marsit ditës së Mësuesit dhe 8 Marsit ditës së Gruas.<br>- Aktivitete sportive me aspirata të riaktivizimit të Klubit të Basketbollit (M).<br>- Përgatitjet intensive të klubeve të riaktivizuara për kampionatin e Kosovës.<br>- Qershori-muaj i aktivitete rinore, organizimi i turneve për nderë të FF "I këndojmë lirisë" dhe Ditës se Çlirimit të Klinës (futboll, volejboll, shah dhe ping-pong).<br>- Regjistrimet, lejet e klubeve të reja dhe klubeve të riaktivizuara Volejboll dhe Basketboll.<br>- Fillimi i klubeve klinase në kampionatin e Kosovës; futboll (M), futboll (F), , volejboll (F), ping-pong (M), basketboll (M).<br>- Aktivitete sportive gjatë javë së rinisë.<br>- Muaji i analizave të suksesit të klubeve tona në kampionatin e Kosovës si dhe organizimi i turneve në disa disiplina me rastin e festës se 28 Nëntorit - Ditë së Flamurit.<br>- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional dhe shpallja e sportistëve më të mirë të klubeve dhe çmimi kryesor "Sportisti i vitit". | Rinovime dhe investime të reja në hapësirat sportive janë të nevojshme. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6 | **Departamenti i Trashëgimisë Kulturore** | Zyra për Trashëgimi Kulturore përkujdeset për gjetjen, regjistrimin, ruajtjen dhe konservimin e objekteve dhe aseteve të trashëgimisë kulturore në Klinë dhe në kuadër të kësaj parashihet:<br><br>- Evidentimi dhe përpilimi i një liste të re për gjendjen e objekteve të paluajtshme dhe të luajtshme të trashëgimisë kulturore të komunës së Klinës.<br>- Bashkëpunim ndërinstitucional me MKRS, Institutin Arkeologjik të Kosovës, Muzeun e Kosovës, QRTK, KKTK etj.<br>- Vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, pasuria e trashëgimisë kulturore në Klinë.<br>- Shënimi i Ditës së Trashëgimisë, objekteve dhe lokaliteteve – 18 prill (Ekspozitë me eksponante dhe fotografi realizuar nga prof. Masar Valla – Arkeolog).<br>- Gërmime dhe punime të tjera të nevojshme në Dresnik.<br>- Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe turizmi ( Përgatitja e një guide turistike).<br>- Inventarizimi i trashëgimisë kulturore.<br>- Strategjia komunale e trashëgimisë kulturore.<br>- Mbledhja e eksponateve të ndryshme arkeologjike brenda territorit të Klinës dhe vendosja e tyre në muze.<br>- Projekti për pastrimin e gurëve në hyrje të shtëpisë së kulturës dhe vendosja e pllakave metalike për ruajtjen dhe emërimin e tyre.<br>- Përpilimi i projekti për kishën e "Shën Pjetrit" në Ujmirë, pastrimi dhe shtrimi i shtegut që dërgon të kisha.<br>- Përpilimi i hartës së trashëgimisë kulturore të komunës së Klinës dhe vendosja e tyre në disa pika kryesore të qytetit.<br>- Shenjëzimi i objekteve të trashëgimisë kulturore brenda territorit të komunës së Klinës. | -Për shkak të kostove të larta që kërkohen për realizimin e këtyre projekteve mund të jetë e nevojshme kohë më e gjatë dhe bashkëfinancim me institucione më të larta dhe organizata ndërkombëtare.<br><br>-Krijimi i një guide për trashëgimi dhe turizëm është parësore meqenëse komuna nuk e ka ende një të tillë.<br><br>-Formimi i një komisioni për punë në terren dhe sigurimi i kushteve për këto vizita. |

## 6. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

### FUSHËVEPRIMTARIA

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtoria ka këtë fushëveprim:

- Mbikëqyrja e punës së QKMF-së, QMF-së, AMF-së dhe QPS-së;
- Hartimi i strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor, imunizimin, diagnostikimin e parë dhe kujdesin themelor shëndetësor, promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik;
- Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare;
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e Qendrës për Punë Sociale dhe përmes saj siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të specifikuara nga ministria përkatëse;
- Përmes QPS siguron implementimin e plotë të infrastrukturës ligjore që rregullojnë përkujdesjen e rasteve sociale të popullatës së Komunës, përmes shpërndarjes së drejtë të ndihmës sociale;
- Mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës;
- Të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbajtur udhëzimeve nga MSH dhe Kuvendi i komunës;
- Vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, liron kategoritë e caktuara të shoqërisë; brenda kornizës së caktuar nga MSH dhe Kuvendi komunal;
- Siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës;
- Raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara, kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
- Zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSH dhe DSHMS;
- Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të aprovuara nga MSH dhe Kuvendi i Komunës;
- Bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal;
- Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët;

- Ushtron edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statutit të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror.

| Objektivat | Veprimet/hapat | Afati kohor | Bashkëpunimi | Rezultatet e pritshme | Vështirësitë/sfida | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët. | Rritja e numrit të shërbimeve mjekësore, furnizimi me medikamente për pacientët, shërbimet e patronazhes, etj. | Janar - Dhjetor | QKMF – Komunë - MSh - Donatorë | Përmirësimi dhe rritja e shërbimeve mjekësore për të gjithë qytetarët pa dallim moshe e përkatësie etnike. | | |
| Rritja e imunizimit/ Vaksinimi kundër Covid 19, vaksinimi kundër gripit sezonal. | Rritja e kapaciteteve humane për vaksinim të vazhdueshëm kundër Covid 19 dhe gripit sezonal. | Janar - Dhjetor | DSHMS QKMF | Rritja e imunizimit kundër Covid 19. | | Të organizohen fushata sensibilizuese për vaksinim. |
| Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore: Objekti i Emergjencës, QMF, AMF | Krijimi i hapësirave të reja dhe renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore. | Mars - Tetor | DSHMS QKMF Zyra e prokurimit Zyra e projekteve Donatorë | Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet shëndetësore. | Buxheti Stafi | |
| Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore. | Trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante. | Janar - Dhjetor 2023 | DSHMS QKMF Donatorë | Përmirësimi i performancës së stafit. | Buxheti | |
| Vazhdimi i bashkëpunimit me donatorë ekzistues dhe takimet e reja me donatorët potencial. | Prezantimi i objektivave tona parësore dhe projektet e planifikuara dhe prezantimi para tyre. | Në vazhdimësi | DSHMS QKMF | Rritja e gamës së shërbimeve. | . | |
| Vazhdimi i projektit “Vizitat sistematike shëndetësore në shkolla” | Përgatitja e projektit, sigurimi i aspekteve teknike. | Shkurt -Nëntor | DSHMS QKMF DKA | Vizita mjekësore, regjistrimi, analiza dhe prezantimi i shëndetit publik të nxënësve. | Buxheti Stafi | |
| Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikim – Rëntgen dhe Laborator. | Rritja e gamës së analizave, menaxhimi me kujdes i reagensëve, digjitalizimi i kabinetit të RTG. Rritja e numrit të analizave laboratorike. | Janar - Dhjetor | DSHMS QKMF Donatorë | Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe rritja e shërbimeve ndaj pacienteve. | Buxheti | |
| Identifikimi i nevojave për furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe | Furnizimi me pajisje mjekësore ngritë dhe | Janar - Mars | DSHMS QKMF Donatorë | Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në | Buxheti | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| AMF. | përmirëson shërbimet mjekësore. | | | QKMF dhe AMF. | | |
| Programi për kujdesin mjekësor për të moshuarit.<br>Programi për kujdesin paliativ dhe pacientëve terminal.<br>Kujdesi mjekësor për komunitetet pakicë. | Ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk mund të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF. | Janar - Dhjetor | DSHMS<br>QKMF<br>Donatorë | Përkujdesje shëndetësore për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për përkujdesje. | Buxheti | |
| Plotësimi korrekt i recetave të barnave.<br>Plotësimi i protokolleve shëndetësore (Me të gjitha të dhënat e plota). | Koordinatori i cilësisë në QKMF do të monitorojë veprimet. | Janar - Dhjetor | DSHMS<br>QKMF | Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe AMF. | | |
| Programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijët 0-3 vjeç.<br>Programi i vizitave në shtëpi synon të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve 0-3 vjeç dhe grave shtatzëna. | Të shtatzënat realizohen dy vizita, tek fëmijët realizohen gjithsej 5 vizita nga lindja deri në moshën 3 vjeçe. | Janar - Dhjetor<br>Targeti për vitin 2023 është 2340 vizita, vizitat duhet të realizohet nga punëtorët shëndetësorë të trajnuar dhe certifikuar nga M.SH. | DSHMS<br>QKMF<br>Donatorë | Përkujdesje shëndetësore për të gjitha nënat dhe fëmijët 0-3 vjeç.<br>Gjatë vizitave, profesionistët shëndetësorë këshillojnë dhe ndihmojnë familjet për zhvillim të shëndetshëm; ushqyerje, siguri të fëmijëve, mirëqenie prindërore. | | |

**<u>QKMF / QMF / AMF - Objektivat kryesore gjatë vitit 2023</u>**

## QENDRA PËR PUNË SOCIALE NË KLINË

### Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Familjare

| Objektivat | Veprimet/hapat | Afati kohor | Bashkëpunimi | Rezultatet e pritshme | Vështirësitë/sfidat | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aplikimi në përpikëri e standardëve minimale të përcaktuara nga MFPT/DPSF. | Për çdo ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, të udhëzohemi se si te veprohet nga Standardet Minimale. | Gjatë vitit 2023. | Drejtori, Udhëheqësja e Shërbimeve dhe zyrtarët e shërbimeve Sociale në QPS. | Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare. | Hezitimi i bashkëpunimit të kërkuesit të shërbimeve me ofruesin e shërbimeve në zbatimin e standardeve minimale. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe familjare duke i vendosur ato më pranë nevojtarëve. | Të organizohen takime më të shpeshta me komunitetin, shkollat, institucionet shëndetësore, organizatave ofruese të shërbimeve, komunitetit ndërfetar etj, për një informim më të mirë për referimin e personave në nevojë për shërbime sociale në Institucione të duhura që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. | Takime të tilla do të organizohen gjatë tërë vitit 2023. | QPS, Shkolla, QKMF, OJQ, përfaqësues komunitetesh, etj. | Trajtimi dhe kujdesi për persona/familje në nevojë sociale dhe ofrimi i shërbimeve më profesionale. | Mungesa e takimeve të rregullta të përfaqësuesve nga Institucionet ndërsektoriale Komunale. | |
| Rritja e cilësisë së Shërbimeve Sociale dhe Familjare. | Do angazhohemi në avancimin e formave alternative të mbrojtjes për të gjitha grupmoshat. Mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla herë pas here, përgatitja e fletushkave në lidhje me shërbimet që ofron QPS etj. | Gjatë tërë vitit 2023 | QPS, DPSF, Gjykata, Policia, Shkolla, OJQ, përfaqësues komunitetesh etj. | Shërbimet do të jenë më afër atyre që kanë nevojë për shërbime sociale. | Mos investimi në zhvillim të qëndrueshëm profesional të zyrtarëve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare qoftë nga MPMS apo nga Komuna. | |
| Planifikimi buxhetor për QPS-në. | Planifikimi për nevojat buxhetore të QPS-së, për vitin 2023, duke u bazuar në kostot e shërbimeve të ofruara, dhe të njëjtin planifikim do e dorëzojmë në kohën e duhur në Institucionet përkatëse për aprovim. | Qershor-Dhjetor 2023 | QPS, DSHMS, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe zhvillimit. | Ndarja e një buxheti që plotëson nevojat e QPS-së. | Mungesa e një zyrtari financiar në QPS, si dhe mos vullneti i Institucioneve Komunale për një qasje më pozitive në raport më kërkesat e QPS-së, për buxhetim të Institucionit tonë. | |
| Gjetja dhe trajnimi i familjeve strehuese. | Organizimi i fushatave sensibilizuese duke shfrytëzuar radion lokale, fletushkat informuese etj, në lidhje me rëndësinë e familjeve strehuese, kriteret, përfitimet, trajnimet etj. Në mënyrë që të kemi të gatshme 1-2 familje strehuese. | Janar-Prill 2023 | QPS, DSHMS, DPSF, Radio lokale, OJQ, përfaqësues komunitetesh etj. | Përgatitja e familjeve, të gatshme për strehim familjar të fëmijëve pa përkujdesje familjare. | Mosgatishmëria e familjeve që të marrin në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare edhe përkundër pagesës që bëhet nga ana e MFPT-së. | |
| Rritja e përkushtimit në mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje familjare, fëmijëve me sjellje asociale, rritja e përkushtimit në punën kundër dhunës në familje, | Jetësimi në përpikëri i Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve, vendimeve, standardeve minimale të shërbimeve sociale dhe familjare etj. Puna në terren, takimet formale dhe jo formale ndërsektoriale me të gjithë faktorët që kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve. | Gjatë tërë vitit 2023 | QPS, DSHMS, DPSF, OJQ, Institucione rezidenciale, Strehimore, Shkolla, Polici, Prokurori, Gjykata, përfaqësues komunitetesh etj. | Të ofrojmë shërbime sa më profesionale dhe sa më afër njerëzve në nevojë. | Mungesa e kuadrove profesionale, sidomos e psikologut dhe zyrtarit financiar etj. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore, strehimin familjarë, kujdestarinë, kontaktin e fëmijëve me prindërit e tyre, do e rrisë kujdesin ndaj personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, personat me nevoja të veçanta si dhe do e rrisë angazhimin në parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve. | | | | | | |

## Sektori i Ndihmave Sociale

| **Objektivat** | **Veprimet/hapat** | **Afati kohor** | **Bashkëpunimi** | **Rezultatet e pritshme** | **Vështirësitë /sfidat** | **Vërejtje** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përkrahja financiare e familjeve në gjendje të rëndë ekonomike, në përputhshmëri me kriteret e parapara në Ligjin e Skemës për Ndihma Sociale. | Identifikimi në terren dhe përzgjedhja e familjeve nevojtare, dhënia e informacioneve të duhura për aplikim për ndihmë sociale etj. | Gjatë tërë vitit 2023 | QPS, DPSF, përfaqësues komunitetesh, OJQ etj. | Të gjitha familjet në nevojë, që i plotësojnë kriteret e parapara për ndihmë sociale, të futen në skemë. | | |
| Rishikimi me kujdes të shtuar i të gjitha dosjeve, të familjeve përfituese të Ndihmave Sociale. | Në afatin sa më të shkurtër të rishikohen të gjitha dosjet e përfituesve të NS, në mënyrë që të evidentohen gabimet e mundshme që janë bërë me | Janar – Prill 2023 | Sektori i Ndihmave Sociale | Të kompletohen të gjitha dosjet me dokumentacionin e duhur, ashtu siç parashihet me Ligj dhe udhëzime administrative. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rastin e pranimit të dokumentacionit. | | | | | |
| Respektimi i afateve ligjore për procedim me kohë të kërkesave për Ndihmë Sociale. | Të gjitha kërkesat për Ndihmë Sociale, të procedohen me kohë (pranim të kërkesës, verifikim në teren, futje në bazë). | Gjatë tërë vitit 2023 | QPS-DPSF | Të procedohen me kohë të gjitha kërkesat për Ndihmë Sociale. | Problemet e vazhdueshme me bazën e shënimeve gjatë futjes së të dhënave, pastaj koha e shkurtër në dispozicion për futjen e këtyre të dhënave/ri-aplikim etj. | |

## Investimet kapitale dhe financimet tjera në shëndetësi dhe mirëqenie sociale

| **Objektivat** | **Veprimet/hapat** | **Afati kohor** | **Bashkëpunimi** | **Rezultatet e pritshme** | **Vështirësitë/sfidat** | **Vërejtje** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i një shtëpie rezidenciale për personat e moshuar pa përkujdesje familjare. | Shpronësimi i pronës për ndërtim dhe fillimi i ndërtimit. | 2023 - 2024 | Komuna DSHMS - MFPT | Ndërtimi i objektit. | | |
| Ndërtimi dhe renovimi i hapësirave shëndetësore. | Ndërtimi i objektit të ri të Urgjencës.<br>Renovimi i hapësirave ekzistuese të QKMF, QMF, AMF. | Shkurt – nëntor 2023 | DSHMS<br>Donatorë | Përmirësimi i kushteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. | | |
| Furnizim me barna,<br>Furnizim me pajisje mjekësore,<br>Furnizim me material shpenzues për | Planifikimi buxhetor është bërë për blerjen e barnave, pajisjeve mjekësore dhe materialit shpenzues për rëntgen e laborator. | Shkurt-Nëntor | DSHMS | Qëndrueshmëri në furnizim me barna dhe pajisje mjekësore në QKMF dhe QMF e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| röntgen e laborator. | | | | AMF. | | |

**<u>Qendra për Punë Sociale në Klinë gjatë vitit 2023 do të angazhohet edhe në punë dhe detyra tjera si:</u>**

- Ofrimi i përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për të gjithë banorët e komunës pa dallim;

- Zbatimi i konceptit të punës dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale;

- Ofrim i drejtpërdrejtë i përkujdesjes sociale, këshillimit, ndihmës financiare/ materiale, për rastet në nevojë sociale brenda territorit të komunës;

- Respektimi dhe implementimi i të gjitha ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara;

- Zhvillimi i aktiviteteve me qëllim sigurimi të fondeve apo ndihmave tjera materiale nga organizatat joqeveritare që merren me veprimtari përkatëse;

- Sigurimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda komunës se Klinës, sipas standardeve të specifikuara nga MPMS;

- Administrimi me kujdes i Skemës së Ndihmave Sociale;

- Ndërmarrja e hapave për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të komunës;

- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe MPMS-në, me qëllim të realizimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale;

- Përpilimi i planit operativ dinamik të QPS-së, lidhur me detyrat dhe obligimet e Institucionit, si dhe raportimi me kohë për DSHMS e DPSF;

- Koordinimi i punës me Komisionin Rajonal Mjekësor, si dhe informimi me kohë i aplikantëve, në lidhje më vendimet e Komisionit Mjekësor;

- Organizim të mbrojtjes së të miturve pa kujdes prindëror, dhe realizim të formave adekuate të mbrojtjes;

- Organizim të mbrojtjes së të miturve të rrezikuar dhe keqtrajtuar;

- Organizim të mbrojtjes së të rriturve që shfrytëzojnë substanca psiko-aktive;

- Organizim të mbrojtjes së fëmijëve të prindërve të shkurorëzuar;

- Organizim të mbrojtjes së të miturve dhe të rriturve më nevoja të veçanta;

- Organizim të mbrojtjes së personave të moshuar dhe pa kujdes familjarë;

- Organizim të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit;

- Respektimin dhe implementimin e Marrëveshjeve të mirëkuptimit të lidhura në mes MPMS, DSHMS dhe Organizatave tjera joqeveritare, për mbrojtjen e kategorive të veçanta të qytetarëve.

## 7. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI

Punët të cilat realizohen dhe planifikohen të realizohen në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës, raportohen çdo vit. Duke parë faktin se kjo drejtori është komplekse, pavarësisht punëve dhe objektivave të cilat janë përmbushur gjatë vitit 2022, përsëri përballemi me probleme për të cilat nevojitet angazhim dhe punë për zgjidhjen e tyre gjatë vitit 2023.

Në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, përveç punëve të cilat planifikohen të bëhen, ofrohen edhe shërbimet ditore si:

- Zyrtarët për pranimin e qytetarëve të cilët ofrojnë këto shërbime:

1. Lëshimi i certifikatës për pronë,
2. Lëshimi i certifikatës që nuk posedon pronë,
3. Lëshimi i certifikatës për social.

**- Zyrtari për shërbim pronësoro-juridik që ofron këto shërbime:**

1. Kryen të gjitha punët juridike dhe administrative në shërbimin pronësoro – juridik, si p.sh., përgatitja e shkresave profesionale për punët zyrtare kadastrale dhe pronësore;
2. Harton regjistrin e uzurpimeve të pronës komunale dhe mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme;
3. Kryen të gjitha procedurat administrative lidhur me shpronësimet dhe veprimet tjera procedurale sipas kërkesave të subjekteve tjera apo edhe Komunës sipas Ligjit për Shpronësimet.

**- Zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të paluajtshme që kryen këto shërbime:**

1. Kryen bartjen e pronësisë në bazë të dokumenteve valide ligjore dhe të verifikuara si nga noteri, gjykata, dhe vendimet tjera të organeve administrative;
2. Nxjerr aktvendimet mbi regjistrimin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave;

3. Kryen regjistrimin e paluajtshmërive, hipotekave, barrave tatimore dhe nxjerr aktvendimet për to;

4. Nxjerr aktvendimet mbi legalizimin e objekteve, lokaleve, shtëpive në Geoportal pas azhurnimit të gjeodetit në Geoportal.

**- Zyrtarët gjeodet ofrojnë këto shërbime:**

1. Bënë sigurimin e hartave Orto-foto, rikunstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, dhe ofron shërbime përmes modelit të sistemit informativ mbi tokën dhe pronën;

2. Bënë lëshimin e kopjeve të planit;

3. Bënë matjet për nevoja komunale dhe me kërkesë të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë;

4. Mban regjistrin zyrtar të zonave kadastrale si dhe regjistrimin e ngastrave kadastrale, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave, përçuesve dhe objekteve nëntokësore, regjistrimit të pronës dhe punët tjera në kuptim me Ligjin për Kadastrin dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;

5. Harton raporte, historiate dhe ekspertiza të pronave sipas kërkesave zyrtare.

**Ndër objektivat kryesore që planifikohen të realizohen në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi gjatë vitit 2023 janë:**

**1. Informimin me kohë të qytetarëve për miratimin apo refuzimin e kërkesës së tyre dhe kryerjen e lëndëve sipas afateve kohore.**

- Çdo qytetar do të informohet me kohë nga zyrtarët e sportelit për lëndën e tyre se a është përfunduar, a është në proces apo është refuzuar, gjithashtu qytetarët do të informohen edhe për arsyet e refuzimit të kërkesës së tyre.

- Po ashtu, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të bëhet kryerja e të gjitha lëndëve brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës, si për legalizim, historiate, ndarje - bashkim të parcelave, kontratave të noterit, urdhëresave të gjykatës, prokurorisë etj.

**2. Zgjidhja e problemit të disa zonave komunale të cilat nuk janë të regjistruara në Geoportal.**

- Një numër i madh i qytetarëve ankohen si shkak i mungesës se regjistrimit të parcelave të tyre në sistemin Geoportal, prandaj Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, në bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencionin Kadastral të Kosovës, do të jetë në shërbim të qytetarëve duke trajtuar në përpikëri ankesat e tyre rreth kësaj çështje dhe ofrimin e shërbimeve më efikase për zgjidhjen e këtij problemi të trashëguar.

**3. Përgatitja dhe publikimi i listës së veçantë dhe të përgjithshme të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023 në bazë të legjislacioneve në fuqi.**

- Sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Komunat janë të obliguara që ta publikojnë listën e përgjithshme të pronave dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ka përgatitur këto dy lista të cilat janë publikuar në ueb-faqen e komunës së Klinës dhe të gjitha procedurat për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim do të udhëhiqen sipas legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi, si: Ligji Nr 06/l-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme.

**4. Mbështetja e drejtorive të tjera brenda Komunës së Klinës për ofrimin e shërbimeve.**

- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të jetë vazhdimisht në dispozicion të ofrimit të shërbimeve të nevojshme edhe për drejtoritë e tjera të cilat funksionojnë në Komunën e Klinës, si për matjet e nevojshme në terren, ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve të tjera, siç janë: përgatitja e koordinatave, certifikata të pronësisë, kopje të planit, ortofoto të parcelave etj.

**5. Udhëheqja e procedurave për shpronësim të pronës shtetërore për nevoja komunale nga zyra për shërbim pronësoro-juridik.**

- Të gjitha procedurat e nevojshme për shpronësim të pronave komunale do të udhëhiqen nga zyra për shërbimin pronësoro-juridik në bashkëpunim me Zyrën Ligjore Komunale, konform legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi, të cilat janë të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

**6. Zbatimi i Rregullores NR.07/2021 mbi pezullimin e shërbimeve komunale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë.**

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, gjatë vitit 2023 do ta zbatojë në përpikëri rregulloren NR.07/2021 mbi pezullimin e shërbimeve komunale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë.

Si objektiv i këtij Udhëzimi Administrativ për Drejtorinë e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë është:

- Pa pagesat e tatimit në pronë në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, nuk pranohen lëndët e noterit dhe të gjykatës për nevoja të ndryshe, p.sh., ndërrimit të parcelave, shitblerjeve, trashëgimi etj.

**7. Mbajtja tabelare e raportit financiar të pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarja përgjegjëse dhe zyrtarët në sportel.**

- Pas çdo muaji nga drejtori përkatës i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të kërkohet raporti financiar prej gjeodetëve, zyrtares përgjegjëse dhe zyrtarëve në sportel dhe ato pagesa do të kompletohen në formë tabelare gjatë tërë vitit. Gjithashtu, gjeodetët pas çdo muaji do të obligohen që barazimin e tyre ta bëjnë me zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

**8. Trajnimi i gjeodetëve dhe juristit në Agjencionin Kadastral të Kosovës për punët gjeodezike, ndërsa juristi do të trajnohet për përpunimin e aktvendimeve për Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.**

Gjeodetët dhe juristët vazhdimisht do të dërgohen në trajnime profesionale të cilat organizohen gjatë tërë vitit në Agjencionin Kadastral të Kosovës.

- Gjeodetët në theks të veçantë do të mbajnë trajnime për ndarjen–bashkimin e parcelave, për caktimin e kufijve të parcelave, për legalizimin e objekteve në Geoportal dhe punëve të tjera gjeodozike.

- Ndërsa juristët në trajnimet të cilat organizohen nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, do të trajnohen në programin për ndarjet në RDPP dhe lëshimin e aktvendimeve për kontratat e noterit, lëndët e gjykatave, lëndët e gjeodetëve, hipotekat, barrat tatimore, urdhëresat e prokurorisë, gjykatës etj.

Këto objektiva të lartcekura janë të planifikuara për realizim gjatë vitit 2023 në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, në Komunën e Klinës.

## 8. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

| PLANI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2023 | | | |
|---|---|---|---|
| -Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, pranë Komunës së Klinës, gjithë fushëveprimtarinë e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, Rregulloreve që janë në fuqi dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të Kuvendit të Komunës së Klinës. | | | |
| DREJTORIA | **Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit, veprojnë:** | **Në kuadër të kësaj Drejtorie ushtrohen këto veprimtari:** | vërejtje |
| | Shërbimi i ndërtimit dhe banimit | - Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit,<br>- Legalizimi,<br>- Punët dhe aktivitetet që delegohen nga drejtoria,<br>- Certifikata përdorimi,<br>- Pëlqime komunale,<br>- Referenca,<br>- Vërtetime,<br>- Mirëmbajtja e sistemit te adresave . | |
| | Zyra për Mbrojtje të Mjedisit | - Për vitin 2023 është paraparë aprovimi i planit lokal për veprim në mjedis,<br>- Shqyrtimi dhe vendimet e kërkesave për leje Mjedisore Komunale,<br>- Identifikimi dhe regjistrimi i deponive ilegale, së bashku me MMPH –në dhe GIZ-in,<br>- Përgatitja e paramasës dhe parallogarisë për eliminimin e deponive ilegale,<br>- Aksioni i pastrimit për largimin e deponive ilegale,<br>- Aksioni i pastrimit në pjesën urbane,<br>- Pastrimi i parkut të qytetit –afër lumit,<br>- Mbikëqyrja e fshirjes së rrugëve nga K.R.M “Ambienti“,<br>- Zbatimi i projekteve nga plani komunal për menaxhim të mbeturinave,<br>- Aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”,<br>- Aksione vetëdijesimi nëpër shkolla. | |
| | Planifikimi Urban | - Punët dhe aktivitetet rreth urbanizmit-planifikimit,<br>- Udhëzime për kushte ndërtimore,<br>- Kushtet ndërtimore,<br>- Hartimi, implementimi dhe monitorimi i planeve strategjike në nivel komune, si:<br>- PZHK,<br>- PHRRU,<br>- HZK. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Zyra për Projekte | - Punët dhe aktivitetet rreth urbanizmit – planifikimit,<br>- Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projekt -propozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa etj,<br>- Menaxhimi i kontratave,<br>- Mbikëqyrja e ecurisë së punimeve për të gjitha projektet,<br>- Pranime teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera si dhe bënë inspektime në terren sipas kërkesave të palëve. | |

| | | |
|---|---|---|
| DREJTO RIA | **Duke u bazuar në detyrat dhe kërkesat të parashtruara në këtë drejtori deri në implementimin e tyre komfor ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, të nxjerra nga organet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës, kemi hartuar planin njëvjeçar të punës për vitin kalendarik janar-dhjetor 2023 si në vijim:** | vërejtje |

- Implementimi i Hartës Zonale, PZHK,
- Shtimi i efikasitetit në organizimin dhe zhvillimin e sektorëve duke filluar nga stafi dhe vazhdimi i shqyrtimit të lëndëve,
- Realizimi i planit rreth kompensimit të taksave ndërtimore të cilat na janë ngarkuar nga plani dinamik i drejtorisë,
- Ndihmë me këshilla profesionale si dhe menaxhimin adekuat për përdorimin e tokës në pronësi komunale për shfrytëzime të përgjithshme dhe të detajuar,
- Ndihma profesionale në planifikim të shfrytëzimit, sanimit, rrënimit të objekteve që paraqesin rrezik për mjedisin,
- Përgatitja e projekt-propozimeve për aplikim të donatorët e ndryshëm,
- Përgatitja e detyrave projektuese,
- Përgatitja e raporteve të punës,
- Përgatitja e kushteve ndërtimore për projektim, ndërtim, rindërtim,
- Përgatitja e lejeve të ndërtimit,
- Përgatitja e lejeve të legalizimit,
- Përgatitja e lejeve mjedisore komunale,
- Përgatitja e certifikatave të përdorimit,
- Pëlqime komunale,
- Referenca,
- Vërtetime,
- Mirëmbajtja e sistemit të adresave,
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e kontratave për projektet kapitale,
- Me rastin e implementimit të projekteve të ndryshme investive, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, jep këshilla profesionale arkitektonike ndërtimore për zgjidhjen e tyre,
- Ndihmë profesionale Drejtorisë për Shërbime Publike në lidhje me ambientin dhe projekteve që menaxhohen nga ajo,
- Ndihmë profesionale Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi si dhe Drejtorisë për Bujqësi rreth mbikëqyrjes dhe menaxhimit të projekteve kapitale që realizohen në kuadër të këtyre drejtorive,
- Zbatimi i të gjitha normave ligjore ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit që janë në përputhje me organizatat e ndryshme botërore në fushën e mjedisit,
- Mbrojtja e mjedisit do të jetë pjesë e politikave, planeve zhvillimore e sektorëve të ndryshëm.
- Shënimi i datave mjedisore në veçanti, si:
    - Dita e tokës - 22 prilli,
    - Ta pastrojmë Kosovën - 24 maji,
    - Dita e mjedisit - 5 qershori.
- Sensibilizimi dhe ruajtja e monumenteve natyrore në komunën tonë,
- Sensibilizimi dhe ruajtja e mjedisit,
- Largimi i deponive ilegale.

<table>
<tr><td rowspan="3">DREJTORIA</td><td rowspan="3">PROJEKTET</td><td colspan="3">Gjatë vitit kalendarik 2023 planifikojmë t`i realizojmë këto projekte:</td></tr>
<tr><td>Të bartura nga viti paraprak</td><td>- Asfaltimi i rrugës Stupë-Zajm, faza 3,<br>- Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktura nëntokësore Ranoc-Leskoc-Zllakuqan,<br>- Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktura nëntokësore Dresnik –Dollc,<br>- Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë,<br>- Ndërtimi i stacionit të autobusëve,<br>- Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijshëm,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Klinë,</td><td></td></tr>
<tr><td>Projekte të reja 2023</td><td>- Projektet nga grandet e performancës,<br>- Projekte nga donatorët,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë,<br>- Ndërtimi i parkut industrial Klinë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Caravik-Çabiq,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Zajm-Deiq,<br>- Ndërtimi i rrugës dhe urës Budisalc-Rudicë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë-Jagodë Paskalicë-Krushevë e Madhe,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinafc,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë,<br>- Asfaltimi i rrugëve Shtupel –Kerrnicë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollovë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Gremnik,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Jashanicë-Jelloc,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Shtupel-Kërrnicë-Binxhë-Grapc,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Sferkë-Volljakë-Qupevë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Qeskovë,<br>- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Klinës,<br>- Rregullimi i shtratit të lumit Klina,<br>- Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Gryken e Jarinës-Pogragjë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Gjurgjevik i Madh, Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Përqevë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Zllakuqan –Pataqan – Berkovë,<br>- Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Krushevë e Vogël,<br>- Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e ngrohjes qendrore në qytetin e Klinës.</td><td></td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | -Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, do të bëjë edhe punë tjera, si mbikëqyrje të punëve dhe pranime teknike për të gjitha projektet e cekura më lartë, inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe parallogari për rrugë, objekte, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, kërkesa, raporte, procesverbale, shkresa, pjesëmarrje në komisione të ndryshme, etj. | |

## 9. DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**Misioni:**

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), ka për objektiv udhëheqjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues, të fokusuar në zhvillimin e bujqësisë, mbështetjen e fermerëve të komunës së Klinës, menaxhimin e stafit të drejtorisë, burimeve financiare dhe koordinimin e aktiviteteve bujqësore dhe zhvillimit rural me agjencionet tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Vizioni i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është të koordinojë punët me të gjithë akteret të cilët kanë për qëllim mbështetjen e aktiviteteve bujqësore, të koordinojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e gjuetisë dhe pylltarisë.

**Sektori i bujqësisë gjatë vitit 2023 planifikon t'i zhvillojë aktivitetet si në vijim:**

- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga fermerët dhe qytetarët,

. Dhënia e certifikatave nga regjistri i fermerëve (NIF),

. Lëshimi i vërtetimeve për fermerë.

Duke marrë parasysh se bujqësia është një lëmi e gjerë, ku përfshinë shumë sektorë për të cilat në vazhdim do t`i specifikojmë me të dhëna konkrete dhe aktivitet të cilat zhvillohen:

**Lavërtaria**-të përgatisë planin për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore në territorin e komunës së Klinës, dhënia e këshillave për:

- Përdorimin e farërave cilësore për mbjellje,
- Plehrave cilësore sipas përbërjes kimike për secilën kulturë bujqësore,
- Përdorimin e pesticideve përkatëse për çdo kulturë,
- Monitorimi i mbjelljeve vjeshtore dhe pranverore,
- Organizimi i trajnimeve për sëmundjet e kulturave lavërtarie,
- Përgatitja e planit për korrje-shirje dhe formimi i komisionit komunal për monitorimin fushatës së korrje-shirjeve,
- Vizitat në pikat grumbulluese dhe mullinjve.

**Perimtaria:** Duke e ditur se perimtaria është degë mjaftë profitabile dhe ndikon në zhvillim ekonomik, ne si drejtori në vazhdimësi këshillojmë fermerët:

- Për kultivimin e fidanëve sa më cilësore, të perimeve si në ambiente të hapura dhe në ato të mbyllura,
- Mbrojtjen e perimeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit,
- Ujitjen e perimeve sipas nevojës te secili lloj i perimeve.

**Blegtoria, bletaria:**

. Evidentimi i numrit të gjedhëve, deleve, dhive, derrave, pulave,

. Vizitë fermave blegtorale për qumësht dhe për majmëri,

. Dhënia e këshillave për higjienën e kafshëve në fermë,

. Këshillime për përdorimin e ushqimit të kafshëve,

. Këshillimi i fermerëve për përditësimin e të dhënave,

. Organizimi i trajnimeve për sëmundjet e ndryshme të kafshëve dhe shpezëve,

. Evidentimin e numrit të shoqërive të bletëve,

. Organizimi i trajnimeve lidhur me sëmundjet dhe dëmtuesit e bletëve,

. Shpërndarja e fletushkave për bletarët.

**Pemëtaria:**

. Evidentimi i pemishteve,

. Këshilla profesionale në ngritjen e pemishteve,

. Këshillimi i fermerëve për krasitjen e pemëve,

. Këshillimi i fermerëve në përdorimin e plehrave cilësore në pemishte,

. Mbrojta nga sëmundjet dhe dëmtuesit,

. Ujitjen e pemëve,

. Ruajta e frutave të pemëve,

. Dhënia e fletushkave me tema për pemëtari,

. Ngritja e pemishteve të reja në bashkëpunim me donatorë.

**Sektori i Pylltarisë gjatë vitit 2023 planifikon t`i zhvillojë aktivitetet si në vijim:**

- Të bëjë kontrolle të rregullta të terrenit në të gjitha rajonet ekonomike pyjore që janë në pronësi shoqërore, të intervenojnë në ato vende ku ka uzurpime (pushtime) dhe zjarre, me qëllim që t'i mbrojë ato nga zjarri dhe uzurpimet e paligjshme;

- Të bëjë pranimin dhe regjistrimin e fletëparaqitjeve në Librin e Autoritetit Pyjor Komunal;

- Të bëjë përgatitjen dhe dërgimin e fletëparaqitjeve në Gjykatën Themelore Pejë–Dega në Klinë, divizionin për kundërvajtje;

- Të përfaqësojë lëndët e zyrës së pylltarisë në Gjykatën Themelore Pejë – Dega në Klinë;

- Të bëjë përgatitjen dhe dërgimin e kallëzimeve penale në Prokurorinë Themelore në Pejë;

- Pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura tokësore në bashkëpunim me agresionin e pylltarisë;

- Të bashkëpunojë me zjarrfikësit, Agjencinë Pyjore dhe Policinë e Kosovës gjatë gjithë vitit, të organizojë aksione të kohëpaskohshme me qëllim të kontrollimit të shitësve dhe transportuesve të druve, se a janë pajisur me dokumentacione përkatëse të lëshuara nga organi kompetent;

- Të pranojë dhe shqyrtojë kërkesat e parashtruara nga qytetarët për prerjen e pyjeve private;

- Të përgatisë dhe dërgojë raportet mujore në drejtorinë koordinuese të APK-së në Pejë;

- Të bëjë regjistrimin e dëmeve pyjore, në të gjitha rajonet ekonomike pyjore, të shkaktuara nga faktori njeri dhe nga zjarri;

- Planifikon të kryejë edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrit të drejtorit të Drejtorisë.

**DBPZHR planifikon t`i realizojë edhe këto aktivitete gjatë vitit 2023:**

- Të informojë fermerët rreth grandeve dhe subvencioneve që jepen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), përkatësisht Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

- Të pranojë aplikacionet e fermerëve për subvencionimin e pagesës direkt për sipërfaqet e mbjella me grurë, misër, tërshërë, elb, pemë, perime, bletë dhe për bagëti (lopë, dele, dhive, dosa etj.);

- Të pranojë aplikacionet e fermerëve për subvencionimin e qumështit, i cili bëhet çdo gjashtë (6) muaj;

- Planifikon të ndërtojë kanalet për ujitje të tokave bujqësore në fshatrat Dollovë, Jagodë, Deiq dhe Krushevë e Madhe;

- Të ndërtojë pendën në fshatin Grabanicë;

• Planifikon t'i subvencionojë fermerët me sera, makina mjelëse, makina mbjellëse të grurit, freza, motokultivator, shkrirëse dylli për bletë dhe mjete të tjera;

• Të organizojë trajnime profesionale për fermerë nga lëmia e blegtorisë, lavërtarisë, pemëtarisë, perimtarisë, bletarisë etj;

• Të vizitojë kohë pas kohe fermerët, me qëllim të përcjelljes së gjendjes së të mbjellave vjeshtore dhe pranverore dhe monitorimit për së afërmi të kultivimit të pemëve, perimeve, blegtorisë dhe bletarisë;

• Planifikon të kryej edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrit të drejtorit të Drejtorisë;

Po ashtu, organizojmë trajnime për fermerë në bashkëpunim me departamentin e shërbimeve këshillimore në nivel të Ministrisë së Bujqësisë me tema të caktuara, shpërndarjen e broshurave për fermerë.

## 10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë muajve të ardhshëm të vitit 2023 do të angazhohet në bazë të detyrave dhe obligimeve të përshkruara në Statutin e Komunës së Klinës, dhe do të ndërmerr masa dhe aktivitete që kanë për qëllim ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve dhe performancës së përgjithshme si dhe përmirësimin e shërbimeve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në tërë territorin e komunës për shfrytëzimin e buxhetit të alokuar për vitin 2023. Posaçërisht do të fokusohemi në disa nga aktivitetet vijuese:

- **Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve).**

Gjithashtu, edhe në këtë vit do të vazhdohet me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve ekzistuese, posaçërisht shëtitorja përgjatë lumit "Klina", duke vazhduar me trendin e zgjerimit të këtyre hapësirave publike. Do të pastrohen nga mbeturinat e ndryshme, posaçërisht deponitë ilegale me inerte dhe mbetjet e ndërtim-demolimit. Do të mirëmbahet edhe parku i ri "Ilir Merturi", në mënyrë që të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të mbrohet nga dëmtimet.

Për këtë vit janë planifikuar 50,000€.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit.**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë më datë 30.11.2022 dhe është kontratë 3 vjeçare, të cilën e kemi kontraktuar dhe do ta bëjë dekorimin e qytetit të Klinës për festat e fundvitit.

Shuma e ndarë për këtë projekt është 50,000€ për 3 vite.

- **Mirëmbajtja e kamerave të qytetit.**

Edhe në vitin 2022 Komuna e Klinës, respektivisht DSHPE, ka bërë rregullimin dhe përmasimin e gjendjes së kamerave të qytetit të Klinës. DSHPE ka monitoruar situatën dhe ka bërë mirëmbajtjen e kamerave, duke ndërruar ato dhe duke zëvendësuar me të reja, ka aktivizuar akse të prishura.

Vlera e kontratës është *8,761.50*€, dhe kontrata është 3 vjeçare.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik**.

Komuna Klinës ka lidhur kontratë për mirëmbajtje të ndriçimit publik, duke lidhur kontratë për 2 vite dhe shuma e kontratës është 42,335€.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.**

Do të vazhdojmë me zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, në vende ku nuk ekziston. DSHPE ka paraparë që në vitin 2023 do të investojë 70,000€ për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, pasi që edhe ka kërkesa të shumta të qytetarëve. Po ashtu, investime tjera që komuna jonë do të fitojë nga Grandi i Performancës. Kemi lidhur kontratë 2 vjeçare për zgjerim të ndriçimit publik në fund të vitit 2022, me vlerë 95,885€, e cila do të vazhdojë në vitin 2023.

- **Riparimi dhe sanimi i gropave të rrugëve me asfalt.**

DSHPE do të investojë në kontratën e riparimit dhe sanimit të gropave dhe rrugëve me asfalt, ku do të intervenojmë për sanimin e gropave ku ka nevojë dhe sipas kërkesave të qytetarëve, dhe të bëhet mirëmbajtja e tyre. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, për vitin 2023 do të investojë 155,000€.

- **Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr**.
  Vazhdimisht kemi kërkesa të shumta për riparimin e rrugëve të paasfaltuara në të gjitha fshatrat dhe disa lagje brenda në qytet. Është përpiluar një listë me rrugë dhe fshatra të cilët kanë bërë kërkesa dhe janë vizituar në terren. Duke u bazuar në buxhetin e paraparë për 3 vitet e ardhshme dhe janë zhvilluar procedura të prokurimit. Për *këto 3 vite janë planifikuar* ***300,000Euro***

- **Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.**

Nevoja për trajtim të ujërave të zeza është problem madhor në komunën e Klinës, siç është edhe në tërë Kosovën, komuna e Klinës do të investojë 150,000€ në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

- **Blerja e kamionit me eskavator për shërbime publike.**

Komuna Klinës, përkatësisht DSHPE, ka nevojë për mjete të tilla që t`i kryej shërbime qytetarëve dhe projekteve të veta. Këto pajisje janë të domosdoshme që edhe në raste emergjente të kryej shërbime të ndryshme, andaj Drejtoria ka planifikuar që për vitin 2023 të investojë 50,000€ për posedimin e këtyre pajisjeve.

- **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve.**

Duke e kuptuar rëndësinë e pastrimit të rrugëve për arsye të marrjes së masave preventive për aksidente të mundshme në komunikacion, komuna Klinës ka lidhur kontratë në fund të vitit 2022, e cila vlenë për 6 muaj dhe do shërbejë për pastrimin e rrugëve dhe largimin e borës nga pjesët e rrezikuara.

- **Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë.**

Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë ka qëllim edhe stimulimin e fëmijëve që të dalin të lozin dhe të socializohen. Kemi planifikuar 5,000€.

- **Trajtimi i qenve endacakë**

Qentë endacakë janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që kemi pasur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Komuna e Klinës planifikon për vitin 2023 rreth 30,000€ kontratë për trajtimin e qenve endacakë, e cila sadopak do të përmirësojë gjendjen e qenve dhe me rëndësi të qytetarëve.

- **Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me rrymë elektrike.**
  Me kompaninë për mirëmbajtjen e rrjetit dhe furnizim me rrymë KEDS kemi kontakte të rregullta javore në nivele të drejtorisë dhe Nj.O në Klinë, ndërsa mujore me Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën Regjionale në Pejë. Jemi dakorduar që të bëjmë punë të përbashkëta në përmirësimin e rrjetit elektrik në fshatra, ndërrimin e shtyllave dhe instalimin e kabllove. Kemi kërkesa të shumta nga qytetarët e pothuajse të gjitha fshatrave, mirëpo duke marrë parasysh që KEDS është ndërmarrje e privatizuar për 99 vite, ndikimi ynë është shumë i kufizuar.
- **Zyra për alarmim, informim dhe koordinim** për vitin 2023 ka planifikuar:
  - Kryerjen e punëve në rajon e cila bën grumbullimin dhe distribuimin e informatave nga bashkësitë lokale, urgjencës, SHPK-ja, zjarrfikësve si dhe këto informata i shpërndan dhe informon Drejtorinë e Shërbimeve Publike, GE dhe Zyrën Rajonale të Pejës.
  - Gjithashtu, bënë informimin reciprok në tërë territorin e Kosovës në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, fatkeqësie elementare, aksidenteve në trafik, vërshimeve si dhe të gjitha fatkeqësive tjera eventuale në komunën e Klinës.
  - Përgatit informatat të cilat i dalin nëpërmes radio – lidhjeve, telefonave të cilat i regjistrojnë dhe i shpërndajnë në vendet e caktuara, në përgjithësi bëjnë rregullimin e dokumenteve të punës në zyre.
  - Zyrtari i alarmimit kujdeset për mirëmbajtjen e alarmit të qytetit i cili gjendet në objektin e postës në Klinë si dhe bënë mirëmbajtjen e antenës kryesore e cila gjendet në vendin e quajtur Tikvesh.

- **Njësia Operative për Zjarrfikje dhe Shpëtim.**
  Objekti në të cilën operon njësia e Zjarrfikësve është tepër e vjetërsuar. Ndërtesa e filluar para shumë viteve ka mbetur e papërfunduar, prandaj këtë vit do të caktojmë një lokacion për ndërtimin e objektit të Njësisë së Zjarrfikësve, ndërsa ndërtimi i objektit mbulohet nga Agjencia për Mbrojtje dhe Emergjenca /AME/.

- Gjithashtu, në kuadër DSHPE është edhe NJPZSH e cila bënë planifikimin e punëve dhe zhvillimit të kapaciteteve të saj në kuadër të detyrave të përshkruara dhe mandatit të dhënë. Për vitin 2023 është planifikuar:
  - Pjesëmarrje në kurse dhe trajnime në QTE në Vushtrri me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe të sigurisë fizike për personelin e kësaj njësie;
  - Pajisje me mjete dhe vegla të nevojshme;
  - Mbajtje të këshillimeve dhe dhënie të udhëzimeve në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë e ndryshme;
  - Angazhim me kontratë për kohë të caktuar për sezonin e verës–zjarrfikës vullnetar.
  - Brenda këtij viti kemi kapacitete për përmbushje të këtyre planifikimeve:
    1. Intervenime në fatkeqësitë elementare natyrore – sipas nevojës;
    2. Shpëtim nga rrënojat - sipas nevojës;
    3. Dhënia e ndihmës së parë – sipas nevojës;
    4. Mbrojtje nga vërshimet – sipas nevojës;
    5. Ushtrime praktike – sipas nevojës;
    6. Ushtrim i emergjencave në nivel komune – 1;
    7. Intervenime në raste konkrete sipas nevojës – 300 raste.

## 11. DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Drejtoria për Punë Inspektuese (DPI), e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e inspektoratit të tregut, inspektoratit komunal (shërbimeve komunale), inspektoratit të ndërtimtarisë, inspektoratit të mjedisit dhe bujqësisë, në planin e punës për vitin 2023 planifikon që përmes inspektorëve kompetent në përgjegjësinë e saj të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme komfor ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për mbrojtjen e subjektet afariste (deri në atë shkallë sa nuk cenohet interesi publik), duke e luftuar konkurrencën e pandershme në tregun e brendshëm, duke siguruar se produktet ushqimore dhe joushqimore të plasura në treg janë të sigurta dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe standardet ndërkombëtare, mbrojtjen e konsumatorëve, mbikëqyrjen e prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit, bartjes së ushqimit, pajisjeve, veglave të punës, dhe zbatimin e masave për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse, marrjes së masave mbrojtëse të shëndetit të popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, inspektimin e ndërtimeve, instalimeve, rinovimeve, zgjerimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, rrënimin e çfarëdo ndërtese apo strukture, evidentimi dhe marrja e masave për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme, inspektimin e prodhimeve me origjinë shtazore, kontrollimin e bagëtisë para dhe pas

therjes, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve publike (rrugët, trotuaret, sheshet, parqet, tregun e gjelbër etj), lirimin e hapësirave publike nga pengesat e ndryshme, mbikëqyrjen e aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis dhe kontrollon aplikimin  e standardeve për mbrojtjen e mjedisit. DPI-ja në objektivat e veta për vitin 2023 ka edhe rritjen e besueshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të inspektorëve, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të qytetarëve në kohë sa më të shpejtë. Gjithashtu, transparenca do të luaj një rol të rëndësishëm në raport me subjektet, realizimi i të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga objektivat strategjike dhe politike të qeverisjes lokale, ndjekja me korrektësi e të gjitha procedurave ligjore për rastet dhe shkeljet e ndryshme, rritjen e bashkëpunimit efikas me sektorët e tjerë komunal, bashkëpunimi me Policinë, Gjykatën dhe Prokurorinë, IKSHP-në, si dhe tentimi për bashkëpunim dhe shkëmbime të informacioneve me inspektorët qendror në fushat përkatëse.

| Plani i Punës për 2023 | Planifikim për Inspektime dhe kontrolle | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Inspektorati i Tregut** | **227** | **15** | **16** | **20** | **17** | **18** | **20** | **25** | **20** | **18** | **20** | **20** | **18** |
| **Inspektorati i Ndërtimit** | **182** | **10** | **13** | **10** | **20** | **20** | **20** | **20** | **10** | **19** | **15** | **15** | **10** |
| **Inspektorati Shërbimeve** | **213** | **15** | **18** | **20** | **25** | **20** | **15** | **20** | **20** | **15** | **15** | **15** | **15** |
| **Inspektorati i Bujqësisë dhe Ambientit** | **182** | **8** | **15** | **13** | **15** | **13** | **20** | **20** | **13** | **15** | **20** | **15** | **15** |
| **Inspektorati i Financiare** | **186** | **15** | **18** | **15** | **14** | **18** | **15** | **20** | **15** | **15** | **13** | **13** | **15** |
| **Inspektorati i Trafikut** | **161** | **10** | **10** | **13** | **15** | **15** | **20** | **20** | **15** | **13** | **15** | **15** | **10** |
| **Drejtoria për Punë Inspektuese** | **1151** | **83** | **90** | **91** | **106** | **104** | **110** | **125** | **93** | **95** | **98** | **73** | **83** |

# Plani i punës për gjithë inspektorët janar-dhjetor 2023

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti i Inspektorëve të Tregut për vitin 2023** | Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Certifikatës së Biznesit;<br>Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Aktvendimit të DPI-së për plotësim të kushteve H.T.S;<br>Inspektimi në lokalet afariste, mjetet transportuese dhe produktet, kontrollimi i dokumentacionit përcjellës, informatat mbi furnizuesin e tyre, dokumentet përcjellëse të produkteve etj.;<br>Inspektime të subjekteve afariste të cilët merren me qarkullimin e produkteve nga metalet e çmuara (verifikimin e mjeteve matëse ligjore në qarkullim publik etj.);<br>Inspektime me qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale në treg. | Inspektimi me qëllim verifikimin e karakteristikave të produkteve, përmes kontrollimit të dokumenteve (certifikatat e përputhshmërisë së produkteve, deklarimin dhe etiketimin e produktit, markimin e efikasitetit të energjisë së pajisjeve të amvisërisë);<br>Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Certifikatës së Biznesit dhe Aktvendimit të DPI-së për plotësim të kushteve H.T.S;<br>Inspektimi në subjektet afariste, mjetet transportuese dhe produktet, kontrollimi i dokumentacionit përcjellës, informatat mbi furnizuesin e tyre, dokumentet përcjellëse të produkteve etj;<br>Mbikëqyrjen e vazhdueshme të aktiviteteve të subjekteve afariste gjatë shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve (reklamimet e produkteve, çmimet, përcaktimin dhe ekspozimin e çmimeve, pagesën dhe dhënien e faturave);<br>Inspektimi me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të orarit të punës;<br>Inspektimi në lokalet afariste, mjetet transportuese dhe produktet, kontrollimi i dokumentacionit përcjellës, informatat mbi furnizuesin e tyre, dokumentet përcjellëse të produkteve etj;<br>Inspektimin e subjekteve afariste të cilët merren me qarkullimin e produkteve nga metalet e çmuara (verifikimin e mjeteve matëse ligjore në qarkullim publik etj.);<br>Inspektimin e subjekteve afariste që merren me veprimtari turistike, hoteliere dhe zejtare;<br>Mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale në treg. | Ibikëqyrjen e vazhdueshme të aktiviteteve të ubjekteve afariste gjatë shitjes së produkteve he ofrimit të shërbimeve (reklamimet e rodukteve, çmimet, përcaktimin dhe kspozimin e çmimeve, pagesën dhe dhënien e aturave);<br>nspektime me qëllim të mbikëqyrjes së espektimit të orarit të punës;<br>nspektime me qëllim mbrojtjen e të drejtave ë autorit dhe pronësisë industriale në treg;<br>nspektime në subjekte afariste me qëllim të erifikimit të Certifikatës së Biznesit dhe ktvendimit të DPI-së për plotësim të kushteve I.T.S;<br>nspektimi me qëllim verifikimin e arakteristikave të produkteve, përmes ontrollimit të dokumenteve (certifikatat e ërputhshmërisë së produkteve, deklarimin he etiketimin e produktit, markimin e fikasitetit të energjisë së pajisjeve të mvisërisë) dhe nëse është e nevojshme të ëhet kontrollimi fizik dhe laboratorik;<br>nspektimi në lokalet afariste, mjetet ansportuese dhe produktet, kontrollimi i okumentacionit përcjellës, informatat mbi urnizuesin e tyre, dokumentet përcjellëse të rodukteve etj;<br>nspektimi e subjekteve afariste të cilët herren me qarkullimin e produkteve nga etalet e çmuara (verifikimin e mjeteve atëse ligjore në qarkullim publik etj.);<br>nspektimin e subjekteve afariste që mirën me eprimtari turistike, hoteliere dhe zejtare; | Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Certifikatës së Biznesit dhe Aktvendimit të DPI-se për plotësim të kushteve H.T.S;<br>Inspektimi me qëllim verifikimin e karakteristikave të produkteve, përmes kontrollimit të dokumenteve (certifikatat e përputhshmërisë së produkteve, deklarimin dhe etiketimin e produktit, markimin e efikasitetit të energjisë së pajisjeve të amvisërisë) dhe nëse është e nevojshme të bëhet kontrollimi fizik dhe laboratorik;<br>Mbikëqyrjen e vazhdueshme të aktiviteteve të subjekteve afariste gjatë shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve (reklamimet e produkteve, çmimet, përcaktimin dhe ekspozimin e çmimeve, pagesën dhe dhënien e faturave);<br>Inspektim me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të orarit të punës;<br>Inspektimin e subjekteve afariste të cilët merren me qarkullimin e produkteve nga metalet e çmuara (verifikimin e mjeteve matëse ligjore në qarkullim publik etj.);<br>Inspektimin e subjekteve afariste që merren me veprimtari turistike, hoteliere dhe zejtare;<br>Mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale në treg; | | **Në Gjithë territorin e Klinës** | Inspektori i Tregut i cili gjatë mbikëqyrjes inspektuese konstaton mangësi është i detyruar të paralajmëroj subjektin e mbikëqyrur që të eliminoj mangësitë, ne të kundërtën është i detyruar te merr masat ndëshkuese te përcaktuara me ligj. |

| | | | | 8 | NDRRIMI I DYEREVE TE SHKOLLES ALI KRASNIQI NE QABIQ | TOTAL | 1,00 | 4.000,00 | 4.000,00 |
| | | | | 9 | INSTALIM I KAMERAVE NE SHKOLLA | TOTAL | 1,00 | 7.000,00 | 7.000,00 |
| | | | | 10 | RIPARIME I SISTEMEVE TE FURNIZIMIT ME ENERGJI DHE NDRIQIMIT NE SHKOLLA | TOTAL | 1,00 | 3.000,00 | 3.000,00 |
| | | | | 11 | RREGULLIMI I PLLAKAVE TE EMRAVE NE SHKOLLA | TOTAL | 1,00 | 2.000,00 | 2.000,00 |
| | | | | 12 | RREGULLIMI OBORREVE ME KUBEZA NE SHKOLLA | TOTAL | 1,00 | 5.000,00 | 5.000,00 |
| | | | | 13 | NDERTIMI I ANEKSIT PER DRU | TOTAL | 1,00 | 5.000,00 | 5.000,00 |
| 27 | 45000000-7 | NDERTIME - RIPARIME TE JASHTEME NE OBJEKTET SHKOLLORE | 16.02.2023 | 1 | RENOVIMI TE JASHTME NE OBJEKTET SHKOLLORE | TOTAL | 1,00 | 12.000,00 | 12.000,00 |
| 26 | 45000000-7 | RENOVIMI I SALLES SE KUVENDIT | 09.02.2023 | 1 | RENOVIM NDERTIME NE SHTEPI TE KULTURS | TOTAL | 1,00 | 55.000,00 | 55.000,00 |
| 33 | 45000000-7 | RIPARIM I RRUGEVE SANIM I GROPAVE NE RRUGET ME ASFALT | | 1 | SANIM I RRUGEVE | TOTAL | 1,00 | 168.000,00 | 168.000,00 |
| | | | | | | | | Totali i Vlerës | 3.835.595,00 |

**II.4)KONKURSET E PROJEKTIMIT**

| Rendor i prokurimeve | Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP) | Përshkrimi i Kontratës | Data e parashikuar e fillimit të prokurimit | Nr. Rendor | Artikulli | Njësia matëse | Sasia e përafërt Vjetore | Çmimi për Njësi | Vlera e parashikuar e kontratës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Totali i Vlerës | |

**Vlera totale e planifikuar 5,161.511.00€**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

**Komuna e Klinës**

**Kuvendi i Komunës**

**01Nr____________/2023**

**Klinë,**

# PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 20.12. 2022, , filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.**

Të pranishëm në mbledhje janë: Kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, drejtorët e drejtorive, nënkryetarja, znj. Marqe Selmanaj, Përfaqësues të OSBE, Mediave lokale, etj.

Kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi e hapi mbledhjen duke përshëndet të gjithë të pranishmit dhe duke konstatuar se prezent në mbledhje janë 25 anëtarë të Kuvendit. Për Rendin e ditës , z. Gashi hapi debat.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje të gjithëve. Kryesues së pari të shpreh ngushëllime për humbjen e dajës. Rreth Rendit të Ditës kam dy çështje : 1. Është hera e tretë që kërkoj të bëhet zëvendësimi i anëtarit të KPF dhe 2. Kemi formuar një komision për të hetuar procedurat e dhënies së lejes për fabrikë të çimentos. Të gjitha afatet kanë kaluar pse nuk sjellët raporti në asamble.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit për ngushëllime, tani duke hy në sallë më njoftuan se më vdiq daja. Sa i përket Komisionit , ata kanë obligim që të na sjellin raportin. Besoj që duhet të japim presionin e nevojshëm, ata janë anëtarë të kuvendit, kanë pasur një mandat dhe një afat , janë shkelur ato afate. Unë do ta kontaktoj kryetarin e Komisionit.

**z. Valmir Bacaj:** Edhe unë dëshiroi që të dakordohem me ato që tha z. Raci. Kërkojmë që të procedohet gjithsesi me zëvendësimin e anëtarit të KPF dhe censit sipas rregullores ligjeve në fuqi. Sa i përket Komisionit për të cilin u bë fjalë. Kryetarin e kemi zgjedhur që të jetë i jashtëm shkaku i transparencës. Arsyes pse s`ka ardhë raporti është mriz që ta shpjegoj kryetari i Komisionit. Unë e diji dhe jam shumë i sigurt se nuk janë gjetur asnjë shkelje gjatë procedurës së dhënies së lejes për fabrikën në fjalë.

**z. Zafer Gashi:** Edhe unë ju shpreh ngushëllime për dajën. Dëshiroj të dijë nëse Raportimi i kryetarit a do të ketë debat apo vetëm raportim i tij.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Nuk do të ketë debat.

**z. Esat Raci:** Rreth zëvendësimit të anëtarit të KPF-së. Nuk ka dakordancë rreth çelësit, votat i ka AAK, kërkoj që të procedohet sipas udhëzimit administrativ. Nuk ka ndodhë që të ulemi dhe të gjejmë marrëveshje, nuk ka pas gatishmëri nga grupi më i madh i kuvendit -AAK-së.

**z. Fadil Gashi, kryesuesi:** Sa po e kuptoj ju po kërkoni që të futet në rend të ditës kjo çështje. Nëse e fusim në rend dite dhe nuk ka dakordim mes grupeve kuvendare atëherë do të procedohet sipas udhëzimit administrativ. Tek Rendi i Ditës kam edhe një propozim që pika 7 të hiqet sepse nuk ka ardhur propozimi nga Komuniteti për zëvendësim të një anëtari tek komiteti për komunitete si dhe ajo që po kërkojnë grupet është që të futet si rend dite ri formatizimi i KPF-së. Të lutem të votojmë për propozimin **tim të parë. Kush është për ?**

**Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Kryesuesi vuri në votim edhe propozimin e dytë dhe me 23 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U KIRATUA.**

**Edhe Rendi i Ditës në tërësi u vendos në votim dhe me 23 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika e 1 e rendit të ditës: Arsyetimi i Mungesave.**

Kryesuesi theksoi se ka njoftim se do të mungoj Kushtrim Haliti dhe Armend Beqiri.

**Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**z. Zafer Gashi:** Ne e kemi marr përmes e-mail rendin e ditës dhe në masë më të madhe e falënderoj z, Behrami që po shihet që po e mban mirë. Në disa vende edhe pse nuk duhet fjalë për fjalë ndoshta, ka munguar fjala ime. Konkretisht aty ku kryetari i Komunës kërkon që mos të i përmendet emri i tij dhe procesi nuk është shkruar si duhet, mungon reagimi im aty. Le të na jep sqarim këtu kryetari se çka do të bëjë nëse unë vazhdoj të ja përmend emrin e tij?

Në vazhdim zhvillohet një dialog interaktiv mes z. Zafer Gashi dhe kryesuesit ku zoti Zafer Gashi shprehe pakënaqësinë e tij me mos dhënien e fjalës aq sa do të duhej dhe ndërprerjen e saj të vazhdueshme dhe z. Fadil Gashi i cili kërkon që të ndërprerë fjalën dhe sugjeruar që nëse ka vërejtje për proces le ti përmend konkret ku e si duhet të ishte. Në trego se ku ke vërejtje për proces që ta përmirësojmë e mos të dalim nga pika e rendit të ditës. A ka dikush për proces? Shihet që nuk ka vërejtje. Kush është për ?

**Me 23 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-s**

Kryesuesi theksoi se të gjitha rekomandimet janë në materialin e marrur. Rekomandimet që nuk janë këtu janë adresuar nëpër drejtoritë përkatëse

**Rekomandimet u MIRATUAN në Bllok me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim.**

**Pika 4 e Rendit ët Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim listës së përgjithshme të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023.**

Kryesuesi kërkoi mirëkuptim nga anëtarët e kuvendit që drejtori të prezantoj edhe pikën 5 të rendit të ditës njëkohësisht sepse kanë lidhshmëri me njëra tjetrën dh më pastaj kërkoj që të debatohet.

**z. Besnik Marku, drejtor i kadastrit:** Përshëndetje për të gjithë. Një shkresë i është dërguar komunës ë Klinës nga MPL që na ka obliguar që deri me datën 31 të kemi listën e përgjithshme të pronave të Komunës së Klinës dhe lista e veçantë e pronave komunale. Pra tek lista e përgjithshme janë përmbledhur të gjitha pronat komunale ndërsa tek lista e veçantë janë përfshi vetëm ato prona që parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023. Në KPF është modifikuar lista dhe janë eliminuar ato prona që kanë qenë në bashkëpronësi. Pronat do të jepen në shfrytëzim bazuar në rregulloret në fuqi dhe ligjet.

Kryesuesi theksoi se edhe ai ka pasur problem në hapjen e file dhe me siguri edhe disa nga anëtarët e kuvendit kanë pasur të njëjtin problem e sidomos ata që përdorin email privat të cilët i lutë që të hapin email zyrtar.

**z. Zafer Gashi:** Faleminderit kryesues për kohën që do të japësh për të folur. Me sa gjeta material në lidhje me këto dy listat e ardhura, thirrur në kërkesën e drejtorit nuk gjeta material për vitin 2022 ndërsa për vitin 2020 po. Kjo rregullore është që nga Koha e presidentes Jahjaga dhe sa duket në vitin 2020 është precizuar. Është pra e drejtë e komunës që të epën prona me qira dhe të këmbehen. Afati është nga 15 vjet deri në 99 vjet. Ajo që do të lutem që të jemi të kujdesshëm në këto raste se në gjendjen aktuale në kuvendin e komunës me votat që tani më janë bërë shumicë në një krah politik, po dihet që mund të votohet çdo propozim. Po krijohet një lloj oligarkie dhe në këtë rast kam informacion që ngërzit veçse janë përgatit me dokumentacion. Do të duhej të dinim saktësisht se për cilën pronë saktësisht bëhet fjalë për dhënie me qira, këmbim etj. Duhet të kemi kujdes seriozisht që të dihet cilat prona epën dhe nuk kanë asnjë kontest. Jam shumë i sigurt se do të epën pronat për njerëzit që janë më afër pushteti dhe jam i sigurt që kjo do ti dëmtoj disa që kanë qenë shfrytëzues por që nuk do të kenë mundësi që në ankand të ofrojnë shumën e kërkuar. Nëse duhet të mburret kryetari i Komunës me rezultatin e arritur atëherë të mburret me rezultatin e votave që ka arritur të i kthej pro vendimeve të subjektit të tij politik.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë edhe një herë për proces, kërkoj vëmendje edhe nga procesmbajtësi, nuk ka nevojë që të hyjmë në çështje që nuk an takojnë, Unë me pas

mundësi 11 anëtarë të AAK-së i kisha bërë anëtarë të LDK-së, por tjetër kush ka vendosë për këtë. Është votuesit që i kanë determinuar këta numra, prandaj ne do ti respektojmë. Këtu janë dy lista dhe ligji i ka përcaktuar procedurat e dhënies së pronave për shfrytëzim etj. Ne do të formojmë edhe komisionin përkatës por tani e në vazhdim në jemi duke kryer një procedurë ligjore, një kriter ligjor. Procedura për dhënie është krejt diçka tjetër që do ti nënshtrohet gjithsesi edhe ajo ligjeve në fuqi.

**z. Esat Raci:** Ju veç e thatë atë që unë deshirova ta them. Janë pra procedurat ligjore që ne do ti respektojmë se e kemi obligim. Në të ardhmen kërkoi që të sjellën më të specifikuara dhe të sakta.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Pikërisht këtë edhe ne e kemi kërkuar që listat që do të shpallen të jenë të determinuar saktë. Më shumë për ata që janë të interesuar të investojnë në Klinë se sa për ne në kuvend.

**Kryesuesi e vendosi në votim listën e përgjithshme dhe me 22 vota për , asnjë kundër dhe dy abstenime(LVV) U MIRATUA. Gjithashtu u vendos në votim edhe lista e veçantë dhe me 22 vota për , asnjë kundër dhe 2 abstenime(LVV) U MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës dhe kalendari i takimeve të kuvendit për vitin 2023**

Kryesuesi theksoi se ky kalendar do të plotësohet edhe me kërkesa të jashtëzakonshme, miratime të rregulloreve të ndryshme etj. të cilat tani nuk mund ta i planifikojmë prandaj po e vendosim në votim kështu siç është.

**Nuk kishte debat për këtë pikë të rendit të ditës. Me 24 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022.**

**Znj. Marqe Tanushi- Selmanaj, nënkryetare e Komunës:** Përshëndetje të gjithëve. Parimi kryesor i KKSB është periudhë raportuese dhe ka qenë kryesisht përqendrimi në aktivitete për çështje të sigurisë në bashkëpunim me Policinë dhe qytetarët si dhe forumet , organizatat e tjera të sigurisë etj. Për të identifikuar dhe shqyrtuar çështje që lidhen me probleme të sigurisë në bashkësi me synimin e zgjidhjeve konkrete të këtyre problemeve. KKSB gjithsej sipas rregullore ka gjashtë takime, takimin e gjashtë e kemi në ditët në vazhdim. Në të gjitha këto takime pika kryesore ka qenë siguria në bashkësi ku si zakonisht sa i përket sigurisë në bashkësi ka raportuar Komandanti i Policisë në Klinë z. Ragip Bytyqi. Tema të tjera të rendit të ditës kemi vazhduar tutje sipas planit të punuar paraprakisht. Kemi vazhduar me situatën e pandemisë, mbrojtja e fëmijëve nga punët e renda, sensibilizimi i të rinjve nga dukuritë negative etj. Komandanti i Policisë ka raportuar në çdo takim për gjendjen e sigurisë në komunën e Klinës, bashkëpunimi mes qytetarëve dhe policisë ka qenë në nivelin shumë të lartë. Në takime ka marrë pjesë përfaqësuesit e KFOR, OSBE etj. Si rezultate të arritura të KKSB kemi evidentuar disa:

Institucionet komunale akne arritur që të realizojnë instalimin e ndriçimit në shumë lagje e rrugë e në disa pjesë të qytetit janë ndërmarrë masa nga drejtoria përkatëse për rregullimin e tyre. Janë vendosur shenjat e komunikacionit aty ku ka pasur dëmtime të tyre. Masat e ndërmarrura nga policia e Kosovës dhe inspektorët ndaj atyre që kanë rrezikuar sigurinë kanë qenë evidente. Policia e Kosovës së bashku me institucionet komunale janë angazhuar gjatë kohës së ardhjes së bashkë atdhetarëve dhe janë angazhuar që ata të marrin shërbimet sa më të mira të nevojshme. Ka përfunduar instalimi i kamerave në të gjitha shkollat dhe pjesë të qytetit që ky ishte edhe planifikim i KKSB dhe në fund fare janë marrë masa parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave. Uroj shumë që në të ardhmen të jemi akoma më shumë produktiv si KKSB.

**Pika e 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim listës për themelimin e komiteteve konsultative.**

Kryesuesi z. Gashi theksoi se me udhëzim administrativ jemi të obliguar që të themelojmë dy komitetet konsultative dhe komisioni i themeluar ka kryer punën e vet dhe ka sjell listën e personave që komisioni ka përzgjedhë në bazë të konkursit të zhvilluar dhe rezultateve.

Kryesuesi në vazhdim prezantoi listën me emra për komitetin e parë- Çështje emergjente për komunën e Klinës: 1. Laura Gojani-Palucaj, 2. Visar Bojaj, 3. Viktor Kuçi, 4. Kosovare Beqiri-Zogaj dhe 5. Skënder Tafilaj.

**Pasi që nuk kishte të interesuar për debat, kryesuesi e vendosi në votim përbërjen e komitetit të parë dhe me 22 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

Komiteti i dytë- Komiteti Konsultativ për zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit i propozuar është: 1. Diesa Morina, 2. Luan Berisha, 3. Artur Berisha, 4. Ermelinda Berisha dhe 5. Rinor Sejdiu.

**Edhe përbërja e Komitetit të dytë u vendos në votim dhe me 22 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u Miratua.**

**Pika e 9 e Rendit të Ditës: Raportimi i kryetarit të Komunës për rrjedhat e qeverisjes, vështirësitë, investimet kapitale për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022.**

Kryesuesi theksoi se është obligim ligjor që kryetari të raportoj dy herë në vit. Ky do të jetë një raportim pa debat dhe fjalën ja dha kryetarit të Komunës.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës së Klinës:** Faleminderit kryesues, edhe një herë ngushëllime për vdekjen e dajës! Të nderuar anëtarë të Kuvendit, Komandant i policisë, media, ne e kishim një raportim të tillë edhe muajin e kaluar pasi që ishte një interpelancë për këtë temë. Do të ndalem në arritura deri ën ditën e sotme sepse i gjitha angazhimi i ekzekutivit është në përmbushjen e detyrimeve respektivisht në shpenzimin

e buxhetit konform kontratave të firmosura dhe implementimin  tyre në interes të shpenzimit të buxhetit në një përqindje sa më të madhe në mënyrë korrekte sipas rregulloreve në fuqi. Pra deri me ditën e sotme nga gjithsejtë  12 milion e 654 mijë e 484 euro janë shpenzuar 9 milion e 923 mijë e 392 euro ose 78.42%.

Kryetari Elezaj në vazhdim të raportit specifikoj në detaje veç e veç shpenzimet nëpër drejtori të të gjithë buxhetit prej 78.42% duke theksuar se bazuar në këto të dhëna jemi mriz me shpenzimet buxhetore përveç tek shpenzimet kapitale që deri në fund të vitit dhe afateve të pagesave do të arrijmë që të paktën të arrijmë vlerën prej 75% të shpenzimeve të buxhetit nga investimet kapitale duke u bërë përfitues të grandit qeveritar.

**Pika 10 e rendit të Ditës: Re formatimi i Komitetit për politikë dhe financa-KPF.**

Kryesuesi theksoi se është një situatë e re tani pasi që nuk është arritur një konsensus mes grupeve kuvendare prandaj do të duhet të veprohet sipas udhëzimeve administrative bazuar në % e ulëseve të marrura e të certifikuara nga KQZ. Kryesuesi Gashi theksoi se grupi më i madh kuvendar ai i AAK ka 11 ulëse në kuvend me 2.85% që i takojnë 3 anëtarë në komitet, PDK me 7 ulëse në kuvend ka 1.82% dhe i takojnë 2 anëtarë në KPF, LDK ka 1.56 dhe ka 2 anëtarë dhe LVV me 0.78% i takon një anëtarë por tani duhet të shohim se si thotë udhëzimi administrativ. Neni 5 paragrafi i dytë i udhëzimit administrativ  thotë se entiteti më i madh politik që ka numrin më të madh në kuvend varësisht nga % në kuvend do të përfaqësohet edhe në Komitet, pastaj me radhë entiteti i dytë që ka numrin më të madh në Kuvend dhe kështu me radhë. Ne duhet të shkojmë me radhë deri të plotësohet numri 7. Shkojmë me AAK me 3 anëtarë, PDK me 2 anëtarë, LDK me dy anëtarë. Zëvendësimi i Bledar Berishës që ka kaluar nga grupi i PDK në atë të AAK, z, Berisha është obligative që të jap dorëheqje nga KPF pasi që nuk përfaqëson më grupin e PDK.

**z. Bledar Berisha:** Përshëndetje të gjithëve. Për shkak të situatës së krijuar unë jap dorëheqje nga të qenurit anëtar i KPF-së.

**z. Valmir Bacaj:** Përshëndetje. Ne si grup propozojmë që ta vendosim me votim censin e ri me përfaqësimin  AAK-3 anëtarë, PDK-2 anëtarë dhe LDK-dy anëtarë.

**z. Esat Raci:** Me insistimin tonë dy herë radhazi por edhe i juaji që të gjendet një mirëkuptim i cili nuk u gjet tek grupi më i madh i AAK-së, ne detyrohemi që propozimin ta bëjmë sipas çelësit të propozuar nga ju.

**z. Arben Limanaj:** Ne kemi menduar që këtë “kontest” ta rregullojnë dy grupet e para por pasi nuk ka ndodhë ne jemi që të vazhdohet me këtë çelës.

**Me 22 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA çelësi.**

U propozuan këta anëtarë për KPF:

1.Tunë Dedaj, 2. Blerta Gashi, 3. Bledar Berisha, 4. Mendehije Duraku, 5. Azdren Ramadani( i cili pasi të votohet -për- duhet të jap dorëheqje nga komiteti i urbanizimit), 6. Blerina Gashi dhe 7 Fadil Gashi, kryesuesi i Kuvendit i cili shkon me automatizëm.

**Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA reformimi i KPF-së.**

**z. Azdren Ramadani:** Unë si anëtar i Komitetit për Urbanizëm jap dorëheqje nga ky komitet.

**Pika 11 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje**

**z. Enver Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Kam një pyetje për drejtorin e DKA. Një udhëzim nga ministria e arsimit është për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë kohës së grevës. A do të zëvendësohen ato orë në shkollat e komunës së Klinës se më duket ka një lloj hutie në këtë drejtim. Sa shkolla po i zëvendësojnë orët e humbura dhe si mendoni a është vendim i drejt?

**z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Përshëndetje të pranishëm. Sa i përket zëvendësimit të orëve sipas udhëzimit të MASHT, ne jua kemi përcjell orarin të gjitha shkollave, ndërsa sa i përket statistikave se sa shkolla janë duke bërë zëvendësimin e orëve, në seancën e ardhshme mund të jua sjell këtë informacion.

**z. Esat Raci:** Kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë. A janë nda mjetet për bujqit që kanë pasur dëme gjatë vërshimeve?

**z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Përshëndetje. Komisioni e ka kryer punën e vet dhe atë konstatim të komisionit e kemi dërguar në Ministri por nuk ka pasur dëme aq të mëdha në bujqësi sa ka pasur në ekonomitë familjare.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje për të gjithë. Unë dua ta shpreh një shqetësim të qytetarëve të Klinës e më gjerë në lidhje me mungesën e letërnjoftimeve dhe pasaportave. Unë e respektoj Kryeministrin e Kosovës edhe pse është i LVV-së, ai është edhe kryeministri im por nuk janë marr masat me kohë për furnizim të qytetarëve me dokumente udhëtimi, gjë që ka bërë që shumë familjarë të mos kenë mundësi të bëjnë vizita gjatë fund vitit tek familjarët e tyre. Gjithashtu falënderoj kryetarin e Komunës për zbukurimin e qytetit për festat e fund vitit dhe ju uroj gjithë shqiptarëve krishtlindjet!

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Një nga ata që ka aplikuar për pasaportë me 20 shtator dhe nuk e ka marr akoma jam edhe unë.

**z. Arben Limanaj:** Dëshiroj të shpreh një shqetësim që ka të bëjë më shumë më drejtorin e administratës. Online në web e pash vendimin e komisionit të pavarur mbikëqyrës i cili komisionin për pranimin e kuadrit të punësuar në administratë e Komunës së Klinës e cilëson të paligjshëm. Shqetësimi im është për afërsisht 20 punëtorë të pranuar në administratë nga ky komision.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Përshëndetje të gjithëve. Unë në seancën e kaluar e kam dhënë përgjigjen kur më ka pyetur z. Esat Raci. Po është e vërtetë që këshilli i pavarur ka nxjerr një vendim që nuk e ka anuluar konkursin në fjalë por ka kërkuar që të plotësohet komisioni. Konkursi është mbajtur më gojë dhe me shkrim sipas vendimit të Këshillit të pavarur dhe e kemi zbatuar me përpikëri atë që e ka kërkuar këshilli i pavarur.

**z. Arben Limanaj:** Nuk përmenda anulim të konkursit, unë ju referova vendimit të këshillit të pavarur që thotë se Komisioni në fjalë është i pa ligjshëm.

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Po e përsëris , është zbatuar në përpikëri vendimi i Këshillit. Është ndryshuar Komisioni qysh është kërkuar me vendim.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Të mundohem që të ju ndihmoj në kuptimin e pyetjes. Më duket Arbeni kërkoj të dijë se çfarë do të bëhet me ata punëtorë të pranuar nga ai komision? A kanë arsye që të shqetësohen ata të punësuar?

**z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Asnjë shqetësim nuk duhet ta kenë sa i përket kësaj çështje

**Znj. Lirije Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Tani në stinën e dimrit ditët janë më të shkurtra dhe mua po më bije që pas dite, kur po bëhet errësirë, të marr fëmijën tim në shkollën fillore dhe më besoni është shuam errësirë aty sa nuk arrij ta shoh fëmijën e dalloj nga të tjerët. Ju kisha lutur që të ndërhyni dhe të instaloni ndriçim në atë pjesë.

**z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA:** Po është shqetësim me vend, shumë shpejt do të instalojmë ndriçimin publik në atë pjesë.

Kryesuesi në fund të kësaj pyetje , pasi që nuk kishte pyetje të tjera nga anëtarët e kuvendit e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të fundit për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës duke ju uruar të gjithëve festat e fund vitit dhe uruar gjitha të mirat në familjet e të gjithëve.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtës: | Kryesuesi: |
| Skënder Behramaj | Fadil Gashi |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

**Komuna e Klinës**

**Zyra e kryetarit**

**Klinë, 23. 12. 2022**

## PROCESVERBAL

## Nga takimi i dytë i kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj me qytetarët e Komunës së Klinës, mbajtur me datë 23. 12. 2022 në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00

Kryetari z. Elezaj falënderoj qytetarët pjesëmarrës në këtë takim duke jua bërë të ditur që në vazhdim në pika të shkurtra do të ju jap informacion dhe një raport për punën e bërë të ekzekutivit.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Përshëndetje të gjithëve. Mirë se keni ardhë në këtë takim që bashkë të i diskutojmë të gjitha të arriturat në të gjitha sferat e pushtetit lokal në Komunën e Klinës. Ka qenë një vit i shoqëruar me shumë sfida dhe atë që nga fillimi duke e pasur parasysh situatën globale me rritjen e çmimeve dhe që edhe tek ne ka pasur efekt negativ. Të gjitha firmat me të cilat kemi pasur kontrata të nënshkruara hezitonin të fillonin punën duke kërkuar rritje të vlerës së kontratave. Ne në nivel lokal nuk e kishim mundësinë e rritjes së vlerës pasi që kjo është kompetencë e nivelit qendror përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo është rregulluar në fund para një muaji. Duke e pasur parasysh këto vështirësi, unë jam i kënaqur me realizimin e projekteve. Çështja e dytë ka qenë fillimi i procesit të prokurimit me projekte të reja në këtë vit e që parashikimi dhe ndarjet buxhetore kanë qenë nga viti i kaluar. Edhe kjo ishte vështirësi e madhe pasi që të tjera ndarje buxhetore ishin bërë vitin e kaluar e të tjera çmime diktoheshin nga kriza globale këtë vit. Shembull, kur kemi bërë ndarjen buxhetore sipas planifikimit në vitin e kaluar me 100 mijë euro të ndara për shtrimin e tre kilometrave rrugë me asfalt jemi detyruar që ta reduktojmë në një kilometër shkaku i rritjeve të çmimeve. Jemi detyruar që të i përsërisim procedurat e prokurimit. Me gjithë këtë me angazhimin maksimal të ekzekutivit sot mund të them se është shpenzuar buxheti 80.39% që është një arritje e mirë , ndërsa në projektet kapitale është 66.9% e buxhetit të shpenzuar. Mundësi për kryerjen pagesave ka edhe dy tre ditë dhe shpresojmë që do të arrijmë minimumin nga shpenzimi i buxhetit nga projektet kapitale në 75% që është kusht për përfitimin e grandeve. Ne ende nuk e kemi vlerësimin përfundimtar por këtë vit jemi një nga 6-shtë komunat më të mira për përformancë. Jemi të kualifikuar si komunë e tillë dhe do të shpërblehemi me grandin e përformances që tani për tani flitet që do të jetë 800 mijë euro. Në aspektin e përgjithshëm mund të them se projektet kapitale kanë ecur mirë ato që janë menaxhuar nga Komuna e Klinës. Ndërsa projektet që janë menaxhuar nga CDI etj. kanë nga pak vonesa por që do të kryhen gjithsesi shumë shpejtë. Në këtë fillim viti është formuar nga një komision nga Kryeministri i republikës

bashkë me Komunën e Klinës për ujin e pijshëm. Komuna me buxhetin e vet nuk mund ta kryej investimin për këtë problematikë pasi që duhet të kemi më shumë se 10 milion euro. Po ashtu, në raportin është pranuar nga qeveria vizioni i jonë për fabrikën e ujit. Një projekt tjetër i rëndësishëm është trajtimi i ujerave të zeza. Ne me kapacitetet tona çdo vit po ndërtojmë nga një impiant. Është ndërtuar në Volljak, në Sferkë tani më kanë përfunduar punimet etj. Zgjidhja përfundimtare për trajtimin e ujerave të zeza do të bëhet me qeverinë pasi që është projekt që kapë vlerën deri në 10 milion euro. Aspekt tjetër që ka krijuar vështirësi është periudha e vërshimeve. Edhe pse kemi bërë investime të konsiderueshme në pastrimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve prap se prap ka pasur probleme. Detyrimisht duhet të kemi buxhet më të madh që investimi të jetë akoma më i madh pasi që duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim sepse Klinën e përfshijnë 5 lumenj.

Unë nuk do të zgjatem me tepër. Jam i gatshëm që të bashkëbisedojmë dhe shqyrtojmë të gjitha kërkesat dhe idetë e juaja. Përveç kësaj zyra e ime ka qenë gjithmonë e hapur për çdo qytetar të Komunë së Klinës.

Pasi që asnjeri nga të pranishmit nuk morri fjalën në vazhdim të këtij takimi, kryetari i Komunës. Z. Zenun Elezaj, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe duke ju uruar festat e fund vitit e mbylli këtë takim.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtës: | Kryetari i Komunës |
| Skënder Behramaj | Zenun Elezaj |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

# Drejtoria për Financa , Ekonomi dhe Zhvillim

## RAPORT

## I MENAXHIMIT FINANCIAR KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2022

## Raport financiar për buxhetin , të hyrat dhe shpenzimet për periudhen janar – dhjetor 2022

Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhen janar – dhjetor 2022 do të japim një pasqyrë të buxhetit , të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore , do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhen e njejt të vitit paraprak .

Raporti për periudhën janar-dhjetor 2022, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK , shpenzimet dhe arketimin e të hyrave .

### TË HYRAT BUXHETORE TË KOMUNËS SË KLINËS
### Për periudhën janar- dhjetor 2022

**Buxheti në SIMFK sipas burimit**

| | Buxheti në SIMF 2022 | % në total | Buxheti sipas SIMFK 2021 | Ndryshimi nga 2020 në % |
|---|---|---|---|---|
| Granti qeveritar | 10,372,411.74 | 81.79 | 10,223,170.63 | 1.46 |
| Të hyrat vetanake 2021 | 1,065,865.00 | 8.40 | 830,437.00 | 28.35 |
| Të hyrat e bartura | 1,196,666.06 | 9.44 | 554,975.41 | 115.63 |
| Participimi i qytetarve | 41,443.63 | 0.33 | 21,212.12 | 95.38 |
| Save the Children | 5,437.68 | 0.04 | 5,000.00 | 8.75 |
| **TOTALI :** | **12,681,824.11** | **100** | **11,634,795.16** | **9.00** |

**Tabela 1. Buxheti në SIMFK për vitin 2022 sipas burimit dhe krahasimi me 2021**

**Buxheti për këtë periudhë ishte 12,681,824.11 €**

Siq shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2022 është më i lartë për rreth 9 % se buxheti në periudhen e njejt të vitit 2021 .

## 1. Granti Qeveritar

Granti Qeveritar në vlerë 10,372,411.74 € është burimi kryesorë i financimit të buxhetit komunal , 81.79% e buxhetit total në këtë periudhë .

Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 1.46 % më i lartë.

## 2. Të hyrat vetanake

Siq shihet edhe në tabelë buxheti nga THV të vitit 2022 është 1,065,865.00 € ( 8.40 % e buxhetit total në këtë periudhë) . Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i lartë për rreth 28.35% .

Të hyrat e bartura janë 1,196,666.06 € (9.44 % e buxhetit total në këtë periudhë ).Në raport me vitin paraprak janë më të larta për rreth 115.63 %

## 3.Donacionet

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit ,si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet siq janë :

**- Participimi i qytetarve** në vlerë 41,443.63 € (0.33 % e buxhetit total në këtë periudhë ) , në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetar është rreth **95.38** % më i lartë se në vitin paraprak **.**

- Donacioni nga Save the Children është 5,437.68 €




**Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit**

# SHPENZIMET BUXHETORE
# Për periudhën janar-dhjetor 2022

## Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar

| Burimi | **Buxheti sipas SIMFK 2022** | **% në total** | **Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2022** | **Progresi ndaj buxhetit në %** | **% në total** | **Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2021** | **Krahasimi 2022 me 2021 në %** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Granti qeveritar | 10,372,411.74 | 81.79 | 10,009,166.28 | 96.50 | 86.66 | 10,089,467.21 | - 0.80 |
| Të hyrat vetanake 2021 | 1,065,865.00 | 8.40 | 663,126.57 | 62.21 | 5.74 | 542,080.30 | 22.33 |
| Të hyrat e bartura nga viti paraprak | 1,196,666.06 | 9.44 | 850,471.49 | 71.07 | 7.36 | 482,004.10 | 76.44 |
| Participimi i qytetarve | 41,443.63 | 0.33 | 21,361.50 | 51.54 | 0.18 | 16,130.00 | 32.43 |
| Save the Children | 5,437.68 | 0.04 | 5,437.68 | 100 | 0.05 | 5,000.00 | 8.75 |
| **TOTALI :** | **12,681,824.11** | **100** | **11,549,563.52** | **91.07** | **100** | **11,134,681.61** | **3.73** |

**Tabela 2.Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar në periudhen janar –dhjetor 2022**

Buxheti i shpenzuar në periudhen janar – dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € është 91.07 % e buxhetit në SIMFK për vitin 2022. Nga Granti qeveritar 10,009,166.28 € ( 96.50 % në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat vetanake 663,126.57 € (62.21 % në raport me buxhetin nga të hyrat 2021 ) , nga të hyrat e bartura 850,471.49 € (71.07 % në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura ) , nga participimi i qytetarve 21,361.50 € (51.54% në raport me buxhetin nga participimet me qytetar dhe nga Save the Children 5,437.68 €(100 % në raport me buxhetin nga ky donacion .

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë përiudhë në vlerë 11,549,563.52 € nga granti qeveritar janë 86.66 % , nga të hyrat vetanake 5.74 % , nga të hyrat e bartura 7.36 % , nga participimi i qytetarve 0.18 % dhe nga Save the Children 0.05% .
Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 3.73 % krahasuar me periudhen e njejtë të vitit paraprak .

**Shpenzimet e buxhetit  sipas kategorive ekonomike**

| Përshkrimi | Buxheti në SIMFK 2022 | % në total | Shpenzimet janar-dhjetor 2022 | Shpenzimet në raport me buxhetin në % | % në total e shpenz. | Shpenzimet janar-dhjetor 2021 | Krahasimi 2022 me 2021 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga dhe mëditje | 6,686,270.42 | 52.72 | 6,443,170.89 | 96.36 | 55.79 | 6,700,218.13 | - 3.84 |
| Mallra dhe shërbime | 1,369,064.00 | 10.80 | 1,340,623.85 | 97.92 | 11.61 | 1,211,429.32 | 10.66 |
| Shërbime komunale | 167,000.00 | 1.32 | 166,971.64 | 99.98 | 1.45 | 179,398.69 | - 6.93 |
| Subvencione dhe transf. | 408,796.31 | 3.22 | 401,428.90 | 98.20 | 3.48 | 345,108.59 | 16.32 |
| Kapitalet | 4,050,693.38 | 31.94 | 3,197,368.34 | 78.93 | 27.68 | 2,698,526.88 | 18.49 |
| **TOTALI** | **12,681,824.11** | **100** | **11,549,563.52** | **91.07** | **100** | **11,134,681.61** | **3.73** |

**Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit  për periudhën janar – dhjetorr  2022 sipas kategorive ekonomike**

Nga buxheti  i shpenzuar  në përiudhen  janar – dhjetor  2022  në vlerë 11,549,563.52 €  për  paga dhe meditje janë shpenzuar 6,443,170.89 € (55.79 % e shpenzimeve ), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,340,623.85 € (11.61 % e shpenzimeve ), për shërbime  komunale 166,971.64 € (1.45 % e shpenzimeve ), për subvencione 401,428.90 € (3.48 % e shpenzimeve ) dhe për kapitale  3,197,368.34 € (27.68 % e shpenzimeve ).

Shpenzimet në periudhen janar- dhjetor  2022 në vlerë  11,549,563.52 €  krahasuar me shpenzimet  për periudhen e njejtë të vitit 2021 në vlerë 11,134,681.61 €  janë rritë  për  rreth 3.73 % . Shpenzimet për paga dhe meditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogluar rreth 3.84 % , shpenzimet për mallra dhe shërbime  janë  rritë për   rreth  10.66 %, shpenzimet për shërbime komunale janë  zvogluar  për rreth  6.93 % , shpenzimet për subvencione janë rritë  për  16.32 % dhe shpenzimet për kapitale janë  rritë    për  rreth  18.49 %.




**Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në periudhen janar – dhjetor 2022 sipas kategorive**

## Arketimi i të hyrave sipas llojit për vitin 2022 dhe krahasimi me të hyrat e vitit 2021

| Nr. | KODI EKONOMIK | LLOJET E TRANSAKSIONEVE | Janar- dhjetor 2021 | % Ne total | Janar- dhjetor 2022 | % Ne total | Krahasimi 2021/2022 | Ndryshimi ne € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 40110 | TATIMI NË PRONË | 488,480.94 | 29.15 | 453,281.30 | 28.81 | (7.21) | (35,199.64) |
| 2 | 50001 | TAX REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE | 76,040.00 | 4.54 | 80,326.50 | 5.11 | 5.64 | 4,286.50 |
| 3 | 50009 | TAX PËR LEJE NDËRTIMI | 192,546.98 | 11.49 | 300,448.67 | 19.10 | 56.04 | 107,901.69 |
| 4 | 50013 | TAX CERTIFIKATAT E LINDJES | 1,641.51 | 0.10 | 1,210.00 | 0.08 | (26.29) | (431.51) |
| 5 | 50014 | TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT | 12.00 | 0.00 | 1.00 | 0.00 | - | (11.00) |
| 6 | 50015 | TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES | 2,163.50 | 0.13 | 886.00 | 0.06 | (59.05) | (1,277.50) |
| 7 | 50016 | TAX CERTIFIKATA TJERA | 38,239.30 | 2.28 | 39,549.20 | 2.51 | 3.43 | 1,309.90 |
| 8 | 50017 | TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME | 303,278.25 | 18.10 | 8,389.00 | 0.53 | (97.23) | (294,889.25) |
| 9 | 50019 | TAX TJERA ADMINISTRATIVE | 1,913.01 | 0.11 | 2,090.61 | 0.13 | 9.28 | 177.60 |
| 10 | 50103 | LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE | 580.00 | 0.03 | 1,039.50 | 0.07 | - | 459.50 |
| 11 | 50104 | GJOBAT NGA INSPEKTORIATI | 6,543.00 | 0.39 | 14,745.00 | 0.94 | 125.36 | 8,202.00 |
| 12 | 50205 | LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT | 2,387.00 | 0.14 | 6,808.55 | 0.43 | 185.23 | 4,421.55 |
| 13 | 50217 | LIC.PËR DYQANE TË MËDHA | 69,030.00 | 4.12 | 73,565.85 | 4.68 | 6.57 | 4,535.85 |
| 14 | 50403 | TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE | 4,092.90 | 0.24 | - | - | - | (4,092.90) |
| 15 | 50405 | SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE | 1,650.00 | 0.10 | 10,427.23 | 0.66 | 531.95 | 8,777.23 |
| 16 | 50406 | PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR | 2,315.00 | 0.14 | 3,000.00 | 0.19 | 29.59 | 685.00 |
| 17 | 50407 | QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR | 6,590.00 | 0.39 | 11,057.50 | 0.70 | 67.79 | 4,467.50 |
| 18 | 50408 | QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE | 4,940.00 | 0.29 | 21,194.00 | 1.35 | 329.03 | 16,254.00 |
| 19 | 50409 | PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM | 42,332.00 | 2.53 | 44,587.19 | 2.83 | 5.33 | 2,255.19 |
| 20 | 50409 | PARTICIPIM - QERDHJA | 21,777.46 | 1.30 | 22,956.31 | 1.46 | 5.41 | 1,178.85 |
| 21 | 50409 | PARTICIPIM - SHENDETSIA | 31,908.40 | 1.90 | 32,572.70 | 2.07 | 2.08 | 664.30 |
| 22 | 56000 | DONACIONET E JASHTME | 5,000.00 | 0.30 | 5,437.68 | 0.35 | - | 437.68 |
| 23 | 50504 | TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN | 66,877.00 | 3.99 | 78,482.00 | 4.99 | 17.35 | 11,605.00 |
| 24 | 50409 | PARTICIPIM I QYTETAREVE | 4,825.00 | 0.29 | 36,361.50 | 2.31 | - | 31,536.50 |
| 25 | | GJOBAT NGA TRAFIKU | 276,796.80 | 16.52 | 304,710.50 | 19.37 | - | 27,913.70 |
| 26 | | DENIMET NGA GJYKATA | 23,640.00 | 1.41 | 20,115.00 | 1.28 | - | (3,525.00) |
| | | **GJITHESEJT:** | **1,675,600.05** | **100** | **1,573,242.79** | **100** | **(6.11)** | **(102,357.26)** |

Komuna ka arkëtuar ( inkasuar ) gjithsej 1,573,242.79 € të hyra , në periudhën janar – dhjetor 2022. Krahasuar me periudhen e njejtë të vitit paraprak të hyrat janë më të ulta për 6.11 % ose në vlerë për 102,357.26 €.

Vrejtje: Në totalin e të hyave për vitin 2022 , vlera 1,573,242.79 € nuk janë përfshi të hyrat e tremujorit të fundit për gjobat nga trafiku dhe denimet nga gjykata.

## SHPENZIMET BUXHETORE PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2022

| Nr.rend. | Kodi ekonomik | Përshkrimi | Shpenzimet 2022 | Shpenzimet 2021 | Ndryshimi 2022 me 2021 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 11110 | PAGAT NETO PERMES LISTAVE | 5,456,602.01 | 5,179,779.34 | 276,822.67 |
| 2 | 11115 | PAGESA PËR SINDIKATË | 20,289.10 | 27,564.51 | - 7,275.41 |
| 3 | 11125 | ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOSOVËS | 2,349.84 | 2,202.22 | 147.62 |
| 4 | 11126 | ANTARSIM-ODA E MJEKVE TE KOSOVËS | 1,920.00 | 1,440.00 | 480.00 |
| 5 | 11400 | PUNËTORET ME KONTRATË (JO NË LISTËN E PAGËS) | 4,684.56 | | 4,684.56 |
| 6 | 11500 | TATIMI NE TARDHURA PERSONALE | 331,747.54 | 307,521.07 | 24,226.47 |
| 7 | 11600 | KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI | 300,752.11 | 289,465.47 | 11,286.64 |
| 8 | 11700 | KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI | 300,752.11 | 289,465.47 | 11,286.64 |
| 9 | 11900 | PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORË | 24073.62 | 602,780.05 | - 578,706.43 |
| | **TOTALI: 11** | **RROGAT DHE PAGAT** | **6,443,170.89** | **6,700,218.13** | **- 257,047.24** |
| 10 | 13130 | SHPEN.UDHTIMIT BRENDA | 33,134.61 | 33,237.09 | - 102.48 |
| 11 | 11140 | SHPENZIMET E UDHËT. ZYRTARE JASHTË VENDIT | 150.00 | | 150.00 |
| 12 | 13141 | SHPESHPENZIME TE VOGLA - PARA XHEPI | 1,336.40 | 331.60 | 1,004.80 |
| 13 | 13310 | SHPENZ. PËR INTERNET | 2,781.75 | 3,024.82 | -243.07 |
| 14 | 13320 | SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900 | 11,565.71 | 12,911.96 | - 1,346.25 |
| 15 | 13330 | SHPENZIMET POSTARE | 7,322.42 | 7,318.23 | 4.19 |
| 16 | 13430 | SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETËSORE | 46,710.75 | 24,375.00 | 22,335.75 |
| 17 | 13440 | SHËRBI. E NDRYSHME INTELEK. DHE KËSHILLËDH. | 5,442.00 | | 5,442.00 |
| 18 | 13450 | SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING | 16,503.57 | 11,628.89 | 4,874.68 |
| 19 | 13460 | SHERB.KONTRAKTUESE TJERA | 357,746.32 | 445,235.51 | - 87,489.19 |
| 20 | 13470 | SHËRBIME TEKNIKE | 845.00 | | 845.00 |
| 21 | 13480 | SHPENZIMET PËR ANTARËSIM | 8,836.80 | 8774.40 | 62.40 |
| 22 | 13490 | SHERBIMET E VARRIMIT | 1,590.00 | 715.00 | 875.00 |
| 23 | 13501 | MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro) | 18,161.62 | 4,028.00 | 14,133.62 |
| 24 | 13503 | KOMPJUTER ME PAK SE 1000 EURO | 14,659.50 | 3,665.00 | 10,994.50 |
| | 13505 | MAKINA FOTOKOPJUESE | | 1,309.00 | - 1,309.00 |
| 25 | 13509 | PAISJE TJERA<1000 EURO | 55,183.27 | 26,394.83 | 28,788.44 |
| 26 | 13510 | BLERJA E LIBRAVE DHE VEPRAVE ARTISTIKE | 2,999.00 | | 2,999.00 |
| 27 | 13610 | FURNIZIME PER ZYRE | 36,395.97 | 35,542.68 | 853.29 |
| 28 | 13616 | FURNIZIM ME ARTIKUJ BUJQËSOR | 278.50 | | 278.50 |
| 29 | 13620 | FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA) | 61,901.93 | 118,946.85 | - 57,044.92 |
| 30 | 13630 | FURNIZIME MJEKSORE | 65,817.97 | 79,415.74 | -13,597.77 |
| 31 | 13640 | FURNIZIM PASTRIMI | 12,053.03 | 13,553.27 | - 1,500.24 |
| 32 | 13650 | FURNIZIM ME VESHMBATHJE | 14,296.85 | 11,158.32 | 3,138.53 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 33 | 13720 | NAFT PER NGROHJE QENDRORE | 66,208.17 | 21,287.77 | 44,920.40 |
| 34 | 13760 | DRU | 186,308.48 | 101,634.70 | 84,673.78 |
| 35 | 13770 | DERIVATE PER GJENERATOR | 4,432.13 | 1,127.99 | 3,304.14 |
| 36 | 13780 | KARBURANTE PER VETURA | 65,335.05 | 51,459.28 | 13,875.77 |
| 37 | 13920 | PROVIZIONI BANKAR - BKT | 30.00 | 30.00 | - |
| 38 | 13950 | REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE | 2,690.00 | 3,431.89 | - 741.89 |
| 39 | 13951 | SIGURIMI I AUTOMJETEVE | 5,626.33 | 6,094.09 | - 467.76 |
| 40 | 14010 | MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE | 19,907.33 | 19,525.70 | 381.63 |
| 41 | 14020 | MIRMBAJTJA E NDERTESAVE | 4,853.13 | 10,558.54 | - 5,705.41 |
| 42 | 14023 | MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE | 45,842.71 | 28,349.08 | 17,493.63 |
| 43 | 14024 | MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE | 983.00 | 5,284.80 | - 4,301.80 |
| 44 | 14032 | MIRËMBAJTJA AUTO RRUGËVE LOKALE | 61,831.27 | 82,929.34 | - 21,098.07 |
| 45 | 14040 | MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE | 567.63 | 209.00 | 358.63 |
| 46 | 14050 | MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE | 30,763.40 | 13,083.63 | 17,679.77 |
| 47 | 14060 | MIRËMBAJTJA RUTINORE | 34,716.55 | | 34,716.55 |
| 48 | 14210 | REKLAMAT DHE KONKURSET | 1,900.00 | 2,767.24 | - 867.24 |
| 49 | 14230 | SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK | 576.00 | 3,165.60 | - 2,589.60 |
| 50 | 14310 | DREKAT ZYRTARE | 1,664.70 | 7,134.99 | - 5,470.29 |
| 51 | 14410 | SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE | 30,674.90 | 11,789.49 | 18,885.41 |
| | **TOTALI: 13** | **MALLRA DHE SHERBIME** | **1,340,623.75** | **1,211,429.32** | **129,194.43** |
| 52 | 13210 | RRYMA | 124,749.05 | 111,313.81 | 13,435.24 |
| 53 | 13220 | UJI | 13,794.74 | 23,138.53 | -9,343.79 |
| 54 | 13230 | MBETURINAT | 25,193.28 | 41,640.88 | -16,447.60 |
| 55 | 13250 | SHPENZIMET TELEFONIKE | 3,234.57 | 3,305.47 | -70.90 |
| | **TOTALI: 14** | **SHPENZIMET KOMUNALE** | **166,971.64** | **179,398.69** | **-12,427.05** |
| 56 | 21110 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE | 800.00 | | 800 |
| 57 | 21200 | SUB.PËR ENTIT.JOPUBLIKE | 400,628.90 | 339,949.00 | 60,679.90 |
| | 22300 | PAGESA- VENDIME GJYQESORE | | 6,339.59 | -6,339.59 |
| | **TOTALI: 20** | **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET** | **401,428.90** | **349,288.59** | **52,140.31** |
| 58 | 31110 | NDËRTESAT E BANIMIT | 30,000.00 | 11,232.03 | 18,767.97 |
| 59 | 31120 | NDËRTESAT ADMINISTRATËS AFARISTE | 19,972.66 | 9,434.00 | 10,538.66 |
| 60 | 31121 | OBJEKTET ARSIMORE | 100,000.00 | 51,330.75 | 48,669.25 |
| 61 | 31122 | OBJEKTET SHËNDETËSORE | 49,340.00 | 47,531.22 | 1,808.78 |
| 62 | 31124 | OBJEKTET SPORTIVE | 17,303.00 | 41,652.50 | -24,349.50 |
| | 31126 | RRETHOJA | | 34,013.91 | -34,013.91 |
| | 31129 | FUSHA SPORTIVE | | 82,927.28 | -82,927.28 |
| 63 | 31230 | NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE | 2,146,923.20 | 1,617,339.90 | 529,583.30 |
| 64 | 31250 | KANALIZIMI | 221,331.31 | 125,384.63 | 95,946.68 |
| 65 | 31260 | UJËSJELLËSI | 21,000.00 | 47,060.32 | -26,060.32 |
| 66 | 31270 | MIREMBAJTJA INVESTIVE | 109,435.38 | 84,015.21 | 25,420.17 |
| 67 | 31510 | FURNIZIMI ME RRYMË GJENRATOR TRAFNS | 20,853.72 | 44,223.27 | -23,369.55 |
| | 31610 | MIREMBAJTJE E TI | | 1,760.00 | -1,760.00 |
| 68 | 31620 | MOBILJE | 19,992.00 | 20,000.00 | -800 |
| 69 | 31660 | PAJISJE SPECIALE MJEKËSORE | 59,873.00 | 5,725.53 | 54,147.47 |
| | 31690 | PAISJE TJERA | | 38,239.30 | -38,239.30 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 31703 | VETURA E NDIHMES SE SHPEJT | | 75,800.00 | -75,800.00 |
| 70 | 32000 | INVESTIMET NE VIJIM | 192,463.96 | 256,375.55 | -63,911.59 |
| 71 | 32110 | RREGULLIMI I LUMENJËVE | 117,722.89 | | 117,722.89 |
| 72 | 32111 | SISTEMI I UJITJES | 53,657.22 | 102,635.87 | -48,978.65 |
| 73 | 33200 | TRANSFERE KAPITALE - ENTITETET JOPUBLIKE | 17,500.00 | | 17,500.00 |
| | 34000 | PAGESA- VENDIME GJYQESORE | | 1,845.61 | -1,845.61 |
| | **TOTALI: 30** | **PASURIT JO FINANCIARE** | **3,197,368.34** | **2,698,526.88** | **498,841.46** |
| | **TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30** | | **11,549,563.52** | **11,135,861.61** | **413,701.91** |

**Klinë 06.01.2023**

**Zyrtarja kryesore financiare**

**Xufe Kelmendi**

U

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUN. E KLINËS
MUNICIPALIT OF KLINA
OPŠ INA KLINA

www.komuna-kline.org

**Kuvendi i Komunës Klinë**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**01Nr 06-1947 /23**
**Klinë: 17.01.2023**

**PËR: Kuvendin e Komunës Klinë**

**Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi Komitetit: Fadil Gashi**

**R E K O M A N D I M E T: e Komitetit për Politikë dhe Financa të d tës 13.01.2023**

Komiteti për Politikë dhe Financa në seancën –I-rë të rregullt për vitin 20 3, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në kuvend këto pika:

**Pika 1. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 20 2.**

-Lidhur me këtë pik të rendit të ditës referoi drejtori i Drejtorisë për Finar ca, Ekonomi dhe Zhvillim. z. Enver Berisha, theksoi se: Duke marr parasysh gjendjen e kri uar, fillimisht nga pandemia e më pas nga inflacioni që ka ndodhur, Komuna e Klinës ka arr tur ta menaxhojë dhe realizojë me sukses mbi 90% të buxhetit, duke realizuar me sukses të gjit a projektet e planifikuara. Buxheti për periudhën janar 2022- dhjetor 2022 ishte 12,68 ,824.11 €, po ashtu buxheti për periudhën janar-dhjetor 2022 është më i lartë rreth 9 % se b xheti në periudhën e njëjtë të vitit 2021. Grandi Qeveritar në vlerë 10,372,411.74 € është burir i kryesor i financimit të buxhetit komunal, 81.79% e buxhetit total në këtë periudhë, në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 1.46 % më i lartë. Buxheti nga THV të vitit 2022 shtë 1,065,865.00 € ( 8.40 % e buxhetit total në këtë periudhë). Ndërsa në raport me vitin para rak buxheti nga THV është më i lartë përreth 28.35% . Të hyrat e bartura janë 1,196,666.06 € ( ).44 % e buxhetit total në këtë periudhë ). Në raport me vitin paraprak janë më të larta përreth 1 5.63 %. Përveç Grandit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, në këtë eriudhë kemi edhe donacionet, siç janë : Participimi i qytetarëve në vlerë 41,443.63 € (0.33 % e buxhetit total në këtë periudhë ), në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetarë është rreth 95.38 % më i lartë. Donacioni nga Save the Children është 5,437.68 €

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit Finan iar për periudhën janar-dhjetor 2022, rekomandoi që për Kuvend të përgatitet tabela e shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak, po ashtu rekomandoi që raporti të kalo ë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2022.**

-Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi, theksoi se kemi obligim ligjor që ta shqyrtojmë këtë procesverbal, nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund ta adresojmë në Kuvend.

**Komiteti Për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës z. Zenun Elezaj, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që procesverbali të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2023.**

Sa i përket kësaj pike referoi zyrtari nga zyra e prokurimit z. Labinot Morina, theksoi se, bazuar në nenin 9 të LPP, kërkesave të njësive kërkuese kemi përgatitur planifikimin e prokurimit për vitin 2023. Planifikimi është bërë sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2023, në total janë 97 procedura të planifikuara në vlerë prej 5.161.511.00 Euro. Gjithashtu theksoi se ka një ndryshim në draft-plan i cili është dërguar në KPF, kemi paraparë një procedurë për furnizim, montim i nxehjes qendrore në SHFMU në fshatin Budisalc në vlerë prej 30.000.00 Euro.

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planifikimit të prokurimit për vitin 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që draft-planifikimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 4. Shqyrtimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2023.**

Kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi, theksoi se kemi obligim ligjor që ta shqyrtojmë dhe ta rekomandojmë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Planin e KKSB-së ashtu siç kemi vepruar viteve të tjera! Në këtë draft-plan nuk kemi të cekuar vlera buxhetore, andaj kërkoj që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planit të KKSB-së për vitin 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Dhjetor 2022-Janar 2023.**

Kërkesë për shfrytëzimin e parcelës P-71011030- 00116-0, Zona Kadastrale Drenoc, Klinë. Parashtrues i kërkesës, Gievdet Feiza Prebreza, thekson: Po e dorëzoj këtë kërkesë për marrje në shfrytëzim të parcelës me numër P-71011030-00116-0, zona kadastrale Drenoc, me sipërfaqe 3503 m2 e cila gjendet para parcelës time me numër P-71011030-00117-[illegible], parcelë në të cilën unë kam dy shtëpitë në të cilat banoj me familje. Parcela gjendet para parcelës time në komplet gjatësinë, andaj më duhet shfrytëzimi i saj për pastrim nga shkurret, mbjellje të drunjve dekorativ, hapësirë gjelbëruese. Shprehem i gatshëm që në rast të dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele do të jem i gatshëm të paguaj taksat sipas ligjeve në fuqi dhe që ta kthej prapë kurdo që kërkohet. Po ashtu, zotohem në mirëmbajtjen në mosdëmtim të mjedisit brenda kësaj parcele.

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, të trajtohet në bazë të Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Pika 6. Inicimi i proceduarave për vënie në diskutim publik, Draft Planin Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 dhe inicimi i procedurave për vënie në diskutim publik Draft-Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.**

-Kryesuesi theksoi se kemi një kërkesë nga DSHPE, për shqyrtimin e Draft- Rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Draft-Planin komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, të cilat janë punuar nga ana e Komisionit komunal, andaj, kërkojmë nga KPF-ja, që këto draft dokumente të shqyrtohen dhe t'i rekomandohen Kuvendit të Komunës që në seancën e radhës të shqyrtohen dhe të merret vendim për vënie në diskutim publik.

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Draft- Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe Draft-Planin Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, rekomandoi që të dyja të kalojnë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për vënie në diskutim publik.**

**Pika 7. Shqyrtimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2023.**

**-Pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2023 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 02
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: 03
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot.No. 7524-2/22
Data: / Datum: / Date: 30.12.22
PRISHTINË / A
No 1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës<br>Fadil Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL<br>Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br><br>Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëmtë MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr.VL-252/22<br>Datë:27.12.2022 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr.06-41148/2022 për shpallje "Zone me Interes Publik" brigjet e shtratit të Lumit "Drini i Bardhë" në Klinë, miratuar nga KK Klinë | |

REPUBLIKA E KOSOVËS – MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS – PRISHTINË / A

I nderuari Kryetar, Elezaj,
I nderuari Kryesues, Gashi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë,në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.06-41148/2022 për shpallje "Zone me Interes Publik" brigjet e shtratit të Lumit "Drini i Bardhë" në Klinë, miratuar nga KK Klinë, datë 02.12.2022.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr.06-41148/2022 për shpallje "Zone me Interes Publik" brigjet e shtratit të Lumit "Drini i Bardhë" në Klinë, miratuar nga KK Klinë, në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Klinës:

**Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit**

Vendimi Nr.06-41148/2022 për shpallje "Zone me Interes Publik" brigjet e shtratit të Lumit "Drini i Bardhë" në Klinë, miratuar nga KK Klinë, datë 02.12.2022.

**A r s y e t i m i**

Sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205, datë 28 tetor 2010, nuk parashihet shpallja e interesit publik.

Sipas nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme, kompetent për kryerjen e procedurës së shpronësimit është vetëm Kryetari i Komunës , përveç nëse kuvendi komunal i komunës përkatëse, përmes një akti të miratuar në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, cakton një Autoritet tjetër Publik Komunal për të vepruar në cilësinë e Organit Shpronësues të Komunës.

Organi Shpronësues i Komunës, mund bëjë shpronësimin e pronës se paluajtshme vetëm nëse:

2.1. kushtet e përcaktuara në paragrafit 1. të këtij neni;
2.2. shpronësimi i prek shprehimisht të drejtat private në fushëveprimin e paragrafit 3. të nenit 3 të këtij ligji;
2.3. prona e paluajtshme përkatëse gjendet plotësisht brenda kufijve të Komunës; dhe
2.4. shpronësimi ndërlidhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet publike në vijim:

2.4.1. zbatimin e një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Komunal në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
2.4.2. ndërtimin ose zgjerimin e një ndërtese ose objekti i cili i do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Komunal për ushtrimin e funksionit të tij publik; ose
**2.4.3. ndërtimin, zgjerimin, themelimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve në vijim, nëse kjo është e nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të komunës ose ka një përfitim tjetër të qartë publik për banorët e komunës dhe është në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore:**
**2.4.3.1. rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda Komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun;**
2.4.3.2. objektet publike të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për sigurimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe/ose të mirëqenies sociale brenda Komunës;
2.4.3.3. gypat që përdoren për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për vendbanimet brenda Komunës;
2.4.3.4. deponitë komunale dhe vendet për deponimin e mbeturinave publike;

2.4.3.5. varrezat publike komunale; ose 2.4.3.6. parqet publike komunale dhe objektet publike komunale të sportit; ose
2.4.4. përvetësimin e të drejtave sipërfaqësore të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për zbatimin e një licence të shfrytëzimit zejtar të mineraleve e cila i është dhënë Komunës nga KPMM në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Pra sipas nën paragrafit 2.4.3 dhe 2.4.3.1 Organi Shpronësues –Kryetari i Komunës ka të drejtë të zhvillojë procedurën e shpronësimit për realizmin e projekteve infrastrukturore nëse nuk janë në kundërshtim edhe me ligjet tjera në fuqi e që ndërlidhen me këtë projekt ose pronat kanë ndonjë status tjetër ose janë nën administrimin e ndonjë institucioni tjetër.

Gjithashtu, neni 1 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/-147 për Uëjrat e Kosovës, përcakton : *"Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj"*, ndërsa, se kush administron me Pronat Ujore, përcaktohet me dispozitat e nenit 109 dhe 110 të të njëjtit ligj.

Bazuar në nenin 110 të Ligjit Nr 04/L-147, për Ujërat e Kosovës dhe nenin 12 të Udhëzimin Administrativ Nr 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore

**Neni 12**

Ndrërprerja e statusit të pasurisë ujore publike

1. Një tokë e humb statusin e pasurisë ujore publike, nëse
1.1 Me vendim të Ministrit përmes së cilit konstatohet se ajo tokë nuk është me e nevojshme për destinimet e përcaktuara sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.
1.2 Me vendim të Qeverisë së Kosovës përcaktohet që ajo pasuri ujore publike të shfrytëzohet për interesa tjera të përgjithshme.
2. Statusi i pasurisë ujore publike ndërpritet në ditën kur regjistrohet në librat kadastral ndryshimi i statusit të asaj pasurie në pajtim me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

Bazuar në karakterin e kërkesës së Komunës së Klinës *për shpallje "Zone me Interes Publik" brigjet e shtratit te Lumit "Drini i Bardhe" në Klinë, miratuar nga KK Klinë*, konstatuam:

Ende nuk është arritur bartja dhe regjistrimi i pronave e që është i domosdoshëm për administrimin e shfrytëzimit të pronave; dhe deri në përfundimin e hartimit të Planit Menaxhues të Pellgut përkatës lumor, që është bazë ligjore e menaxhimit afatgjatë të pronave ujore, është konstatuar se gjendja faktike administrative pamundëson një hap të tillë.

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-118/6
Data Datum Date 13.01.2023

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Zenun Elezaj**, Kryetar i Komunës së Klinës<br>**Fadil Gashi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kinës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Venera Çerkini** , Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani,** zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë:<br>04.01.2023<br>VI-020-1004 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Gëzim Sahiti**,Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Sanije Dërguti**, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Klinës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01 Nr.06-42820 për riformatizimin e përbërjes së komitetit për Politikë dhe Financa |
| I miratuar më datë: 20.12.2022 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.12.2022 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në <u>**është nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u>.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2022, ka miratuar Vendimin 01 Nr.06-42820 për riformatizimin e përbërjes së komitetit për Politikë dhe Financa nga Kuvendi i Komunës së Klinës .

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Klinës është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ(MAPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë ku përcakton se entiteti politik më numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon më entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet. Ndarja e vendeve në komitetin për Politik dhe Financa bëhet sipas ulëseve që kane fituar entitetet politike me rastin e certifikimin të anëtareve të kuvendit nga KQZ, sipas së cilës në KPF një (1) anëtarë i takon entitetit politik nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Klinës, duhet që te ndërmerr veprime dhe te harmonizoi aktin ashtu siç përcaktohet me legjislacionin ne fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. -VI- 020-118/6
Data. Datum. Date. 13.01.2023

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Zenun Elezaj**, gradonačelnik opštine Klina<br><br>**Fadil Gashi**, predsedavajući Skupštine opštine Klina | |
| Cc: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi,** ministar MALS-a,<br>**Venera Çerkini,** zamenica generalnog sekretara MALS-a, | |
| Od: | **Besim Myrtezani**, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS | Dana,<br>04.01.2023<br><br>VI-020-1004 |
| | | |
| 1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:<br><br>Službenik za izradu pravne procene: | **Gëzim Sahiti**, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Sanije Dërguti,** viša službenica za monitorisanje opština<br>për: | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju | |
| Vrsta odluke: | Odluka Skupštine opštine Klina | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština

MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01 br. 06-42820 o preoblikovanju sastava Odbora za politiku i finansije |
| Usvojena dana, 20.12.2022. godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS dana, 23.12.2022. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt **nije u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi.**

**Obrazloženje**

Skupština opštine Klina, na sednici održanoj dana, 20.12.2022.godine, usvojila je Odluku 01 br. 06-42820 o preoblikovanju sastava Odbora za politiku i finansije od strane Skupštine opštine Klina.

MALS konstatuje da usvojena odluka od strane Skupštine opštine Klina u suprotnosti sa članom 5 stav 2 Administrativnog uputstva (MALS) br. 05/2020 o postupku osnivanja, sastavu i nadležnostima stalnih i drugih odbora u opštini kojim je određeno da će politički subjekat sa najvećim brojem poslaničkih mesta, u zavisnosti od procenta zastupljenosti u skupštini, biti zastupljen i u odboru, nastavlja sa drugim entitetom sa najvećim brojem članova u skupštini i tako sve dok se ne raspodele sva odbornička mesta. Raspodela mesta u Odboru za politiku i finansije vrši se prema mestima koja su politički subjekti osvojili u slučaju sertifikacije članova skupštine od strane CIK-a, prema kojoj u OPF-u pripada jedan (1) član političkom subjektu iz redova pokreta Vetevendosje.

Stoga, na osnovu gore navedenog, Skupština opština Klina treba preduzeti radnje i uskladiti akt sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

*Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040. Nenit 3, Nenit 5, Nenit 6 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë i datës 21.12.2021, Nenit 53 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative Nr 05/L-031, nenit 31, 32, 33 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës /2010. Ligjit për barazi gjinore Nr. 05/L-020, Nenit 11 të Rregullores për Punë Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës /2011, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datë: 20.12.2022, mori këtë:*

Data 23.12.2022
01- 62041/3

# VENDIM

*Për*
*riformatizimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa*

1. Miratohet propozimi i Grupit Kuvendar të AAK-së për riformatizimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Klinës.

2. Përbërja reflekton përfaqësimin e etnive politike dhe gjinore në Kuvendin e Komunës në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 dhe ka këtë përbërje:

   **1. Fadil Gashi - LDK, Kryesues**
   **2. Blerina Gashi - LDK, anëtare**
   **3. Tunë Dedaj - AAK, anëtar**
   **4. Blerta Gashi - AAK, anëtare**
   **5 .Bledar Berisha - AAK, anëtar**
   **6. Mendehie Duraku - PDK, anëtare**
   **7. Azdren Ramadani - PDK, anëtar**

3. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve të tjera dhe se mandati i këtij komiteti është i lidhur me mandatin e anëtareve të Kuvendit

4. Përbërja e anëtarëve të KPF-së është shtatë (7) anëtarë të Kuvendit, të cilët do të kompensohen për punën e tyre sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2020.

5. Me ketë vendim, ndryshohet - plotësohet vendimi 01Nr.06-3502/2022 i datës: 28.01.2022.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

7. Me ketë vendim njoftohen: MAPL, anëtaret e KPF-së, kryetari i komunës, drejtoria për financa ekonomi dhe zhvillim, arkivi i komunës dhe zyra për informim

**KUVENDI I KOMUNËS KLINË**

01Nr.06 - 42820 /2022
Klinë, datë: 23.12 /2022

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E KLINËS - MUNICIPALITY OF KLINA

**Kryesuesi,**
**Fadil Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

*Oslanjajući se na član 51. i 52. Zakona o lokalnoj samoupravi, br.03/L-040. Član 3, član 5, član 6 i 12 Administrativnog uputstva (MAPL) br. 05/2020 o postupku osnivanja, sastavu i ovlašćenjima stalnih komiteta u opštini od 21.12.2021 godine, član 53 Zakona o opštem upravnom postupku broj 05/L-031, članaka 31, 32, 33 i 53 Statuta Opštine Klina /2010, Zakona o rodnoj ravnopravnosti br. 05/L-020, član 11 Pravilnika o radu Skupštine i skupstinskih komiteta /2011, Skupština opštine Klina na redovnu XI sednici za 2022 godinu, održanoj 20.12.2022, uzima sledeći:*

# ODLUKU

*O*

*Riformatiranju Komiteta za Politiku i Finanisje*

23.12.2022

1. Usvaja se predlog Poslaničke grupe AAK za riformatisanje sastava Komiteta za politiku i finansije Skupštine opštine Klina.

2. Sastav odražava zastupljenost političkih i rodnih etničkih grupa u Skupštini opštine na osnovu Administrativnog uputstva br. 05/2020 i ima sledeći sastav:

    1. Fadil Gashi - LDK, predsedavajuci
    2. Blerina Gaši - LDK, član
    3. Tune Dedaj - AAK, član
    4. Blerta Gaši - AAK, član
    5. Bledar Beriša - AAK, član
    6. Mendehie Duraku - PDK, član
    7. Azdren Ramadani - PDK, član

3. Članovi Komiteta za politiku i finansije ne mogu biti članovi drugih komiteta i da je mandat ovog odbora povezan sa mandatom članova Skupštine.

4. Sastav članova KPF-a je sedam (7) članova Skupštine, koji će biti naplaćeni za svoj rad u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 05/2020.

5. Ovim rešenjem menja se - dopunjuje se Odluka 01 broj 06-3502/2022 od: 28.01.2022.

6. Ova odluka stupa na snagu nakon usvajanja od strane Skupštine opštine, u skladu sa Uredbom (VRK) br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019 za administrativnu reviziju opštinskih akata i nakon objavljivanja na sajtu opštine.

7. Ovom odlukom obaveštavaju se: MALS, članovi KPF-a, predsednik opštine, Uprava za finansije, privredu i razvoj, arhiv opštine i kancelarija za informisanje.

**SKUPŠTINA OPŠTINE KLINA**

**01Br. 06 – 42820/22**

**Klina, 23.12. /22**

**Predsedavajuci,**

**Fadil Gashi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije / Ministry of Local Government Administration – OUTGOING
Nr. 020-118/2
Datum 16.02.2022

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Zenun Elezaj, Kryetari i Komunës së Klinës<br>Fadil Gashi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Venera Çerkini, Zv, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>09.02.2022<br>020-118 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Gëzim Sahiti, zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Klinës | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregullore (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore(QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| **Vendim për themelimin e komitetit për politikë dhe financa** |
| I miratuar më datë: 28.01.2022 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.02.2022 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-118/2
Data Datum Date 16.02.2022

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| ZA: | Zenun Elezaj, gradonačelnik Opštine Klina<br>Fadil Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Klina | |
| Kopija: | Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinica za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Elbert Krasniqi, ministar MALS-a,<br>Venera Cerkini, zamenica generalnog sekretara u MALS-u, | |
| Od: | Besim Murtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština - MALS | Dana, 09.2.2022.<br>Br. 020-118 |
| | | |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik-ca za potvrdivanjnje pravne procene:<br>2. Službenik-ca za izradu pravne procene: | Gëzim Sahiti, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština<br>Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Klina | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.06/2021 o dopuni i izmeni Uredbe VRK-a br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, utvrđenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva ladministracije okalne samouprave primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kao što je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka za uspostavljenje Odbora za politiku i finansije |

| | |
|---|---|
| Usvojena dana, 28.1.2022. | |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 2.2.2022. | |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je **isti sa proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org

*Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, Nenit 3, Nenit 5, Nenit 6 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë i datës 21.12.2021, nenit 31, 32, 33 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës /2010, Ligjit për barazi gjinore Nr. 05/L-020, Nenit 11 të Rregullores për Punë Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës /2011, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datë: 28.01.2022, mori këtë:*

# V E N D I M

## Për

## Themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, si komitet i përhershëm. Komiteti kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

2. Përbërja reflekton përfaqësimin e etnive politike dhe gjinore në Kuvendin e Komunës me këtë përbërje:
1. Fadil Gashi - LDK, Kryesues
2. Blerina Gashi - LDK, anëtare
3. Tusë Dedaj - AAK, "
4. Blerta Gashi - AAK, "
5. Bledar Berisha - PDK, "
6. Mendehije Duraku - PDK, "
7. Valmire Krasniqi - VV, "

3. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve të tjera dhe se mandati i këtij komiteti është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit

4. Përbërja e anëtarëve të KPF-së është shtatë (7) anëtarë të Kuvendit, të cilët do të kompensohen për punën e tyre sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05 2020

5. Përbërja dhe kompetencat e këtij Komiteti rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si në hyrje të këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

7. Me këtë vendim njoftohen MPL, anëtarët e KPF-së, kryetari i komunës, drejtoria për financa ekonomi dhe zhvillim, arkivi i komunës dhe zyra për informim

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr.[illegible] 2022
Klinë më [illegible] 2022

Kryesuesi
Fadil Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org

*Na osnovu [illegible] 32. Zakona o lokalnoj samoupravi, [illegible] člana 3, člana 5 [illegible] o postupku osnivanja, sastavu i nadležnostima 4 Administrativnog uputstva ([illegible]) br. 05/2020 [illegible] Statuta opštine Klina/2010, Zakona o stalnih komisija u opštini od 21.12.2021. člana 31, 32, 33 i 34 [illegible] Poslovnika o radu Skupštine [illegible] ravnopravnosti polova br. 05/L-020, člana 11 [illegible] odbora/2017, Skupština opštine Klina na I redovnoj sednici za 2022 godinu, [illegible] uzima sledeću:*

# ODLUKU

za

## Osnivanje Komiteta Politike i Finansija

1. Osniva se Komitet za Politke i Finansije Skupstine Opstine Klina kao stalni komitet. Predesedavajuci Komiteta je Predsedavajuci Skupstine Opstine.

2. Sastav odražava zastupljenost političkih i rodnih etničkih grupa u Skupštini opštine i ima ovaj sastav:
   1. Fadil Gashi - LDK, Predsedavajuci
   2. Blerina Gashi - LDK, član
   3. Tunë Dedaj - AAK, "
   4. Blerta Gashi - AAK, "
   5. Bledar Berisha - PDK, "
   6. Mendehije [illegible] - PDK, "
   7. Valmire Krasniqi - LVV, "

3. Članovi Komisije za politiku i finansije ne mogu biti članovi drugih komisija i da je mandat ovog odbora povezan sa mandatom clanova skupstine

4. Sastav članova KPFa je sedam (7) članova Skupštine, koji će biti naplaćeni za svoj rad prema Administrativnom uputstvu br. 05/2020

5. Sastav i nadležnosti komiteta zauređuju se zakonskim i podzakonskim aktima koji su na snazi kao u uvodu ove odluke.

6. Ova odluka stupa na snagu nakon usvajanja od strane Skupštine opštine, u skladu sa uredbom (KRK) br. 06/2021 o izmenama i dopunama uredbe (KRK) br. 10/2019 o administrativnoj reviziji opštinskih akata i nakon objavljivanja na sajtu opštine.

7. O ovoj odluci obaveštavaju se: MLSU, članovi KPK, predsednik opštine, Uprava za finansije, privredu i razvoj, Opštinska arhiva i Služba za informisanje

**SKUPŠTINA OPSTINE KLINA**

01Br. __________/2022
Klina, __________/2022

Predsedavajuci,
Fadil Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

*Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.3 nën d) dhe dispozitat e nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, nr. 03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e paragrafit 4 te nenit 24 të Ligjit nr.06/L-02 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Dispozitat e Ligjit, nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nenit 10 dhe 40 të Statutit të Komunës, me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit, nr. 352-39541, të datës 21.11.2022 si dhe me rekomandimin e KPF-së të datës 14.11.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të rregullt të mbajtur më datën: 02.12.2022, merr këtë:*

## VENDIM

### *Për Shpallje "Zonë më Interes Publik" brigjet e shtratit të lumit "Drini i bardhe" në Klinë*

1. Miratohet kërkesa, e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nr. 352-39541, për Shpalljen "Zonë më Interes Publik" të shtratit të lumit "Drini i Bardhe" në të dy anët e brigjeve të tij dhe atë nga ura e Haxhisë deri tek ura e hekurit më qellim të realizimit të projektit rregullimi i shtratit të Lumit Drini i Bardhë .

2. Zona e përmendur si ne piken 1 te këtij vendimi shpallet zone më interes publik më qëllimin e realizimit të projektit zgjerimi dhe ndërtimi i shtratit të Lumit Drini i Bardhë projekt i cili është më interes për qytetaret e komunës së Klinës.

3. Kompetent për vazhdimin e procedurave lidhur më shpronësimin dhe këmbimin e pjesëve të parcelave përgjatë shtratit të lumit Drini i bardhe është kryetari i komunës në bashkëpunim më organet përgjegjëse komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas Rregullores së (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Klinës.

5. Më këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Kadastrit, Zyra për informim dhe Arkivi i Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS KLINË**

**01Nr 06-41148 /2022**
**Klinë, datë 02 / 12 /2022**

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E KLINËS · MUNICIPALITY OF KLINA · REPUBLIC OF KOSOVO · OPŠTINA KLINA · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA KLINA

**Kryesuesi,**
**Fadil GASHI**